UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS

# DISERTACION

PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

# ARKITEKTURA DHE PLANIFIKIMI URBAN NË TIRANË NË PERIUDHËN 1925-1943. ZHVILLIMI TIPOLOGJIK I BANESAVE KOLEKTIVE

Kandidati:

**MSc. Oketa BORIÇI (HOXHA)**

Udhëheqës shkencor:

**Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA**

**Tiranë, 2022**

**Mirënjohje**

Falënderimet shkojnë për njerëzit që më kanë qëndruar afër dhe më kanë mbështetur gjatë viteve të realizimit të këtij kërkimi shkencor.

Mirënjohje e veçantë për udhëheqësin tim, profesor Florian Nepravishta, ndihma profesionale dhe këshillat e të cilit nuk më kanë munguar gjithë këto vite.

Pjesë e falënderimeve të mia janë: drejtori i Arkivit Qëndror Teknik të Ndërtimit, Dr. Gjergj Thomai, i cili vendosi në dispozicion të gjitha materialet e nevojshme për studimin tim dhe Dr. Marvin Cukaj, i cili mundësoi hyrjen time në bibliotekën e Universitetit Politeknik të Milanos dhe marrjen e literaturës së duhur për disertacionin.

Në qoftë se nuk do të kisha pranë në çdo moment familjen time nuk do të isha dot e realizuar, ndaj falënderimi më i madh shkon për bashkëshortin, Indrit dhe prindërit e mi. Ky studim i dedikohet fëmijëve të mi Amrës dhe Odritit, të cilëve u kërkoj falje për kohën e munguar por u premtoj se do më kenë gjithmonë pranë sepse dashuria e tyre pa kushte më ndihmoi ta kaloj këtë hap të rëndësishëm të jetës sime. Në fund, por jo nga rëndësia dua të falënderoj për mbështetjen morale dhe shpirtërore që më kanë dhënë: të shtrenjtën, motrën time Alperën dhe tre mikeshat e mia të zemrës, Mirën, Anin dhe Denin.

Faleminderit të gjithëve për besimin.

"Good buildings come from good people and all problems are solved by good design"

Stephen Gardiner

"Whatever good things we build end up building us"

Jim Rohn

## PËRMBLEDHJE

Nevoja për të pasur një sërë mjetesh që mund të përdoren për qëllime të mësimdhënies dhe dizajnit, ofron mundësinë e publikimit të disa materialeve, të cilat mbartin vlera edhe në ditët e sotme, përtej qëllimit të ngushtë që ato kishin në kohën e projektimit të tyre. Kërkesa për të siguruar gjithmonë një numër të madh mjetesh të thjeshtuara për të lexuar dhe interpretuar realitetin fizik që na rrethon, por që ka lindur në të kaluarën, duhet të jetë po aq e qartë sa është prezenca e kritikës arkitekturore të së kaluarës në Shqipëri. Ky kërkim mund të shikohet si një gërmim dokumentar dhe analizë e banesës në terma të lehtë dhe të arritshëm duke u bazuar në elementët bazë të nevojshëm për arritjen e disa konkluzioneve se si arkitektura e tipologjisë së apartamente e viteve para 1944 manifestohej në realitetin e asaj kohe. Ky material katalogimi dhe rileximi krahasues i disa elementëve që duhet të jenë baza e çdo qasjeje sistematike ndaj temave të ndryshme arkitekturore është i vëmendshëm ndaj analizimit të fenomeneve në kontekstin e tyre autentik politiko-kulturor, strukturor dhe arkitektonik. Produkti i mëposhtëm duhet vlerësuar, i organizuar mbi bazën e një kriteri të përgjithshëm kronologjik që nuk përjashton ndërthurjen dhe krahasimin midis përvojave të ndryshme të përshkruara nga ngjarjet ndërkombëtare të asaj periudhe, në veçanti të atyre të ndodhura në Evropë.

Ky kërkim, mbi banesat kolektive në Shqipëri për periudhën e gjysmës së parë të shekullit të XX-të, ka për qëllim të evidentoj një pjesë të historisë së arkitekturës shqiptare me interes të veçantë, e cila deri më sot nuk është studiuar rrënjësisht. Arkitektura e "banesave kolektive", e cila përfshin banesat e para të këtij lloji në Shqipëri ka një ndikim shumë të madh të arkitekturës italiane sepse janë projektuar dhe ndërtuar në periudhën e kolonizimit masiv italian. Arkitektët që patën më shumë ndikim në projektet në Shqipëri ishin të lindur në vitet e para të 1900 duke mbartur në njohuritë dhe formimin e tyre eksperiencën racionale të projektimit.

Për ecurinë dhe zhvillimin e tij, ky studim shkencor u mbështet tek metoda përshkrimore, analitike dhe krahasuese duke u shoqëruar me metoda grafike dhe matematikisht rigoroze për nxjerrjen e rezultateve të duhura dhe arritjen e konkluzioneve si pjesë e qëllimit kryesor të kërkimit. Metoda përshkrimore është zgjedhur si domosdoshmëri në hulumtimin dhe raportimin e ngjarjeve historike, grumbullimin e të dhënave dhe studimin e literaturës ndërkombëtare. Përdorimi i metodës analitike ka ndihmuar në vlerësimin dhe analizimin e fakteve, të dhënave dhe informacioneve të mbledhura.

Hipoteza teorike e këtij kërkimi bazohet mbi komoditetin jetik të krijuar nga sipërfaqet dhe raporti i hapësirave në banesat kolektive të nëpunësve në Shqipëri në krahasim me banesat minimale dhe racionale të punëtorëve në Evropë.

Kërkimi shkencor nis strukturën e vet duke evidentuar ngjarjet historike-politike, social-ekonomike dhe urbanistike-arkitektonike në Shqipëri në tre periudha të ndryshme, të cilat datojnë ngjarje të rëndësishme. Ai evidenton disa pika të rëndësishme, të cilat kanë përcaktuar stilin e fillimit të viteve 1900 në vendin tonë, duke marrë parasysh dhe debatet e mëdha që janë bërë midis projektimit dhe realizimit të planeve rregulluese dhe ndërhyrjeve arkitektonike dhe urbane. Nevojat e projektimit të banesave kolektive lindën natyrshëm pas

zhvillimit të Tiranës dhe pranisë së shumë punëtorëve dhe zyrtarëve të huaj në kryeqytet. Nxjerrja e materialeve të nevojshme të projekteve të ndërtesave të banesave kolektive, të marra për studimin dhe përpunimi i tyre grafik dhe analitik ka qenë një nga pikat më të rëndësishme të disertacionit. Analiza kryesore e apartamenteve është bazuar në numrin e ambienteve dhe sipërfaqet e hapësirave të krijuara në tipologji të ndryshme banesash. Në fillim realizohet një katalogim i banesave sipas tipologjive të ndërtesave të projektuara në Tiranë dhe më pas detajimet vazhdojnë në qelizën e banimit ku çdo apartament është studiuar dhe të dhënat e tij janë hedhur në tabela të veçanta për të arritur në rezultat e duhura. Në fund të tezës së disertacionit është përdorur metoda krahasuese, falë ndihmës së rasteve studimore të huaja, të cilat kanë qenë pjesë e rëndësishme e studimit. Rezultatet e marra nga shembujt e banesave kolektive në Tiranë janë krahasuar me ato të projekteve të banesave për dy kategori punëtorësh në Evropë. Ky studim kthen vëmendjen drejt gjurmëve të para të krijimit të qelizës së banimit si apartamenti në Tiranë duke u përqendruar tek vlerat dhe karakteristikat që ato mbartin. Banesat kolektive në vendin tonë nuk klasifikohen në banesat minimaliste apo tipike racionale të periudhës kur u projektuan. Ato kanë një kompozim hapësirash dhe ambiente të përshtatshme për një nivel jetese shumë të lartë në krahasim me projektimet e ngjashme për të njëjtin target strehuesish në Evropë.

**Fjalë kyçe:** banesa kolektive, planifikim urban, Plan Rregullues, banesa minimale, banesa racionale, banesa punëtorësh.

**SUMMARY**

The need to have a variety of means that can be used for teaching and design purposes offers the possibility of publishing some materials, which carry value even nowadays, beyond the narrow purpose they had at the time of their design. The requirement to always provide a large number of simplified means to read and interpret the physical reality that surrounds us, although created in the past, must be as clear as is the presence of the architectural criticism of the past in Albania.

This research can be seen as a documentary research and analysis of the buildings in easy and accessible terms based on the basic elements needed to reach some conclusions on how the typology architecture of the apartments of the years before 1944 was manifested in the reality of that time. This material cataloging and comparative re-reading of some elements that should be the basis of any systematic approach to various architectural topics is observant to the analysis of phenomena in their authentic political-cultural, structural and architectural context. The following product should be evaluated, organized on the basis of a general chronological criterion that does not exclude the interaction and comparison between different experiences described by international events of that period, in particular those that occurred in Evrope.

This research, on collective housing in Albania for the first half of the twentieth century, aims to identify a part of the history of Albanian architecture of special interest which to date has not been thoroughly studied. The architecture of "collective housing", which includes the first housing of this type in Albania has a huge influence of Italian architecture because they were designed and built in the period of massive Italian colonization. The architects who influenced most the projects in Albania were born in the first years of 1900s and carried in their knowledge and background the rational experience of design.

For its progression and development, this scientific study relied on descriptive, analytical and comparative methods accompanied by graphical and mathematically rigorous methods for achieving the right results and reaching conclusions as part of the main scope of the research. The descriptive method played a neccesary part in the research and reporting of historical events, data collection and the study of international literature. The use of the analytical method has aided in evaluating and analyzing the facts, data and the gathered information.

The theoretical hypothesis of this research is based on the vital comfort created by the areas and the ratio of spaces in the collective housing of employees in Albania in comparison to the minimal and rational housing of workers in Evrope.

The scientific research starts its structure by identifying historical-political, socio-economic and urban-architectural events in Albania in three different periods which constitute important events. It highlights some important points, which have defined the style of the early 1900s in our country, taking into account the great debates that have taken place between the design and implementation of regulatory plans and architectural and urban interventions. The needs for the design of collective housing rose naturally after the progress of Tirana and the presence of many foreign workers and officials in the capital. The extraction of the necessary materials for the projects of collective buildings obtained for the

study and graphic and analytical elaboration has been one of the most important highlights of the dissertation. The main analysis of apartments is based on the number of facilities and areas of space created in different typologies of apartments.

At the beginning, a cataloging  of apartments is achieved according to the typologies of buildings designed in Tirana and, then, the details continue in the residential arias where each apartment is studied and its data are placed in special tables to achieve the right result. At the end of the dissertation thesis, comparative method was used thanks to the help of foreign case studies which have been an important part of the study. The results obtained from the examples of collective housing in Tirana are compared with those of housing projects for two categories of workers in Evrope. This study turns its attention to the first traces of the creation of a residential aria as is an apartment in Tirana by focusing on the values and characteristics that they hold. Collective housing in our country are not classified as minimalist or typical rational housing of the period when they were designed. They have a composition of spaces and environments suitable for a very high standard of living compared to similar designs for the same accomodating target in Evrope.

**Keywords:** collective buildings, Urban planning, Regulatory Plan, minimal building, rational buildings, workers' building

# TABELA E PËRMBAJTJES

1. PLANI I KËRKIMIT ..... 11
1.1. Hyrje ..... 11
1.2. Përcaktimi i problemit ..... 14
1.3. Pyetjet e kërkimit ..... 14
1.4. Qëllimi dhe objektivat e kërkimit ..... 15
1.5. Metodologjia dhe metoda e kërkimit ..... 16
1.6. Vështirësitë dhe kufijtë e kërkimit ..... 18
1.7. Organizimi i Temës ..... 19
2. SFONDI HISTORIK NË SHQIPËRI ..... 22
2.1 Politika dhe krijimi i shtetit të ri ..... 22
2.2 Ndërhyrjet urbane dhe arkitektonike në Tiranë 1925-1944 ..... 25
3. SFONDI HISTORIK. BANESAT E PERIUDHËS 1925-1943 NË EVROPË ..... 37
3.1 Formimi i qyteteve industriale ..... 37
3.2 CIAM – International Congresses of Modern Architecture ..... 41
3.3 Alexander Klein ..... 45
3.4 Banesa popullore kolektive dhe banesa individuale ..... 46
3.5 Tipologjitë e banesave kolektive në vende të ndryshme në Evropë ..... 50
3.6 Karakteristikat e banesës popullore në raport me qelizat ..... 59
4. BANESAT E PUNËTORËVE NË TIRANË ..... 64
4.1 Zonat kryesore të banimit ..... 64
4.2 Banesat e punëtorëve me shtëpi të bashkangjitura – fshati “Littorio” ..... 66
4.3 Banesat kolektive të tipit bllok ..... 67
4.4 Banesat kolektive të tipit linear ..... 69
5. BANESAT KOLEKTIVE DHE ANALIZA ARKITEKTONIKE ..... 73
5.1 Banesat e vitit 1929 – projektet austriake ..... 73
5.2 Banesat e periudhës 1939-1943 – projektet italiane ..... 75
5.2.1 “Villaggio Littorio” ..... 75
5.2.2 Banesat kolektive në Tiranë ..... 78
5.3 Analiza e banesave. Metodologjia ..... 91
6. REZULTATET E APARTAMENTEVE NË TIRANË ..... 97
6.1 Tipologjitë e ndërtesave ..... 97
6.2 Tipologjitë e apartamenteve ..... 99
7. PROJEKTIMI I BANESËS SË PUNËTORËVE NË EVROPË ..... 105

8. KONKLUZIONET ..... 116

8.1 Konkluzionet e tipologjisë së banesës së projektuar në Tiranë ..... 116

8.2 Konkluzionet e analizës krahasimore të banesës në Tiranë në raport me banesën minimale dhe racionale të punëtorëve në Evropë ..... 118

8.3 Konkluzionet e analizës krahasimore të banesës në Tiranë në raport me banesën e nëpunësve në Evropë ..... 120

BIBLIOGRAFI ..... 125

9. SHTOJCA ..... 134

# PLANI I KËRKIMIT 1

# 1. PLANI I KËRKIMIT

## 1.1. Hyrje

Në Tiranë, të gjitha banesat kolektive, të cilat janë ndërtuar para vitit 1944 janë ende funksionale dhe të banueshme nga banorët e qytetit. Ato janë përshtatur me strukturën urbane, si në periudhën në të cilën janë ndërtuar por dhe në situatën aktuale urbane. Ato nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e një analize apo studimi të një historiani apo arkitekti. Këto ndërtime janë të përqendruara në zona shumë të rëndësishme të qytetit dhe prania e tyre nuk mund të injorohet, jo vetëm për rëndësinë historike që ato mbartin, por edhe për pozicionin e tyre në qytetin e Tiranës.

Në periudhën para vitit 1944, shumë arkitektë shqiptar dhe te huaj (të pranishëm në pjesën më të madhe të projekteve), kanë projektuar objekte banimi dhe banesa kolektive, të cilat jo të gjitha janë realizuar dhe ndërtuar. Edhe pse ato kanë ngel vetëm në letër, në kuadrin e projekt idesë, kanë një interes studimi dhe analizimi për vet karakteristikat e projektimit që ato përcjellin. Në ditët e sotme, arkitektë, studentë dhe qytetarë të interesuar nuk e dinë se si është projektuar në atë periudhë në Shqipëri dhe si pasqyroheshin problematikat e kohës në nuklin bazë të jetesës për një familje. Disa prej këtyre objekteve janë rikonstruktuar në ditët e sotme, por disa prej tyre janë në gjendje fizike shumë të keqe.



*Figura 1-1 Pallat në Laprakë, ish "Vilagio Littorio". Burimi: Autori*




*Figura 1-2. Pallat në rrugën "Ismail Qemali", zona e ish "Bllokut". Burimi: Autori*




*Figura 1-3. Pallate në rrugën "Ismail Qemali", zona e ish "Bllokut". Burimi: Autori*



*Figura 1-4. Pallatet në krah të lumit "Lana" . Burimi: Autori*



*Figura 1-5. Pallatet në krah të lumit "Lana". Burimi: Autori*

## 1.2. Përcaktimi i problemit

Në botimet e realizuara deri në ditët e sotme nuk ka një katalogim të banesave kolektive të projektuara që në kohën e ndikimit austriak e deri në çlirimin e Shqipërisë, të paktën ato që janë të dokumentuara dhe të ruajtura në institucionet shtetërore si: Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit. Prezantimi dhe njohja e projekteve të vjetra është një mënyrë për të hulumtuar në të kaluarën historike dhe arkitektonike të vendit tonë.

Disa botime janë realizuar nga arkitektë dhe urbanistë, të cilët kanë pasqyruar dhe analizuar zhvillimin urban të Tiranës duke evidentuar disa prej zonave ku ndodhen banesat kolektive. Arkitektë të tjerë kanë kataloguar dhe përshkruar banesa individuale dhe vila të banorëve të kryeqytetit dhe jo vetëm, por askush nuk ka ndaluar tek banesat kolektive të ndertuara para vitit 1944. Ato kanë një interes të veçantë për vlerat historike dhe arkitektonike që ato mbartin. Ky kërkim shkencor synon të thelloj dijet (njohuritë) dhe të hedh dritë mbi tipologjitë e banesave kolektive në Tiranë. Fokus i kësaj teze do të jenë:

- Ideologjia (duke marrë në shqyrtim dhe krahasim dhe rastet e tjera të ngjashme në Evropë).
- Standardet e projektimit me gjithë elementët që përfshihen në të.
- Shtresa shoqërore se për kë ishte projektuar kjo tipologji banese.

## 1.3. Pyetjet e kërkimit

Pyetjet e kërkimit kanë lindur nga studimi i planifikimit urban dhe banesave të para kolektive në Tiranë, leximi i literaturës dhe kërkimeve individuale të shembujve evropian të projektimit të banesave të punëtorëve dhe nga qasja e tipologjive të ndryshme të projekteve të propozuara dhe realizuara në Tiranë.

- Si ka ndryshuar Tirana nëpërmjet Planeve Rregulluese ndër vite, nga 1925 deri 1944?
- Si u zhvilluan zonat e banimit dhe ku u vendosën ato? Cilët ishin faktorët kryesor që ndikuan në këtë proçes?
- Si ka ndryshuar banesa kolektive në Shqipëri, që nga momenti kur ato filluan të projektoheshin e deri në momentin kur ndryshoi historia dhe arkitektura në vendin tonë, në vitin 1944?
- Si kanë ndikuar ngjarjet historike dhe politike në Shqipëri në projektimin e banesës kolektive para çlirimit të vendit?
- Cilat janë tipologjitë e banesave kolektive në Tiranë (qyteti ku është përqendruar studimi), zhvillimet morfologjike, modelet e dizajnit, hapësirat, skemat funksionale të tyre?
- Si janë sipërfaqet dhe hapësirat e banesave kolektive në Tiranë në raport me banesat minimale dhe ato racionale të projektuara në të njëjtën periudhë në Evropë?
- A janë banesat kolektive në vendin tonë të projektuara me të njëjtat parametra dhe kushte hapësirash si banesat e punëtorëve apo punonjësve në Evropë?

Janë pikërisht këto pyetje kërkimi të cilat ngrenë hipotezën dhe qëllimin kryesor të tezës së disertacionit si dhe nën objektivat e saj.

- **Hipoteza**

Hipotezat e kërkimit shkencor janë:

1. Banesat minimale dhe racionale në Evropë janë më të vogla në sipërfaqe dhe raporte hapësirash se banesat kolektive në Tiranë.
2. Banesat e punëtorëve në Evropë kanë sipërfaqe më të vogla se banesat kolektive në Tiranë.

Për të vërtetuar hipotezat, gjatë kërkimit shkencor, ngrihen dy struktura paralele, që janë; studimi dhe analiza e banesave kolektive në Tiranë dhe zgjedhja e literaturës së duhur duke shqyrtuar rastet e banesave minimale dhe racionale nga njëra anë dhe banesat e punëtorëve në Evropë nga ana tjetër. Modelet e shembujve të huaj zgjidhen duke u bazuar në gjetjen e pyetjeve të mëposhtme:

Çfarë është "*ekzistenc minimum*" dhe banesat minimale në Evropë?

Cilat janë banesat racionale, ku u projektuan ato dhe si janë zgjidhjet planimetrike dhe hapësinore të tyre?

Cilat janë banesat që u projektuan për punëtorët në Evropë dhe si ishin kushtet jetike të tyre?

Si janë sipërfaqet e apartamenteve, numri i ambienteve dhe hapësirat në këto tipologji banesash?

A janë këto banesa me komiditet më të lartë se banesat kolektive në Tiranë?

### 1.4. Qëllimi dhe objektivat e kërkimit

Qëllimi kryesor i kërkimit është të pasqyroj dhe analizoj historikun, arkitekturën, skemat funksionale, format arkitektonike të përdorura tek banesat kolektive në Shqipëri, duke u fokusuar në qytetin e Tiranës. Zhvillimi i tipologjive dhe arkitektura e ndërtesave do të jenë pjesë kryesore e këtij studimi, duke u konkluduar me paraqitjen dhe analizën e detajuar të skemave funksionale planimetrike.

Pjesë e objektivave është dhe evidentimi dhe trajtimi i problemeve që dalin nga analizimi i planimetrive të banesave kolektive. Ky kërkim do të përqendrohet me shumë në zgjidhjen funksionale te banesave dhe mënyrën se si ato përshtateshin me kushtet e jetesës së banorëve. Do të analizohet marrëdhënia që kanë zhvillimet historike me arkitekturën e ndërtimeve duke evidentuar shkaqet dhe pasojat, që vijnë si rezultat i kësaj marrëdhënie. Vlerësimi i banesave kolektive, të cilat janë të parat të këtij lloji në Shqipëri, mund të sjell disa karakteristika ose veçanti, të cilat mund të jenë të dobishme për ata që merren me fushën e projektimit, por edhe me studim. Duhet patur parasysh, që të gjitha rastet e studiuara në këtë studim nuk sjellin një skemë të vetme të zgjidhjeve funksionale sepse ato fillojne nga shtëpitë dyshe me planimetritë bazike e deri te apartamentet me shumë dhoma për akomodimin e shumë banorëve në to. Këto shembuj shoqërohen dhe me objekte shumë katëshe me shumë apartamente në çdo kat dhe me skema nga më të ndryshmet.

Kjo temë disertacioni pasi ka prezantuar një analizë të detajuar të banesave dhe ndërtesave kolektive në Tiranë, kërkon që të krijoj diskutime rreth asaj që ka qenë projektimi i këtij tipi

banese dhe ndoshta se si duhet të ruhen disa nga vlerat, që ato mbartin dhe mund ti përcjellin në të ardhmen.

Tema kërkimore bazohet në disa objektiva, të cilat lidhen edhe me pyetjet kërkimore të përmendura më sipër.

1) Kronologjia e ngjarjeve historike shoqëruar me zhvillimet urbane dhe arkitektonike në Shqipëri, duke qëndruar në mënyrë specifike tek qyteti i Tiranës. Pse dhe si u konkretizuan planet rregulluese në Tiranë dhe ndikimi që ato patën tek banorët e qytetit.
2) Shpjegimi i rëndësisë së banesave kolektive në botë dhe në vendin tonë në veçanti, duke e lidhur ngushtë me ngjarjet historike dhe politike që kanë ndodhur në Shqipëri. Arsyeja e domosdoshmërisë së këtij koncepti projektimi nga arkitektët.
3) Rëndësia e këtyre lloj banesash në Tiranë në periudhën e marrë në studim dhe vlerat e tyre në ditët e sotme dhe në të ardhmen.
4) Zhvillimet e ndryshme historike dhe politike kanë sjell dhe ndryshime në dizajnin e banesave duke u ndikuar nga prezenca e arkitektëve të huaj dhe shqiptar të diplomuar në vende të ndryshme të Evropës.
5) Objektivi i fundit, por më i rëndësishmi qëndron tek analiza e tipologjive, morfologjisë, hapësirave dhe elementëve të ndryshëm të dizajnit të banesave kolektive të projektuara para vitit 1944. Studimi dhe analiza e hapësirave, skemave të lëvizjes, parametrat e ambienteve duke u përqendruar tek dimensionet e hapësirave, format dhe madhësitë do të jenë elementët kryesor ku do të bazohet ky objektiv.

### 1.5. Metodologjia dhe metoda e kërkimit

Kjo temë kërkimore është bazuar në tre metodologji kryesore, që janë: përshkrimore, analitike dhe krahasimore. Arsyeja pse është zgjedhur *metoda përshkrimore* qëndron tek rëndësia, që ka për këtë tezë, përshkrimi i ngjarjeve historike e politike dhe grumbullimi i të dhënave dhe projekteve të realizuara në atë periudhë. Në fund të studimit është përdorur “metoda analitike, ku të dhënat e grumbulluara, faktet, informacionet e mbledhura, analizohen duke bërë një vlerësim kritik të tyre”

Në pjesën e parë të tezës, metoda e kërkimit është bazuar kryesisht në grumbullimin e literaturës, të cilat shpjegojnë qartë të gjithë kronologjinë historike të Shqipërisë dhe ndryshimet e sistemeve politike para vitit 1944. Të gjithë këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejtë në projektimin dhe ndërtimin e banesës në vendin tonë. Elementë ndihmës për temën kanë shërbyer edhe botime dhe artikuj ndërkombëtar, të cilët shpjegojnë dhe analizojnë banesën kolektive dhe atë individuale në vende të ndryshme të botës, si për periudhën para Luftës së Dytë Botërore, ashtu edhe më pas.

Për realizimin e vazhdimit të tezës, kërkimi është bazuar kryesisht në të dhëna primare ku janë mbledhur nga Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit projekte, ku përfshihen planimetri, pamje, prerje, detaje, planvendosje dhe disa fotografi të banesave kolektive ndër vite. Pjesë e dokumentimeve të rëndësishme, të marra nga ky institucion kanë qenë dhe dokumentet shkresor, sidomos ato të periudhës së pushtimit italian.

Janë rreth 50 objekte banesash të tipit kolektiv, tek të cilat është bazuar tema kërkimore. Në këtë fazë të kërkimit është shfrytëzuar metoda analitike ku të gjitha planimetritë e projekteve dhe objekteve, të realizuara ose jo janë hedhur në programin AutoCad dhe janë përgatitur skeda për secilën ndërtesë. Janë nxjerr të dhëna dhe informacione për secilën banesë duke krijuar skema funksionale për planet. Të gjitha të dhënat janë hedhur dhe përpunuar në programin Excel duke krijuar tabela dhe grafikë të ndryshëm, të cilët ndihmojnë në konkluzionet e temës.

Materialet e formatit jpg, të skanuara nga Arkiva janë përpunuar dhe pastruar duke u paraqitur me qartësi më të mirë.

- Çdo rast i marrë në studim do të prezantohet duke u diktuar në harta treguese se ku ndodhet në Tiranë dhe do prezantohet projekti i plotë me imazhet e planimetrive e pamjeve. Në këtë mënyrë do të krijohet një perceptim i saktë mbi ndërtesat e zgjedhura për kërkimin.
- Të gjitha ndërtesat janë grupuar në tipe duke u bazuar tek skema e shpërndarjes së apartamenteve dhe numri i tyre në godinë.
- Janë renditur në një tabelë ambientet e pranishme në secilin apartament me sipërfaqet përkatëse për secilën prej tyre.
- Realizohen grafikë duke krahasuar të dhëna të ndryshme të banesave sipas kronologjisë, pra nga 1929 deri në 1943 duke parë zhvillimin dhe ndryshimet, që ka pësuar projektimi i këtij tipi banese.

Më poshtë tregohen disa nga shembujt e studimit dhe skemat e përdorura në ndihmë të analizës së këtyre objekteve. Tregohet cila është tabela e hartuar për tipologjitë e ndërtesave për të parë zhvillimin e tyre ndër vite. Për çdo banesë apo apartament (sipas secilit rast) janë nxjerr të dhëna të ambienteve dhe sipërfaqeve të tyre duke i mbledhur në një tabelë shoqëruese për ta patur më të lehtë pjesën analitike dhe krahasimore të banesave kolektive. Të gjitha këto të dhëna, të marra nga matja e sipërfaqeve për secilin ambient të çdo apartamenti, nëpërmjet programit AutoCad janë hedhur në Excel. Sipas grumbullimit të informacionit në grupe të caktuara janë arritur grafikë të ndryshëm për rezultatet e kërkuara.

Në fund të tezës së disertacionit, nëpërmjet *metodës krahasimore* është realizuar qasja e banesave të punëtorëve në Evropë me banesat kolektive në Tiranë, falë ndihmës së rasteve studimore të huaja të paraqitura në kërkim. Qasja dhe përballja e parë është realizuar midis banesave kolektive në Tiranë dhe rezultateve të marra nga analiza e banesave minimale dhe racionale në Evropë. Duke u bazuar tek hipoteza e dytë e ngritur në këtë disertacion, u realizua krahasimi midis rasteve tona studimore në Tiranë dhe banesave të punëtorëve në Evropë, ku u zgjodhën rastet me tipologji shumë të ngjashme me vendin tonë. Rezultatet e marra nga këto krahasime ndihmojnë në vërtetimin e hipotezave të ngritura dhe në konkluzionet e arritura.

| KOMANDA AERONAUTIKA PALLATI TIP B | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Ap.3+1 | Ap.2+1 | Ap.1+1 | | |
| 4 | 2 | - | 1 | NR APARTAMENTESH |
| 320 | 300 | - | 2 | SIP. BRUTO APARTAMENTI |
| 1280 | 600 | - | 3 | SIP. BRUTO/ GODINE |
| 260 | 247 | - | 4 | SIP. E SHFRYTEZUESHME, E SHKELSHME |
| 60 | 53 | - | 5 | SIP. E MUREVE |
| 6 | 5 | - | 6 | NR. DHOMAVE / APARTAMENT |
| 3 | 2 | - | 7 | NR. DHOMAVE TE GJUMIT/ APARTAMENT |
| 4 | 3 | - | 8 | NR. KREVATEVE |
| 2 | 2 | - | 9 | NR. TUALETEVE |
| 37 | 37 | - | 10 | SIP. NDEJTJE |
| 14 | 21 | - | 11 | SIP. GATIMI |
| 44 | 44 | - | 12 | SIP. NGRENIE |
| - | - | - | 13 | NDEJTJA + NGRENIA |
| - | - | - | 14 | NDEJTJE + GATIMI |
| - | - | - | 15 | GATIM + NGRENIE |
| 10 | 11 | - | 16 | SIP. DH.GJ. 1 |
| 53 | 54 | - | 17 | SIP. DH. GJ. 2 |
| 19 | - | - | 18 | SIP. DH.GJ. 3 |
| 82 | 65 | - | 19 | SIP. DHOMA GJUMI TOTALI |
| 4 | 3 | - | 20 | SIP. BANJE 1 |
| 10 | 10 | - | 21 | SIP. BANJE 2 |
| 14 | 13 | - | 22 | SIP. BANJE TOTALI |
| 48 | 48 | - | 23 | SIP. KORRIDOR/ HYRJE |
| - | - | - | 24 | SIP. BALLKONI |
| 27 | 25 | - | 25 | SIP. VERANDE |
| 6 | 6 | - | 26 | SIP. LAVANDERI/ DEPO/ SHERBYES |
| - | - | - | 27 | SIP. SHKALLE E BRENDSHME |

| KOMANDA AERONAUTIKA PALLATI TIP B | | |
|---|---|---|
| 696 | 1 | SIP.NJOLLE OBJEKTI |
| 3 | 2 | Nr.KATE (mbi tokë) |
| 1 | 3 | Nr.KATE (nën tokë) |
| 2 | 4 | Nr.AP./KAT |
| 6 | 5 | NR. APART./GODINE |
| - | 6 | Nr.Ap.1+1 TOTAL |
| 2 | 7 | Nr.Ap.2+1 TOTAL |
| 4 | 8 | Nr.Ap.3+1 TOTAL |
| 70 | 9 | SIP.SHKALLE E PERBASHKET / GODINE (M2) |
| - | 10 | KATI PERDHE KA SHERBIME APO JO/ DYQANE |

*Figura 1-6. Shembujt e tabelave të realizuara për nxjerrjen e të dhënave të apartamenteve. Burimi: Autori*

## 1.6. Vështirësitë dhe kufijtë e kërkimit

Gjetja e materiale nga A.Q.T.N dhe skanimi i tyre ka kërkuar një periudhë dy vjeçare duke vështirësuar punimin mbi temën deri në momentin final kur gjithë projektet ishin të skanuara. Një pjesë e shembujve të objekteve nuk janë realizuar ose të paktën nuk shpjegohen se për ku ishin projektuar. Kjo vështirëson një analizë të detajuar, që mund tu bëheshin banesave të tilla, por pse jo edhe një prezantim të gjendjes aktuale të banesave kolektive nëpërmjet fotove reale.

Një pjesë e projekteve të zgjedhura për studimin nuk kanë shumë informacion dhe dokumente shkresor për të shpjeguar konceptet e projektuesve. Edhe detajet mungojnë tek fletët e projekteve duke pasqyruar në pjesën më të madhe të rasteve vetëm planimetritë e banesave. Ekziston një boshllëk i madh literature ku të analizohet arkitektura e banesave kolektive në Shqipëri para vitit 1944. Mungesa e detajeve dhe projektet jo të plota për një pjesë të ndërtesave e vështirësojnë analizën arkitektonike duke e fokusuar kërkimin dhe temën tek funksioni, planet dhe skemat funksionale. Fokusi kryesor ka qenë qyteti i Tiranës

sepse ka qenë pothuajse e pamundur për të gjetur materiale të mjaftueshme për qytetet e tjera të Shqipërisë për banesat kolektive.

### 1.7. Organizimi i Temës

Kërkimi është menduar që të organizohet në tetë kapituj kryesor duke e lidhur me tetë tema të rëndësishme:

*Kapitulli 1:* Hyrje. Në këtë kapitull paraqitet një prezantim i përmbledhur i problematikave, pyetjeve kërkimore që nevojiten për zhvillimin e temës, qëllimit dhe objektivat e kërkimit. Metodologjia luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e rrugës që do të ndiqet për ecurinë e disertacionit dhe shpjegimi i metodave të kërkimit paraqitet në këtë kapitull. Të pranishme gjatë ecurisë së tezës, që në zgjedhje të saj e deri në përfundim kane qenë të pranishme dhe një pjesë e tyre prezantohen në këtë pjesë të temës.

- Hyrje
- Konteksti
- Përcaktimi i problemit
- Pyetjet e kërkimit
- Qëllimi dhe objektivat e kërkimit
- Metodologjia dhe metodat e kërkimit
- Vështirësitë dhe kufijtë e kërkimit
- Organizimi i temës

*Kapitulli 2:* Sfondi historik në Shqipëri. Ky kapitull është i ndarë në dy momente kryesore, të cilat kanë lidhje me arenën poltike e historike në Shqipëri dhe me ndërhyrjet urbane dhe arkitektonike të realizuara në vendin tonë.- Në këtë pjesë të temës do të flitet mbi historinë shqiptare nga periudha e viteve ’20 e deri në vitin 1944. Zhvillimet politike në periudha të ndryshme historike kanë pasur ndikim edhe tek arkitektura dhe struktura urbane e Shqipërisë dhe në veçanti e Tiranës, si kryeqytet i vendit. Për këtë arsye fokus i këtij kapitulli do të jetë dhe politika duke evidentuar ngjarjet kryesore, që kanë ndodhur. Literatura dhe botime shqiptare ndihmojne për shkrimin e këtij momenti të tezës.

Ky kapitull flet për zhvillimet e përgjithshme në shkallë urbane, që i ndodhën qytetit të Tiranës. Ndikimi i projektuesve të huaj në këtë periudhë ishte i madh dhe kjo shpjegohet më së miri në përmbajtje të këtij kapitulli. Pjesë e rëndësishme e temës është evidentimi i zhvillimeve dhe ndryshimeve, që i ndodhi arkitekturës dhe objekteve në Shqipëri.

- Planet rregulluese të Tiranës midis viteve 1920-1931
- Ndryshimi nga Tirana fshat, në Tirana qytet
- Plani i përgjithshëm i Tiranës i vitit 1939-1943
- Rithemelimi i Tiranës, nga qyteti organik tek qyteti i organizuar

*Kapitulli 3: Sfondi historik. Banesat e periudhës 1925-1943 në Evropë.* Baza teorike mbi konceptin e banesës dhe zhvillimi i saj në botë është një pjesë e cila nuk mund të neglizhohet dhe duhet trajtuar patjetër. Efektet që projektimi i banesave kolektive sjell në jetesën e një shoqërie dhe faktorët që merren parasysh për projektimin e tyre, trajtohet në këtë kapitull.

- Banesa dhe rëndësia e projektimit të saj
- Faktorët që duhet të merren në konsideratë për projektimin e banesës
- Normativat e dizajnit
- Historia e banesave kolektive në botë

*Kapitulli 4: Banesat e punëtorëve në Tiranë.* Ky kapitull është i një rëndësie të veçantë sepse prezanton shembujt e banesave kolektive në Shqipëri duke analizuar e trajtuar arkitekturën, organizimin e funksionimin e tyre.

- Zhvillimi i banesës prej fillimit, në kohën e ndikimit austriak e deri në 1939
- Arkitektura e banesave deri në vitin 1939
- Zhvillimi i banesës në periudhën e ndikimit Italian, 1939-1943

*Kapitulli 5: Banesat kolektive dhe analiza arkitektonike.* Rastet e marra në studim janë analizuar dhe ndarë sipas tipologjive të ndryshme. Për çdo apartament janë realizuar skemat përkatëse funksionale dhe janë nxjerrë të dhënat specifike për çdo ambient dhe sipërfaqe brenda nuklit të banimit.

- Tipologjitë e banesave kolektive në Tiranë sipas numrit të apartamenteve në godinë
- Zhvillimi kronologjik duke u bazuar tek tipologjitë e tyre
- Tipologjitë e banesës duke u bazuar tek nukli i banesës apo apartamentit
- Të dhëna dhe parametra për strukturën e banesës dhe ambientet e saj
- Krahasimi dhe përmbledhje e të dhënave

*Kapitulli 6: Rezultatet e apartamenteve në Tiranë.* Në këtë kapitull bëhet një përmbledhje e gjithë analizave të mësipërme duke krahasuar parametra dhe duke nxjerrë rezultate nëpërmjet grafikëve.

- Rezultatet e metodave

*Kapitulli 7: Projektimi i banesës së punëtorëve në Evropë.* Në kapitullin e para fundit prezantohen disa raste studimore të banesave të punëtorëve në disa vende të Evropës. Ato janë shembujt që janë marrë parasysh gjatë analizës krahasimore për të vërtetuar njërën nga hipotezat teorike të ngritura gjatë kërkimit shkencor.

*Kapitulli 8: Konkluzionet.* Në kapitullin e fundit jepen konkluzionet e arritura nga nxjerrja e rezultateve për banesën kolektive në Tiranë dhe përfundimet e arritura pas një analize krahasimore të banesave minimale e racionale kolektive popullore në Evropë dhe banesave të punëtorëve (punonjësve) në disa vende evropiane me banesat kolektive të nëpunësve në Tiranë.

*Referencat, bibliografia*

*Shtojca*

# SFONDI HISTORIK NË SHQIPËRI 2

# 2. SFONDI HISTORIK NË SHQIPËRI

## 2.1 Politika dhe krijimi i shtetit të ri

Vitet 1920-1939 kanë përfshirë përpjekje dhe operacione të pa orientuara qartë ndaj një vizioni të përgjithshëm në shkallë urbane për qytetin e Tiranës. Megjithatë, të gjitha këto ndihmuan për të mbledhur ide dhe propozime, të cilat hodhën bazat e para ndaj një reflektimi të këtij qyteti i cili u kthye në kryeqytet. Planet e hartuara në këtë periudhë duke filluar nga ai i vitit 1923, 1925, 1926, 1928, 1929, 1930, 1931 ndjekin njëri tjetrin me periudha kohore shumë të ngushta dhe shpesh ndryshojnë shumë pak nga njëri tjetri, por ndërtojnë mbi njëri tjetrin, duke synuar të sjellin variantet më të mira.

Planet Rregulluese të cilat lanë gjurmë në Tiranë janë ato të pas vitit 1939, por para se të mberrihej në ato variante përfundimtare do të duhej të përshkruhej një rrugë e pashmangshme, ajo e prezantimit të projekt ideve të shumta të propozuara, të cilat krijuan bazamentin e parë të qytetit të projektuar. Të gjitha këto plane dhe eksperienca të mbledhura gjatë këtyre viteve kanë simbolizuar fillimin, fazën e parë të planifikimit shqiptar. Në qoftë se planifikimi urban nuk do të kalonte në fazat e më sipërme atëherë do të ishte e pamundur të realizoheshin planet e periudhës së fashizmit dhe ato të komunizmit.

Në janar të vitit 1920, me vendim të Kongresit të Lushnjës, Tirana u shpall kryeqytet. Përveç faktorëve politikë të asaj periudhe që ndikuan në marrjen e këtij vendimi, ishte dhe pozicioni gjeografik shumë i përshtatshëm i Tiranës, e cila kishte elementët e vendit ideal për tu kthyer në kryeqytet, si distancën e duhur nga deti e mali dhe klimën e favorshme. Elementët natyror si ujërat dhe gjelbërimi, mundësia e zhvillimit të bujqësisë për shkak të pranisë së fushave pjellore dhe pozicioni i Tiranës në qendër të Shqipërisë, i cili favorizon zhvillimin e tregtisë dhe ekonomisë janë faktorët e tjerë që ndikuan në zgjedhjen e këtij qyteti si kryeqytet i vendit. Koha tregoi se kjo zgjedhje justifikoi sfidat e njëpasnjëshme që do të përballonte Tirana si kryeqytet në rritje të vazhdueshme.

Kur u shpall kryeqytet, Tirana kishte një strukturë organike dhe spontane, me tipare mesjetare ku nuk ekzistonte asnjë fabrikë moderne, mbizotëronte zejtaria e copëzuar për punimin e metalit, veshmbathjeve, ushqimit, etj. të cilat punësonin 1-3 çirakë.

Pas rënies së qeverisë së Nolit në Dhjetor të vitit 1924, në Janar të vitit 1925 Ahmet Zogu shpallet fillimisht Kryetar i Republikës Presidenciale dhe në tetor të po atij viti ai shpallet Mbret i Monarkisë Kushtetuese të Shqipërisë.

Në vitin 1927 Tirana kishte vetëm 5 fabrika mielli me nga 13 punëtorë, po ashtu ekzistonin 54 njësi tregtare ku punonin 140 shegertë, 24 hotele dhe hane, 85 vetura, ndërsa për shërbimet urbane dhe transportin e mallrave ekzistonin 214 karroca e qerre dhe së fundmi 65 njësi tepër të vogla që shërbenin si kafene (Dhamo, Thomai, & Aliaj, 2016, p. 16). Dy vite më vonë Tirana u pajis me një central elektrik të kufizuar. Ritmet e rritjes së ekonomisë dhe industrisë u ndien më shumë pas vitit 1934 kur u kapërcye edhe kriza ekonomike botërore.

Raporti Shqipëri-Itali nisi që në fundin e shekullit të XIX. Shqipëria u shndërrua në vendin e lakmuar ku përplaseshin interesat e kundërta të Austrisë dhe Italisë. Kjo e fundit, kishte filluar të shfaqte hapur interesin e saj ndaj vendeve të Ballkanit duke ndërhyrë në rivalitetin

austro-rus-otoman. Pas shpalljes së pavarësisë dhe njohjes nga shtetet e tjera të kufijve përfundimtar të territorit shqiptar, Shqipëria ishte një shtet i ri në arenën ndërkombëtare. Lufta dhe problemet politike në vitet 1920-1924 vazhdonin edhe pse Shqipëria ishte një vend autonom. Gjatë kësaj periudhë në Itali, Mussolini mori detyrën për të udhëhequr shtetin italian në vitin 1922, deri sa vendosi, në vitin 1925 diktaturën. Qeveria fashiste shfrytëzoi tolerancën dhe hapjen e mbretit Zog për të rritur ndikim e saj në ndërhyrjet ekonomike dhe ushtarake në Shqipëri.

Qeveria e Romës prej vitesh i kishte shtruar si detyrë e kishte punuar me këmbëngulje, përmes veprimtarive të ndryshme, që të sendërtonte në një kohë sa më të shkurtër italianizimin e fashistizimin e Shqipërisë. Po aq i rëndësishëm ishte dhe përfundimi i infrastrukturës kulturore, politike e ideologjike fashiste, e cila kishte rëndësi në përgatitjen e agresionit fashist. Në një shkresë sekrete, që Sestilio Montaneli i drejtonte Legatës Italiane në Shqipëri ishte “italianizimi, fashizimi dhe shballkanizimi i popullit shqiptar”, i cili duhej të fillonte me brezin e ri dhe të përfshinte shkallë-shkallë të gjitha shtresat e popullsisë (Akademia e Shkencave , 2007, p. 345).

### Kriza ekonomike botërore dhe industria shqiptare gjatë viteve 1930

Kriza ekonomike botërore, që nisi në vitin 1929, preku edhe Shqipërinë. Por, ndryshe nga vendet e mëdha, kriza që pllakosi Shqipërinë në këto vite, nuk u shkaktua nga mbiprodhimi kapitalist i brendshëm. Shumë kohë përpara se të shfaqej kriza ekonomike botërore, në Shqipëri pasuria monetare e vendit po pakësohej çdo vit, numri i të papunëve po rritej gjithnjë e më shumë dhe fuqia blerëse e popullsisë po ulej vazhdimisht (Akademia e Shkencave , 2007, p. 108).

Kriza ekonomike botërore e thelloi amullinë ekonomike të Shqipërisë sepse gjatë viteve 1930-1935 shtetet e tjera, për shkak të krizës financiare, I pakësuan blerjet e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Si rrjedhim eksportimi ra nga 14.9 milionë franga ari në 1928, në 4.3 milionë franga ari në 1934.

Vitet e krizës ekonomike botërore shënuan një etapë të re në trysninë që ndërmori kapitali Italian në ekonominë e Shqipërisë. Me gjithë kushtet e vështira, industria shqiptare mundi ta rimerrte veten pas vitit 1934 (Akademia e Shkencave , 2007, p. 110).

### Depërtimi ekonomik italian në Shqipëri - afrimi me Italinë dhe koncensionet në të mirë të saj

Me ngritjen e presidencës, A. Zogu krijoi një strukturë politike që e kishte nën kontrollin e tij. Kjo i dha mundësinë të përqendrohej tani në gjendjen e rëndë financiare të vedit dhe në sigurimin e një aleance të forte nga jashtë. Në kushtet e prapambetjes ekonomike të vendit, të dobësisë së kapitalit vendas dhe të pamjaftueshmërisë së kapaciteteve të tij financiare për investime në degët kryesore të ekonomisë, A. Zogu nuk i mbetej rrugëdalje tjetër për ti hapur rrugën zhvillimit ekonomik të vendit, veçse ti drejtonte sytë te ndonjë fuqi e huaj. Ai erdhi në përfundimin se ishte pikërisht Italia ajo që duhej të tërhiqej në ekonominë shqiptare.

Në mars të vitit 1925 qeveria e Tiranës lidhi një kontratë me grupin financiar që mori përsipër krijimin e “Bankës Kombëtare”, sipas së cilës grupi financiar duhej t’i gjente një hua shtetit

shqiptar. Në të vërtetë, pas tij ishte shteti italian dhe huaja u dha prej tij. Për dhënien dhe për administrimin financiar të huas, u krijua nga qeveria e Romës, "Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë" (SVEA), me të cilën qeveria shqiptare nënshkroi më 29 maj 1925 konventën përkatëse.

Huaja e dhënë ishte 50 milion franga ari, por nga një rivlerësim që iu bë liretës në vitin 1927, shuma e caktuar për Shqipërinë shkoi në 62.7 milion franga ari. (Francesco Jacomoni di San Navino, 1965, pp. 25-37) Kamata për këtë hua u caktua shumë e lartë dhe bëri që borxhi i shtetit shqiptar ndaj atij italian të rritej dhe të kthehej në një mollë sherri midis tyre. Këstet që do të merrte Shqipëria nga SVEA nuk ia u dhanë të plota duke mos respektuar një akt të kontratës, ndërkohë që kamatat duheshin paguar rregullisht.

Më 1927, kur qeveria shqiptare nuk ishte në gjendje të paguante këstin e parë të huasë, qeveria e Musolinit, për të forcuar më shumë pozitat në Shqipëri, mori përsipër t'i shlyente vet detyrimet e huas së SVEA-s. Shteti italian e shfrytëzoi këtë fakt për të mbajtur peng shtetin shqiptar dhe për ta detyruar atë të bënte lëshime të reja. Pas shumë diskutime dhe mosmarrëveshjesh, SVEA vendosi t'i kaloj të gjitha fondet në ndërtime rrugësh, urash, objektesh, skelash, fortifikimesh, si dhe për ndërtimin e disa pallateve qeveritare.

**Tirana, "Qyteti Kopsht" deri në vitin 1925**

Qytetet shqiptare, para Luftës së Parë Botërore, kishin një strukturë urbane zhvillimi shumë të ngjashme midis tyre (Baçe, Meksi, Riza, Karaiskaj, & Thomo, 1979, p. 397).

Vet pozicioni gjeografik i Shqipërisë, morfologjia e terrenit dhe prania e detit kanë kushtëzuar në një pjesë të mirë të qyteteve mënyrën e zhvillimit urban të tyre duke i drejtuar më shumë nga tiparet e një qyteti të lashtë dhe mesjetar. Fortifikimi i qyteteve dhe prania e mureve rrethuese ka qenë një mënyrë mbrojtjeje ndaj armiqve dhe pushtuesve të huaj, por ky element vihet re në jo pak qytete, si psh: Berat, Elbasan, Gjirokastër, Shkodër etj. Pushtimi osman prej 500 vjetësh la gjurmë shumë të thella dhe nuk lejoi një zhvillim të dukshëm në urbanistikë, arkitekturë dhe ekonomi në Shqipëri. Ndikimi oriantal otoman ishte i konsiderueshëm në në të gjithë territorin dhe qendrat urbane. Shpallja e Pavarësisë në 1912 solli ndryshime në dhe në konceptimin e zhvillimin e qyteteve. Formimi kulturor e fetar i shqiptarëve, sjellja sociale e tyre, qasja ndaj ndryshimit dhe zhvillimit ishin ndjeshëm të dukshme në vitet në vazhdim.

Qytetet shqiptare kishin një strukturë urbane të ngurtë dhe kaotike mesjetare, të ngjashme me skemat e qyteteve myslimane, ku mbizotëronin banesat private një deri në dy kate. Gjatë pushtimit osman nuk ekzistonin institucionet administrative për pajisjen me dokumentet e duhura për ndërtimin e një banese apo objekti çfarëdo, duke i përcjell këto problematika dhe në ditët e sotme ku pronarët e shtëpive të ndërtuara para 1912 nuk kanë asnjë dokumentacion që tregon vërtetësinë e pronës.

Tirana prej kohësh kishte një karakter piktoresk e të veçantë që ia jepnin lulishtet e shumta dhe oborret, gjë që i dedikohej dashurisë së banorëve për natyrën. Kjo ishte edhe pikënisja për një vizion të Tiranës të bazuar në karakterin e "qytetit lulishte", siç theksohej edhe në relacionin e planit rregullues. Njëkohësisht kjo lidhej edhe me rëndësinë që Tirana po fitonte

në shkallë kombëtare e rajonale, si edhe me nevojën për të konceptuar një qytet ndryshe nga ai ekzistues (organik), e ku të jetohej në mënyrë më moderne.

Dendësia e popullsisë, që është një element i rëndësishëm për vizionin e qytetit kopsht, do të garantohej përmes normave të shfrytëzimit të truallit dhe përdorimit të tipologjive të përshtatshme për zona intensive, gjysmë intensive dhe të shtrira, duke kombinuar kështu nevojat estetike, higjienike dhe ato praktike. Të gjitha këto dëshmonin se planifikimi i qyteteve Shqiptare filloi të zhvillohej mbi bazën e koncepteve pararendëse dhe vizioneve në shkallë të madhe.

Ky plan me karakteristika të qarta të një "qyteti kopsht", kishte gjithashtu edhe një ndarje të qartë të funksioneve, e po ashtu edhe të mundësive që krijonte për shtresat e ndryshme të popullsisë sipas të ardhurave ekonomike. Në këtë kuptim ky është i vetmi plan i hartuar në Shqipëri, i cili mbart një koncept të qartë të ndarjes së shtresave klasore: lagje banimi zotnish, lagje banimi për shtresën e mesme dhe lagje popullore.

## 2.2 Ndërhyrjet urbane dhe arkitektonike në Tiranë 1925-1944

Tentativat e para të hartografimit të Tiranës dhe sistemit të saj rrugor vihen re në periudhën e viteve 1917-1918 nga studiues austriakë. Në vitin 1923 u hartua plani i parë rregullues për qytetin nga inxhinierë dhe arkitektë austriakë ku synohej që struktura rrugore e Tiranës të korrigjohej e rregullohej sipas një konfigurimi më drejtkëndor, i cili duhet të gjente një përputhje sa më të madhe me rrjetin ekzistues, e po ashtu të ruante drejtimet e radialeve kryesore të origjinës së qytetit. Koncepti i tyre ishtë të krijonte një rrjet kudratik të pastër për hapësirat e lira. Ky plan udhëhoqi zgjerimin e rrugës së Durrësit, rrugës së Kavajës dhe të Barrikadave. Tirana ishte një qytet i vonuar në lidhje me ndërhyrjet infrastrukturore të zgjerimit të bulevardeve në raport me kryeqytetet e tjera të Evropës dhe rajonit. Rikualifikimi i qytetit sidomos i pjesëve Qëndrore përmes hapjes së akseve brenda pëlhurave ekzistuese, formimi i lagjeve të reja borgjeze, formimi i ishujve me forma kënddrejta rrethuar nga rrugë të gjera e me tipologji banesa shumëkatëshe, kishte filluar në Evropë që në vitet '800. Edhe konfigurimet drejtkëndore të propozuara për rritjen e lagjeve të reja të Tiranës në atë kohë ishin influenca e kësaj mënyre rritjeje të qyteteve evropiane.

"Pas ardhjes në pushtet të Ahmet Zogut (1925) politika e vendit u orientua drejt Italisë, së cilës iu kërkua ndihmë për rilevimin hartografik të disa qyteteve dhe për hartimin e planeve rregulluese të tyre" (Dhamo, Thomai, & Aliaj, 2016, p. 18).

Projektet urbane të Tiranës, si plani i parë rregullues i Brasinit, plani i dytë i realizuar nga Köhler, Frashëri e Di Fausto dhe plani i fundit i Bosios, kanë karakteristika të ndryshme midis tyre, të cilat vihen re në kompleksitetin e tyre (Vokshi, 2014, p. 284).

Tre arkitektët italian, Brasini, Di Fausto dhe Bosio i përkasin tre brezave të ndryshëm me 10 vjet diferencë nga njëri tjetri. Për më tepër, ata vijnë nga tre formime të ndryshme mbi teorinë e arkitekturës në botë për mënyrën se si konceptohet qyteti, duke përdorur, rrjedhimisht instrumenta të ndryshëm. Pika e përbashkët e tyre është qëllimi për të shfrytëzuar arkitekturën dhe urbanistikën për të komunikuar ideologjinë politike "Arkitektura, arti i shtetit" (Ciucci, 2002, p. 108).

Duke konsideruar punën e arkitektëve racionalist, të cilëve iu ngarkuan pak projekte nga veprat publike në panoramën e arkitekturës koloniale italiane, vlen për tu përmendur aktiviteti i arkitektëve të cilët patën mundësi profesionale më të mëdha në koloni si, Armando Brasini, Alberto Alpago Novello, Ottavio Cabiati e Guido Ferrazza dhe Florestano Di Fausto.

Këta profesionistë treguan një larmi të qasjes në territoret matanë detit duke krahasuar me arkitektët e tjerë italianë. Problematikave të këtyre vendeve, kaq të ndryshëm nga vendi i tyre, ata iu përgjigjën me instrumenta sipas formimit personal, duke u bërë pjesë e debatit Italian. Në vitet '20 ishin krijuar dy ryma të mendimeve kontradiktore, nga njëra anë pararoja nacionaliste, përfaqësuar nga "Lëvizja Moderne", nga ana tjetër tendenca "e moderuar", e përfaqësuar nga Rava, Piccinato, Pellegrini e Bosio.

Në punët dhe rezultatet finale të planeve rregulluese për Tiranën të arkitektëve si Brasini, Di Fausto dhe Bosio, ndikuan politikat dhe marrëveshjet e realizuara në ato vite në Shqipëri. Gjatë ndërhyrjeve të dy aritektëve të parë, Ahmet Zogu, në fillim president dhe pastaj mbret i Shqipërisë, pati një ndikim të ndjeshëm në zgjidhjet urbane dhe arkitektonike që ata jepnin për kryeqytetin shqiptar. Edhe pse ata ishin zgjedhur nga qeveria fashiste dhe financuar nga SVEA, duhej të përfshinin në vendimet e tyre Zogun duke marrë aprovimin e tij në pjesën më të madhe të projekteve dhe ideve. Në vitin 1939, pas pushtimit italian u krijua Zyra Qëndrore e Ndërtimit dhe Urbanistikës (Ufficio Centrale dell'Edilizia e l'Urbanistica dell'Albania) në Shqipëri. Për këtë arsye, Gerardo Bosio dhe bashkëpunëtorët e tij punonin në kushte më të favorshme dhe me më shumë liri në krahasim me arkitektët e mëparshëm. Faktori kryesor që ndikoi në projektet e tre planeve rregulluese të Tiranës ishte lëvizja demografike e njerëzve në atë periudhë. Numri i popullsisë në vitin 1920 prej 12 000 banorësh, shkoi në 45 000 banorë në 1930.

Për vite me radhë u diskutua dhe u hodhën hipoteza të ndryshme në lidhje me skenaret e mundshme ku do të bazohej Plani Rregullues i Tiranës. Në vitin 1939 u vendos që plani do të shfrytëzonte në interes të ekonomisë publike çdo gjë që ishte bërë më parë.

Gjurmët e arkitekturës italiane gjatë periudhës 1920-1940 për rikualifikimin dhe transformimin e kryeqytetit shqiptar përfaqësojnë ndërhyrjet më të rëndësishme të realizuara në Shqipëri. Momenti kur u punua dhe u hodhën idetë për hartimin e Planit Rregullues të Tiranës, gjatë viteve 1939-1943, është nga më të rëndësishmit në historinë e konsolidimit urban të qytetit të Tiranës. Hartimi i këtij plani përbënte qartazi një moment frymëzimi kur mendohej se shtysa drejt qytetit të madh ishte sinonim i mirëqenies dhe përmirësimit të kushteve të jetesës. Qyteti ishte vendi i mundësive të reja, i kapërcimeve dhe i hopeve cilësore në jetës, sidomos për një qytet si Tirana që ishte ende në fazat më fëmijërore.

**Plani Rregullues i Brasinit, 1925:**

Pas zgjedhjes së Tiranës si kryeqytet i Shqipërisë, sfidat për ta zhvilluar këtë qytet ishin shumë të mëdha. Duhej dizenjuar çdo gjë nga e para mbi një qytet të vogël tipik oriental ku struktura ekzistuese urbane përshtatej me rrjetin ekzistues. Ky plan u konceptua nga Armando Brasini në vitin 1925.

Ideja e Brasinit për qendrën e re të kryeqytetit shqiptar, ishte ajo e një ndërhyrje të konsiderueshmë radikale aksiale mbi strukturën urbane të qytetit, pra një prerje e fortë e drejtë, që do të shërbente si bulevardi kryesor i qytetit (Giacomelli & Vokshi, 2012, pp. 17-25). Kjo skemë aksiale mund të interpretohet edhe si një manifestim i fuqisë politike duke e lidhur me argumentimin që Kostov (Kostof, 2003) paraqet në librin "City Shaped" se bulevardi manifeston tiparet e një dominimi monocentrik. Në këtë Plan Rregullues aksi i bulevardit është në kontrast me qytetin ekzistues, i cili karakterizohet nga një strukturë organike labirinte. Edhe pse në fillesat e veta dhe konceptimet e para të bulevardit, ai ishte jashtë shkalle me kontekstin urban të qytetit, më vonë do të shndërrohej në drejtuesin e linjave kryesore të rakordimit të qytetit që do të zhvillohej rreth tij.

**Planet dhe ndërhyrjet e viteve 1926-1929**

Pas propozimit të Brasinit, në vitin 1926 u hartua një plan më tërësor për Tiranën, i cili materializonte për herë të parë në nivel qyteti idenë e Brasinit, për zhvillimin sipas një aksi kryesor. Autorët që dhanë kontributin e tyre për këtë plan ishin: inxhinieri shqiptar Eshref Frashëri, inxhinieri italian Castellani dhe ai austriak Weiss (ALiaj, Lulo, & Myftiu, 2003, p. 34).

Në vitin 1928, pas prishjes me arkitektin e njohur Brasini, mbreti Zog ngarkoi arkitektin austriak Hans Köhler dhe inxhinierin Skënder Frashëri për të hartuar një plan më të plotë për qytetin e Tiranës. Ky projek vazhdoi mbi punën e nisur nga Brasini dhe ishte plani i parë që përfshinte të gjithë territorin e qytetit, në shkallën 1:5000 dhe kishte qëllimin kryesor realizimin e një rrjeti infrastrukturor i domosdoshëm për zgjerimin e Tiranës. Një nga zgjerimet e qytetit propozohej të realizohej në pjesën jug-perëndimore të tij, zona e Tiranës së Re, ku dallohej qartë në plan (Plani i Tiranës së Re) rrjeti kuadratik i rregullt në një sipërfaqe tereni bosh të asaj kohe. Kjo mënyrë projektimi mundësonte krijimin e kopshteve të gjelbëruara me pemë duke formuluar peizazhin gjatë rrugëve dhe duke përcjell idenë e një "qyteti kopsht", i cili i përshtatej më së miri Tiranës dhe kulturës së vjetër. Rrjeti kuadratik që propozohej në plan, shtrihej dhe në pjesën veriore dhe veri-lindore të qytetit duke e vendosur këtë rrjet të rregullt ndaj rrjetit me rrugica të ngushta dhe plot kthesa, që ishin karakteristike për Tiranën e vjetër. Ky sistem kuadratik përshtatej sipas drejtimeve të trajektoreve historike hyrëse të Tiranës, të cilat në plan drejtoheshin dhe zgjeroheshin, duke i theksuar rëndësinë e rolit që ato mbartnin.

Idetë që u vazhduan dhe u mbartën nga planet e mëparshme ishin, ravijëzimi i aksit të bulevardit, që fillonte nga sheshi i pallatit mbretëror në jug e deri te sheshi "Skënderbej" në veri. Përgjatë kësaj hapësire u projektuan breza gjelbërimi dhe një qendër administrative, e cila fillonte nga sheshi "Skënderbej", në perëndim të pazarit të vjetër dhe vazhdonte gjatë bulevardit, duke përfundonte në jug, në sheshin e pallatit mbretëror. I njëjti plan i 1928, parashikonte edhe sistemimin e Lanës në drejtim pingul me aksin e bulevardit, me dy rrugë paralele që ndiqnin gjatësinë e lumit. Nga i gjithë ky sistemim u fituan edhe shumë terrene e sipërfaqe të reja, të cilat u përdorën për zona banimi.




*Figura 2-1. Plani i Tiranës së Re i 1928, Kohler. Burimi: AQTN*

Në vitin 1929 u hartua një plan në shkallën 1:5000, në të cilin u reflektuan disa ndryshime nga plani i 1928. Sipas këtij plani aksi bulevardit do të zgjatej më shumë ne drejtim të veriut, ku mbyllej në atë pikë me stadiumin e ri të propozuar. Gjatësia e aksit do të shkonte 2 km, duke nisur nga pallati mbretëror, përgjatë sheshit "Skënderbej" dhe në mbyllje me stadiumin. Në pjesën jugore bulevardi shtrihej në terrene boshe, por ndryshe ndodhte në pjesën veriore ku zgjatimi i tij përshkonte zona ekzistuese të qytetit, të cilat duhet të shembeshin.

Ky plan u përgatit nga bashkia në shkallën 1:5000 mbi bazën e bashkimit të dokumenteve dhe planeve kryesore të tre autorëve: plani i Frashërit; plani i qendrës nga Florestano Di

Fausto dhe plani për Tiranën e Re nga Kohler. Ky ishte i pari plan i vërtetë për Tiranën (Nepravishta & Thomai, 2020, p. 28). Pas përgatitjes së planit, ai iu nënshtrua shqyrtimit nga Komisioni Teknik i Ministrisë së Punëve Botore, i cili propozoi disa modifikime, të cilat morën më tej si përgjigje disa komente nga bashkia. Kjo e fundit i analizonte propozimet duke i konkretizuar me ndërhyrjet reale që duhet të realizoheshin në ndërtesat ekzistuese dhe jetën e banorëve të Tiranës.




*Figura 2-2. Plani Rregullues i 1929 me kufijtë e qytetit. Burimi: AQTN*

**Plani Rregullues i Florestano Di Fausto (Qendra e Tiranës)**

Mbreti Zog i kërkoi qeverisë italiane emrin e një arkitekti tjetër të ri në mënyrë që të jepte dhe ai kontributin e vet në projektet e nisura për Planin Rregullues të Tiranës dhe ndërhyrjet e tjera, për ndërtesat me rëndësi të veçantë në kryeqytet. Pas kësaj kërkese të ardhur, Mussolini i propozoi arkitektin roman Florestano Di Fausto, i cili vlerësohej shumë nga ai. Di Fausto me ndërhyrjet e tij në kolonitë e Afrikës së Veriut konsiderohet edhe sot si arkitekti kryesor i arkitekturës matanë detit të asaj periudhe (Santoianni, 2008, p. 93). Në 1928, me përfshirjen e tij në projektet shqiptare, Di Fausto nisi të projektonte disa variante për qendrën e Tiranës, për "Sheshin Skënderbej", të cilat vazhduan për 3 vjet deri në vitin 1931 ku u aprovua projekti përfundimtar.

**Pushtimi italian në Shqipëri dhe ndikimi i tij**

Në aspektin historik periudha 1939-1943 ka shënuar ngjarje të rëndësishme, të cilat kanë lënë gjurmë në të gjithë botën duke u reflektuar patjetër dhe në arenën shqiptare. Nga pikëpamja e projekteve dhe vizioneve në shkallë urbane, Tiranës nuk i kanë munguar në këto vite, kjo dhe për shkak të politikave të atilla që u ndoqën në atë periudhë. Në vitin 1939 Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste dhe pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore ajo vazhdoi të ishte shtet më vete por u bashkua me Italinë nën kurorën e mbretit Viktor Emanuel III.

Drejtimi i punëve të jashtme shqiptare u kthye kompetencë e Ministrisë së Jashtme Italiane dhe vendi i shqiponjave u shndërrua në një provincë italiane (Biaggini, 2005, p. 128).

Pas pushtimit italian dhe ndryshimeve institucionale që ndodhën në vend, doganat, shërbimi diplomatik, konsullor, sistemi gjyqësor dhe të gjitha burimet natyrore, përfshi ato të naftës u vunë nën kontrollin e Italisë. Qëllimi kryesor i shtetit italian ishte të kishte një ndikim sa më të madh në Shqipëri, të merrte mbështetjen për praninë e saj këtu, të ulte armiqësinë e banorëve për projektet mussoliniane, të gjente toka të reja për të kolonizuar dhe mbi të gjitha të shfrytëzonte burimet natyrore dhe lëndën e parë shqiptare.

Zhvillimi i mirëfilltë urban në Shqipëri nisi me Planin rregullues të Tiranës dhe mbi të gjitha me krijimin e Zyrës Qëndrore të Edilicjes dhe Urbanistikës (Ufficio Cendtrale per Edilizia e Urbanistica in Albania), e cila do të drejtohej nga arkitekti italian Gherardo Bosio (Cresti, Billeri, & Busi, 1966, p. 75).

Rezultat i investimeve italiane në Shqipëri ishte ndërtimi i objekteve publike, punishteve dhe objekteve industriale, sidomos në Tiranë. Si pasojë u krijuan vende të reja pune dhe u rrit ndjeshëm niveli i jetesës. Përveç ushtarakëve, vendi ynë priti dhe shumë punëtorë nga Italia, të cilët do të punonin për të ndërtuar rrugë e për të zhvilluar infrastrukturën në Shqipëri. Projektet urbane të Tiranës dhe të qyteteve kryesore shqiptare do të ishin pjesë e vizioneve të një perandorie të madhe, e cila do kontribuonte në zhvillimin e Shqipërisë.

Në kohën e mbretit Zog u kalua nga ndërtimi spontan i mëparshëm në një planifikim më sistematik nëpërmjet bazave të para të planifikimit në Tiranë, por gjatë periudhës së pushtimit italian, planifikimi i të gjitha qyteteve të Shqipërisë u bë nën ndikimin tërësor të Italisë. Kjo ishte dhe mënyra më e mirë për të qenë pjesë dhe për të zbatuar teknika dhe instrumente ligjor që vinin nga një traditë shumë më e konsoliduar në fushën e arkitekturës dhe

urbanistikës. Planet Rregulluese të Tiranës dhe qyteteve kryesore, të hartuara nën ndikimin italian nuk arritën të zbatoheshin të gjitha për shkak të ndryshimeve politike që ndodhën pas Luftës së Dytë Botërore, por ato patën një rëndësi të jashtëzakonshme për periudhat që pasuan, më shumë se për vet kohën. Faza e planifikimit mori fund me kapitullimin e Italisë fashiste në shtator të 1943 kur vendi u pushtua nga gjermanët.

**Plani i përgjithshëm i Tiranës i viti 1939-1943 (Bosio, Lambertini, Poggi)**

Plani Rregullues i Tiranës, i cili nisi të hartohej në vitin 1939 dhe mori formën përfundimtare në janar të 1943 u hartua në dy faza:

1. Faza e parë ishte hartimi i planit në vija të përgjithshme (me këtë term relacioni i planit nënkupton atë që më vonë quhej "projekt ide" e planit). Kjo fazë e planit përfundoi në Tetor të vitit 1939 dhe u miratua me Ligjin N. 71 të datës 07. 03. 1940.

Ky plan ishte Hartuar nga Zyra Qëndrore e Edilicjes dhe Urbanistikës së Shqipnis1. Hartimi i Planit u drejtua nga arkitekti Italian Gherardo Bosio në rolin e Këshilluesit të Parë dhe Drejtorit të Zyrës Urbanistike ("Ufficiale per L'edilizia e L'urbanistica Dell'Albania") i cili parashtroi konceptet e planit në një relacion që i bashkëlidhej këtij Plani. Dokumentacioni grafik i kësaj faze të planit paraqitej në shkallën 1:5000 (Dhamo, Thomai, & Aliaj, 2016, p. 61). Gjithë zhvillimet në fushën e projektimit dhe ndërtimit të regjimit fashist ndiqeshin dhe drejtoheshin nga Zyra Qëndrore e Ndërtimit dhe Urbanistikës së Shqipërisë.

2. Faza e dytë e planit ishte studimi i Planit rregullues definitiv (përfundimtar) i cili u miratua më 31 Kallnuer 1941.

Mbi bazën e këtij studimi të vitit 1941 u hartua plani rregullues definitiv nga Zyra Qëndrore e Edilicjes dhe Urbanistikës së Shqipnis, i cili në fund mban datën e muajit Kallnuer 1943. Pas vdekjes së Gherardo Bosio-s, Ivo Lambertini u vendos në rolin e arkitekt projektues dhe Ferdinando Poggi në rolin e arkitektit këshillues. Dokumentacioni grafik i kësaj faze të planit paraqitej në shkallën 1:2500 (Dhamo, Thomai, & Aliaj, 2016, p. 61).

Rregulllorja e urbanistikës për Planin Rregullues të Tiranës përcaktonte normat dhe standardet e distancave të objekteve, gjeresitë e rrugëve, lartësitë e kateve në raport me rrugët, vijat e ndërtimit, mundësitë e tërheqjes së kësaj vije, përdorimet e kateve nëntokësore, kateve përdhe dhe kateve sipër. Të gjithë këto tregues ndihmonin në realizimin dhe konkretizimin e koncepteve që paraqiteshin tek plani rregullues.

Në relacion trajtohet një problematikë e cila lidhet me rritjen e popullsisë si rezultat i dy faktorëve: së pari, ardhja e një numri të paparashikueshëm popullsie prej shpalljes kryeqytet të Tiranës duke krijuar një krizë banesash në qytet, së dyti, bashkimi i Shqipërisë me Italinë dhe bashkëpunimet e vazhdueshme të dy shteteve solli ardhjen e shumë italianëve me banim të përhershëm apo të përkohshëm në Tiranë. Plani Rregullues dhe hartimi i tij merr parasysh fenomenin e rritjes së mundshme të popullsisë dhe për shumë vite në vazhdim. Në vitet pas hartimit të planit numri i popullsisë së Tiranës shkoi nga 35 000 në 50 000 banorë, një rritje kjo e menjëhershme.

[1] Në këtë rast emërtimi i zyrës është përdorur siç quhej në gjuhën zyrtare të kohës.




*Figura 2-3. Plani Rregullues 1939-1943. Burimi: AQTN*

Nëpërmjet këtij plani, Tirana do të kalonte nga një qytet organik në qytetin e organizuar dhe të projektuar. Plani si një instrument tipik që lindi për t'i dhënë zgjidhje problemeve që shtronte shoqëria industriale, u mbart në Shqipëri nga një vend si Italia, ku marrëdhëniet kapitaliste dhe zhvillimi shoqëror ishin në një fazë shumë më të zhvilluar.

Plani Rregullues i 1939, i cili përshtatet me konceptin e shpjeguar nga Taylor dhe Williams (Taylor & Williams, 1982) është një lloj "fotografimi" i së ardhmes së qytetit duke shpjeguar se si do të duken përdorimi i tokës dhe skema e qarkullimit rrugor.

Plani mbështet propozimet në lidhje me zhvillimin fizik të ardhshëm të qytetit mbi parashikimet e popullsisë, duke supozuar në një shpërndarje optimale të dendësisë së saj në qytet. Në mënyrë të ngjashme parashikohej edhe rritja ekonomike e pritshme si dhe nevojat për territore në perspektivën e afërt dhe të largët që lidheshin me këtë rritje ekonomike.

Në krahasim me planet e mëparshme të viteve 1923-1931 ku ishte vepruar me hartime të pjesshme, plani i viteve 1939-1943 shkon përtej përcaktimit të kufijve apo dhe paraqitjes së sistemit rrugor. Ky plan merrte në konsideratë dhe planet e hartuara të mëparshme, të cilat vlenin ende, por edhe projektet e pjesshme duke i integruar të gjitha këto në një vizion më të

gjerë për zhvillimin e Tiranës. Plani është vizionar në parashikimin e rritjes së automobilave për të ardhmen duke propozuar zgjerim rrugësh, në përputhje me vizionin e ritjes së qytetit dhe trafikut të mjeteve. Një parashikim tjetër i planit ishte dhe transporti mbi shina i cili deri në atë kohë nuk ekzistonte në Shqipëri.

Parashikimet e planit bëheshin nën një kujdes të lartë ndaj mënyrës se si do të veprohej me menaxhimin e pronave. Në lidhje me këtë çështje u tregua mjaft kujdes duke filluar që nga zgjedhja e vizionit në shkallë të madhe, e deri tek ndërhyrjet në shkallë të vogël në mënyrë që propozimet e planit të mos cënonin vlerat e pronave apo të investimeve të kryera më parë në qytet si nga entet publike ashtu edhe nga individët privat. Në këtë mënyrë u bë përpjekja që në parashikimet e planit të respektoheshin sa të ishte e mundur përshtatja me interesat ekzistuese kur këto nuk binin në kundërshtim me inkuadrimin e ardhshëm sipas propozimeve të Planit.

Në një nga kapitujt e planit theksohet se *"Qyteti asht nji organizëm ekonomik dhe ... gjithsija e vet, rruga, shtëpija, fabrika, zyra, transporte, asht nji vegël ... qëllim i parë asht me bamë me lëviz mirë dhe ekonomikisht, duke mos u dukun vetem e bukur"* (relacion p.p. 14)2. Kjo nënkuptonte se qyteti nuk shihej vetëm si një organizëm që duhet të ishte i bukur, por edhe të jetonte ekonomikisht, duke bashkëpunuar me banorët në lidhje me interesat e tyre dhe mundësitë e kontributit të tyre për zhvillimin e qytetit bazuar në parcelizimin e planit.

Nga leximi i vëmendshëm i relacionit të planit vihen re dy vizione hapësinore të ndryshme që parashtroheshin për zhvillimin e Tiranës.

- Skema lineare, e cila e shkëpuste Tiranën e re që do zhvillohej me qytetin historik.
- Skema koncentrike, e cila bazohej në zhvillimet e vjetra historike e duke rritur me tej zhvillimin e Tiranës.

Të dyja këto skema e kishin vizionin të bazuar në idenë e "qytetit kopsht".

Momenti kur u punua dhe u hodhën idetë për hartimin e Planit Rregullues të Tiranës, gjatë viteve 1939-1943, është nga më të rëndësishmit në historinë e konsolidimit urban të qytetit të Tiranës. Hartimi i këtij plani përbënte qartazi një moment frymëzimi kur mendohej se shtysa drejt qytetit të madh ishte sinonim i mirëqenies dhe përmirësimit të kushteve të jetesës. Qyteti ishte vendi i mundësive të reja, i kapërcimeve dhe i hopeve cilësore në jetës, sidomos për një qytet si Tirana që ishte ende në fazat më fëmijërore.

### Rregullorja e Planit Rregullues

Në hartat e Planit Rregullues përcaktohej mënyra e ndërtimit të godinave në buzë të rrugës dhe tërheqja e tyre. Hartat paraqisnin numrin maksimal të kateve në raport me tipat e ndryshëm të rrugëve. Në zhvillimin altimetrik ndërtesa karakterizohej në disa raste nga tarracat e mbingritura apo mbulime/shtesa me struktura te ndryshme me kusht qe 1/8 e sipërfaqes së përgjithshme të mbuluar të ndërtesës të mos kalohej. Tejkalimi i lartësisë ishte kompetencë e autoriteteve në rast se objekti kishte funksion publik, industrial apo përmendore. Harmonizimi arktektonik respektohej dhe zbatohej me rigorozitet.

---

[2]*Relacioni i Planit Rregullues,* i sipërcituar. Kapitulli:*Konceptet e drejtimi i studimevet të planit rregullues*

Në rregullore paraqiteshin edhe normat lidhur me distancat në varësi të numrit të kateve. (Neni 14 Rregullorja Edilicia: distanca midis objekteve 1 katëshe ishte 6 metra, ndërsa ndërmjet ndërtesave 2 katëshe kjo distance dyfishohej). Dendësia e banimit të zonës (e dendur ose gjysmë e dendur) dhe gjeresia e rrugës përcaktonin gjithashtu gjatësine e zhvillimit të ballit të ndërtesave. Shembull për zonat e dendura dhe gjysmë të dendura eshte rasti i ndërtesave të vecuara ku kjo gjatësi varionte mes vlerës së gjerësise së rrugës dhe dyfishit të kësaj gjerësie duke shtuar këtu 2/5 e kësaj shumë për rrugë me gjerësi 20 metra. Nëse gjerësia e rrugës tejkalonte 20 metra, balli i ndërteses nuk duhej të varionte mes 24 metra dhe 60 metra gjatësi.

Zonat gjysmë të dendura, parcelat parashikonin si hapësirë oborri ose të gjelbërt 1/3 e sipërfaqes, ndërsa në zonat me dendësi të ulët kjo hapësirë mjaftonte të ishte në vlerën e 4/5 të parcelës. Objektivi kryesor ishte "qyteti kopsht" në respektimin paralel të nevojave urbane, trafikut dhe vlerave estetike të qytetit. Rregullorja lë gjurmë nëpërmjet hartimit të çështjeve të cilat "impononin" kulturën urbane e cila edhe sot mungon.

Neni 28, 30, 31 përcaktonin edhe vlerat e thellësisë së parcelës e cila duhej të ishte jo më e vogël se 16 metra për ndërtesa në buzë te rrugës dhe më shumë se 22 metra për ndërtesa të tërhequra nga rruga.

Rregullorja gjithashtu parashikonte një sipërfaqe në shërbim te portierit apo edhe banesë për këtë të fundit (neni 10) nëse banesa kishte më shumë se 6 apartamente. Shembulli i nenit 10 për zhvillimin e parcelave brenda tokave të izoluara, që do të thoshte se mungonte dalja në rrugët publike, përjashtonte cënimin e parcelave fqinje, kërkonte theksimin e hyrjes dhe aksesit në parcelë si nga rrugët kryesore ashtu edhe nga ato dytësoret. Një kulturë e tillë kujdesi mbetet unike për këtë tipologji projektimi dhe hartimi rregulloreje madje ende e "huaj" për mënyrën e projektimit të sotëm. Rregullorja përcaktonte qartë lartësitë e mureve rrethues të cilat nuk tejkalonin lartësinë prej 2,2 metra dhe më tej mund të vazhdohej lartësimi me kangjella.

Një kategorizim tjetër ishte sipas zonave në Tiranë, shembulli nga Lana deri tek shtëpia e Fashos ku ndërtimet do të arrinin lartësinë e 6 (gjashtë) kate maksimalisht, distanca ndërmjet objekteve deri në 45 metra dhe prania e hapësirave të gjelbra midis tyre. Zona në lindje dhe në veri të qytetit. Po ashtu, lagja lulishte me vila në lindje të qytetit dhe në veri të zonës sportive dhe lagja në jug deri ku arrinin kufijtë territorial të parashikimeve të planit rregullues; apo lagja me "karakter zengjin" 3 (rregullorja, p.p. 20, neni 46) në jug-perëndim të qytetit (në veri të shtëpisë së Fashjos e deri në zonën sportive) ku mund të bëheshin ndërtime të vetmuara jo më shumë se tre kate mbi tokë, parcelat do të kishin sipërfaqe jo më të vogël se 1200m2,nga e cila,sipërfaqja e mbuluar nuk do të kalonte 1/8 e sipërfaqes së përgjithshme.

Zonat me standarde te ulëta si p.sh zonat popullore në veri, jug-perëndim të qytetit, karakterizuar me nderime deri në 2 kate mbi tokë ngriheshin me distancë minimale 5 metra nga njëra-tjetra dhe materiali i ndërtimit (qerpiçi në kombinim me themele në tullë, gur, ose çimentoje të përzier me rërë) përcaktohej në rregullore.

---

[3]*Rregullore Urbanistike,* e sipërcituar. Kapitulli V: Norma të veçanta

Plani rregullues i formuluar bazuar në një ndarje të qartë shoqërore dhe etnike , sipas të cilës edhe organizimi vendbanimit të komunitetit Rom organizohej në pjesën perëndimore të qytetit buzë Lanës, dhe zona tjetër po për këtë komunitet në veri të Tiranës. Lartësia ashtu si dhe për zonat të tjera përcaktohej në rregullore ku ndërtesat nuk do të kalonin lartësinë e 2 kateve, lartësia e katit përdhe niste nga 0.3 metra nga niveli i rrugës, katet e kishin lartësinë të përcaktuar duke përcaktuar vlerën minimale = 2.8 metra , materiali i ndërtimit do të ishte qerpiçi, distanca nga rruga 4 m dhe distanca minimale mes dy objekteve 3 metra e cila ishte e mirë përcaktuar në rregullore.

### Ndikimi dhe gjuha e përdorur në Tiranë – analizë arkitektonike

Në fillim të shekullit të XX, pothuajse në të gjithë Evropën po humbiste shprehja historiciste në arkitekturë duke i lënë vendin lëvizjes moderne, apo e formuluar ndryshe lëvizja e formave të reja të interpretimit të gjuhës historike. Framton (Frampton, 2007) thekson në librin e arkitekturës moderne se tre ishin qasjet kryesore në fillim të atij shekulli: së pari, Beaux-Arts (klasicizmi evropian); së dyti, “New Tradition” (tradita e re) ku sipas autorit përfshihet arkitektura zyrtare e pushteteve, të cilëve “modernizimi” i gjuhës historike u nevojitej për ta përdorur arkitekturën dhe urbanistikën në ndihmë të përfaqësimit të shtetit. Kjo rrymë u përhap ndjeshëm në vende si Italia fashiste, Gjermania, Bashkimi Sovjetik etj. Një projekt përfaqësues i kësaj rryme në Shqipëri ishte projekti i Brasinit i 1925, projekti i sheshit të ministrive, së bashku me variantet e shumta dhe projekti përfundimtar i Di Faustos. Ato përfaqësonin mënyrën e projektimit e cila krijonte madhështi përmes një gjuhe historike dhe të mbingarkuar.

Në konkluzion të krijimit dhe zhvillimit të Tiranës të atyre viteve, bazuar në planet rregulluese, të cilat ndoqën njëra-tjetrën mund të shkruajmë se: vizionet e Tiranës, bazuar në konceptin e “qytetit linear”dhe “qytetit kopsht” u analizuan në fazat fillestare të planit rregullues të vitit 1939, por ato ishin të njohura në arenën ndërkombëtare, prej më shumë se katër dekadash. Në këtë aspekt mund të themi se pavarësisht distancës kohore nga origjina e mendimeve teorike që frymëzuan dy vizionet, që u krahasuan për planin rregullues të tiranës, ato ishin ende nga konceptet më të përhapura e më të përdorura të asaj kohe e të periudhës në vazhdim. Si në skemat lineare dhe ato satelitore, motivi i shkëputjes së qytetit të ri nga bërthama historike e vjetër, nxitej nga rritja e lartë e numrit të popullsisë në fazën e industrializimit të qyteteve dhe nga pamundësia e qendrës historike për të përballuar këtë fluks rritjeje të menjëhershëm. Skema linare bazohet në zhvillimin e infrastrukturave të reja dhe të fuqishme si: hekurudhat, autostradat, etj, në mënyrë që të mund të lidhen qytetet me njëri-tjetrin dhe të realizojnë zhvillime dinamike.

Në Tiranë u zhvillua skenari i cili propozonte zhvillimin e qytetit brenda skemës të përcaktuar prej kohësh nga ndërtimet historike. Shpërndarja përreth bërthamës kryesore çonte drejt zgjidhjeve të detyrueshme radiocentrike në raport me skemën e qytetit. Kjo zgjidhje, rriste vlerën e pronave ekzistuese dhe plani do të shfrytëzonte në interes të ekonomisë publike çdo realizim të mëparshëm. Me realizimin e kësaj skeme, kushtëzimi i qytetit drejt karakterit me një qendër të vetme, plani trajtonte dhe problemin e trafikut në të ardhmen, i cili do të theksohej sa më shumë të rritej popullsia.

# SFONDI HISTORIK

# BANESAT E PERIUDHËS 1925-1943 NË EVROPË 3

# 3. SFONDI HISTORIK. BANESAT E PERIUDHËS 1925-1943 NË EVROPË

## 3.1 Formimi i qyteteve industriale

Historia e urbanistikës moderne është një histori e fakteve sepse ndryshimet e shkaktuara gradualisht nga revolucioni industrial nëpër qytete e fshatra dalin në pah e konceptohen si probleme vetëm më vonë, kur dukuritë ndikuese në to bëhen mjaft të mëdha. Një nga ndryshimet më vendimtare dhe të rëndësishme është rritja e popullsisë e cila vjen edhe si rezultat i rritjes së lindjeve dhe nga ulja e vdekshmërisë (Benevolo, 2011, p. 13).

Karakteristikë e qytetit antik ishte ndryshimi shumë i ngadaltë që ai pësonte, saqë në çdo moment mund të konsiderohej i palëvizshëm për një kohë të gjatë. Të sistemoje një shesh, një lagje ose një qytet të tërë nënkuptonte të imponoje, një herë e mirë, një formë të saktë arkitektonike, të aftë që të pranojë pa modifikime zhvillimet e ardhshme arkitektonike; me fjalë të tjera, nënkuptonte aplikimin e përshtatjes më të pranueshme me një pamje praktikisht të pandryshuar, në një realitet që lëviz shumë ngadalë.

Revolucioni demografik e industrial kishte transformuar rrënjësisht shpërndarjen e banorëve në zonat e banimit dhe mangësia e vendbanimeve filloi të ndihej shumë, në mungesë të masave të përshtatshme të kontrollit. Familjet që braktisën fshatin dhe u dyndën në përqendrimet industriale, u strehuan ose në hapësirat bosh brenda lagjeve të vjetra, ose në ndërtimet e reja në periferi, që shpejt u shtuan duke formuar lagje të mëdha përreth qëndrave të vjetra.

Në qoftë se do të kthehemi shumë mbrapa në kohë dhe të shohim se çfarë ka ndodhur në shekullin e XVIII do ta kemi më të lehtë të kuptojmë arsyet e ndryshimeve të mëdha në shekullin e XIX. Në fillimet e viteve 1800 gjendja e banesave dhe ndërtimeve në Angli ishte kaotike dhe me kushte jetike shumë të këqija për vet banorët. Ndërtimi i shtëpive pa kurrfarë plani ishte shumë e dëmshme për banorët sepse e vështirësonte shumë ajrosjen sepse ishte një sistem ku punëtorët mbylleshin në oborre të brendshme të rrethuara nga të gjitha anët me ndërtesa, duke mos pasur asnjë qarkullim ajri. Më vonë lindi një tjetër sistem ndërtimi, system që sot përdoret nga të gjithë. Një sipërmarrës ndërton njëherësh një rrugë të tërë ose dy-tri rrugë, të cilat vendosen si më poshtë: në radhën e parë të rrugës qëndrojnë banesat e rangut më të lartë, të pajisura me derë e një oborr të vogël dhe prapa murrit të këtyre oborreve gjendet një rrugicë e ngushtë që është e mbushur me ndërtesa nga të dyja skajet. Pas këtyre banesave vjen një radhë tjetër e tretë e cila ka dalje në rrugën e sipërme. Në këtë mënyrë, me një system të tillë sigurohet një ajrim mjaft i mirë.

Urbanistika moderne nuk është vetëm një përpjekje për të përfaqësuar vizualisht ngjarjen e revolucionit industrial, duke i transferuar aspiratat e tij në organizimet hapësinore, por gjithashtu vihet konkretisht në rolin e një prej faktorëve që bashkëpunojnë në ndërtimin e një komuniteti demokratik (Benevolo, 2011, p. 48).

Në fund të shekullit të XIX, kryeqytetet e mëdha evropiane dhe qytetet industriale periferike u rritën në numër banorësh, nga një minimum prej tre deri në 10 herë më shumë, duke nxjerrë në dukje paaftësinë e “sistemit” për të zgjidhur, apo edhe vetëm për të filluar zgjidhjen e pjesshme të strehimit (Hall, 1966).

Fenomeni i mungesës së banesave lind me zhvillimin industrial dhe ka të bëjë me kushtet e jetesës së pjesës më të madhe të popullsisë ku përfshihen kryesisht punëtorët.

Në vitin 1872, Engels publikoi tre artikuj në Volksstaat me temën "çështja e strehimit", të cilat nuk do të pasqyrohen menjëherë në praktikën politike të lëvizjes së punëtorëve, por do të pastrojë reformizmin borgjez dhe do të bëhet një instrument veprimi (dhe në mënyra shumë të ndryshme nga sa pritej) vetëm me revolucionin sovjetik (Engels, La questione delle abitazioni, 1950).

Deri në atë momet, krahu komunist i lëvizjes punëtore nuk i kishte kushtuar rëndësi problemeve të strehimit popullor ose ekonomik, duke i konsideruar si probleme të shoqërisë moderne, si një zgjidhje të disa "të këqijave" (siç janë ato të mbipopullimit, të ashtuquajturat lagje popullore, mungesa e shërbimeve dhe pajisjeve, etj.) brenda shoqërisë ekzistuese, zgjidhje nga të cilat shoqëria do të gjente një ekuilibër dhe unitet të ri (Aymonino, 1971, p. 10).

Engels ngre në mënyrën e duhur problemin: *"Si të zgjidhim problemin e strehimit? Në shoqërinë e sotme ajo zgjidhet në të njëjtën mënyrë si zgjidhet një problem tjetër shoqëror, me ekuilibrin ekonomik, që vendoset pak nga pak midis ofertës dhe kërkesës. Është kjo zgjidhje e cila vendos problemin përgjithmonë në tapet. Mënyra se si revolucioni shoqëror do të zgjidhte këtë problem nuk varet vetëm nga rrethanat e kohës dhe vendit, por lidhet edhe me çështje që shkojnë shumë më tej, ndër të cilat më kryesorja është ulja e kontrastit midis qyteti dhe fshatit. Meqënëse ne nuk kemi pse të përfaqësojmë sistemet utopiste për organizimin e shoqërisë në të ardhmen, do të ishte e pakuptimtë të ndalemi në të. Një gjë është e padiskutueshme: se sot në qytetet e mëdha, tashmë ka shtëpi të mjaftueshme për të korregjuar menjëherë "mungesën e banesave" reale me kusht që këto shtëpi të përdoren në mënyrë racionale"* (Engels, Zur Wobnungsfrage, 1872)4.

Gjatë një gjysëm shekulli, prej 1872 e deri në vitin 1929 u zhvilluan ide dhe zgjidhje të ndryshme, të cilat përmbajnë elementë të përparimit dhe të një kërcimi politik e kulturor. Ato mund të verifikohen saktësisht nga planifikimi teknik dhe ekonomik që u realizua në atë periudhë sepse vetëm një vend socialist, ku pronësia private është hequr, mund ta realizojë.

Para se të shpjegojmë rëndësinë e kongreseve të Frankfurtit dhe Brukselit (CIAM), vlen të shqyrtohen tre përvoja që në periudhën paraardhëse (e cila shkon nga 1918 në 1930) janë përpjekur të lidhin, pa arritur plotësisht sukses, një qasje politike ndaj problemit të strehimit me një program ose me eksperimente të pjesshme në vendosjen e kushteve për zgjidhjen e tij:

### Përvoja vjeneze

Kur flasim për "arritjet e Bashkisë së Vjenës" ose "banesat e punëtorëve të Bashkisë së Vjenës" nënkuptojmë atë program të gjerë dhe ambicioz të zhvilluar nga Bashkia e Vjenës midis viteve 1920 dhe 1934 për të ngritur dhe zgjidhur çështjen e strehimit të punëtorëve. (Aymonino, 1971, p. 13)

[4] Në vitin 1872 Engels botoi tre artikuj të cilat flsinin për problemin e banesës dhe si zgjidhej ai sipas tij. Këto artikuj janë përkthyer në italisht në vitin 1950 me titullin "La questione delle abitazioni"

Engels nuk e konsideronte problemin e strehimit të punëtorëve si një problem të veçantë dhe të ndarë nga të gjitha banesat e një qyteti të caktuar, duke hedhur poshtë tezën filantropike të ekzistecës së një problemi të veçantë, të izolueshëm dhe të zgjidhshëm në vetvete të banesave të punëtorëve, duke siguruar kështu një platformë politike për një interpretim të problemit për të gjithë qytetin. Kjo do të thotë të bashkosh kontradiktat që ekzistojnë midis qytetit “nën model” dhe qytetit borgjez, në perspektivën e një transformimi socialist të shoqërisë.

Banesat e realizuara nga Bashkia e Vjenës nuk janë një zgjidhje universale e banesës ekonomike dhe as nuk prezantohen me zgjidhje konkrete, si modele të afta për t’iu përgjigjur pyetjeve sociologjike-ekonomike.

“Höfe”-të vjeneze nuk kanë lënë shumë gjurmë në historinë e arkitekturës botërore, por në të vërtetë u kthyen më shumë si një simbol politik i rezistencës së dëshpëruar të punëtorëve ndaj fashizmit (Collotti, pp. 387-432).

Të gjitha ndërtesat e bashkisë vjeneze janë më të rëndësishme se ato të Frankfurtit. Ato janë tipologjikisht shumë të ndryshme, gjë që justifikon mire emrin e tyre “höfe” – oborre. Fasada në pjesën e jashtme shpesh ka një pamje të fortesës, kurse fasada më e vërtetë është ajo nga pjesa e oborrit të brendshëm, shpesh i realizuar si park. Nga ana tjetër “höfe” janë në traditën vjeneze dhe u ndërtuan nga kompani private para vitit 1914 (Lavedan, 1952, pp. 369-370).

Deri në vitin 1918 rregullorja e ndërtimit në Vjenë bazohej në një dekret të 1883, i cili bazohej në disa dekrete më të hershme që datonin deri në 1829. Apartamenti tipik i punëtorit Vjenez, ardhur si rezultat i përqindjes së lartë të shfrytëzimit të ndërtimit, përfshinte një dhomë përafërsisht 4.5-5.5 m², me kuzhinë, duke parë në pjesën e brendshme të shtëpisë në një ballkon të ngushtë, të mbuluar, i cili shërbente nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë nga këto apartamente. Përgjatë këtij ballkoni ishin vendosur dhe banjo, të cilat shfrytëzoheshin nga dy ose më shumë apartamente secila dhe një rubinet uji vendosej në secilin kat për tu përdorur nga të gjithë. Dy nga apartamentet në kat kishin edhe një dhomë tjetër të vogël me dritare që shërbente si kabinet.

Banesa e një punëtori vjenez shpjegohej nga ekonomisti Eugen Philippovic në këtë mënyrë: Banesa është vetëm një strehim ndaj motit, një vend për të pasur natën një shtrat, që në një hapësirë të vogël, pa ajër, pa pastërti, pa paqe dhe ku njerëzit janë të shtypur, i lejon vetëm pak pushim një trupi komplet të rraskapitur. Mungon absolutisht çdo gjë që jemi mësuar t’i konsiderojmë si bazë të një jete të shëndetshme të klasës së mesme si: jeta e pavarur e familjes, kënaqësitë e veçanta të nevojave themelore të jetës së përditshme, kujdesi për të sëmurët dhe ata që kanë nevojë për kujdes të veçantë, ruajtja e modestisë duke ndarë gjinitë, fshehja e marrëdhënieve seksuale tek fëmijët nga prindërit dhe puna edukative e prindërve ndaj fëmijëve të tyre në orë pushimi dhe rekreacioni. Këto vende nuk ofrojnë rehati dhe nuk kanë asnjë tërheqje për ata që kthehen të lodhur nga puna. Kushdo që ka lindur në këto vende ose shkon atje është i destinuar të degjenerojë e të vdesë, si në trup dhe në mendje, ose të bëhet një brutal (A. Gulick, 1948, pp. 407-504).

Nga viti 1890-1900 pati një rritje të menjëhershme të popullsisë së Vjenës, e cila detyroi në mënyrë të drejtpërdrejtë të kalohej nga sondazhet dhe publikimet të tipit filantropik, në diskutime në rang politik. Interesi i Këshillit të Bashkisë së Vjenës për zgjidhjen e problemit

të strehimit për të pastrehët dhe punëtorët ishte i ulet dhe pothuajse in ekzistent. Kjo, për arsye sepse më shumë se gjysma e pjesëtarëve të këtij këshilli ishin pronarët e shtëpive, duke përfituar të ardhura të konsiderueshme nga mbledhja e qërave. Edhe pse në vitin 1918, pas Luftës së Parë Botërore, Bashkia mori shumë prona e sipërfaqe për ndërtimin e shtëpive të reja, këto terrene nuk u shfrytëzuan asnjëherë për këtë qëllim. Me rënien e Perandorisë Austriake në 1918 dhe kthimin në Republikë Federale ndodhën ndryshime shumë të mëdha në aspektin e politikave për strehimin. Në vitin 1920 Partia Social-Demokratete fitoi zgjedhjet në Bashkinë e Vjenës duke përfituar të gjitha avantazhet e një qeverie rajonale. Sistemi i ri që u vendos i kaloi Bashkisë shumë ndërtesa dhe apartamente të cilat do ti menaxhonte në interes të punëtorëve. Arkitekti Adolf Loos (Rossi, Adolf Loos, 1870-1933, 1959)u vendos përgjegjës në sektorin e banesave të Bashkisë së Vjenës, por qëndrimi i tij i shkurtër në një pozicion të një programi dhjetë vjeçar, kërkonte aftësi organizative më të mëdha dhe më pak ndjeshmëri peotike.

Idetë e Loos për strehimin e punëtorëve ishin në kontrast me këndvështrimet urbane të lidhura me qytetin e Vjenës, që administrata socialiste po përgatitej të niste dhe zbatonte. Ai detyroi në 1922 studimin e lagjes Heuberg, e cila u realizua vetëm pjesërisht dhe lagjen Lainz, e cila u kundërshtua nga autoritetet e Bashkisë dhe nuk u realizua (Loos, 1962, pp. 402-428).

Prej vitit 1923 deri në 1927 Bashkia e Vjenës filloi të ndërtonte banesa për punëtorët, të cilat nuk e kalonin 50% të shfrytëzimit të tokës duke u organizuar në perimtër të saj e duke lënë në qendër oborr të brendshëm, i cili mund të shoqërohej me kopshte, vend lojrash për fëmijë, palestra dhe çerdhe. Në katër vjeçarin e pare u projektuan dy tipe apartamentesh: më i vogli 38 m² dhe më i madhi 48 m². Pas 1927 u projektuan tre tipe banesash, ku më i vogli shkonte 21 m², e përbërë nga një dhomë e vetme, me tualet dhe një paradhomë me sobë e gaz, e menduar për tu banuar nga beqarë. Tipi i dytë ishte 40 m², me ndejtje, kuzhinë e dy dhoma gjumi dhe në fund apartamenti me 57 m² përbëhej nga ndejtja, kuzhina e tre dhoma gjumi, njëra prej të cilave ishte e vogël. Bashkia, nëpërmjet mbledhjes së taksave sponsorizonte ndërtimet në Vjenë, duke ulur vlerën e qërasë që duhej të paguanin qiramarrësit, në mënyrë që ata të kishin mundësi ta përballonin atë.

Asnjë nga ndërtesat e asaj periudhe nuk është një "model" strehimi për të gjithë. Nuk kishte një ide që përmes organizimit dhe qelizës së banimit, të mund të krijohej një qytet i ri dhe një sistem urbanistik alternativ për qytetet e vjetra (nga qeliza në qytet) (Aymonino, 1971, p. 30).

Ndërtesat e reja në Vjenë u bazuan tek mangësitë e banesave të vjetra duke i plotësuar dhe rregulluar ato në pikat e tyre të dobëta. I qëndruan besnik kompozimit të oborrit të brendshëm në blloqet e banimit duke shtuar ambientet e reja që nevojiten për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe duke shndërruar atë në një ambient optimal. Në Vjenë u zhvilluan transformime të pjesshme të njëpasnjëshme duke bërë të mundur arritjen e një qyteti të madh me struktura komplekse dhe për të mos e kufizuar atë në zgjidhjen e rrethit model ose në shpërndarjen dhe pulverizimin e blloqeve të vetme tradicionale. Vjena pjesërisht u zhvillua, domethënë ka marrë një formë dhe pamje të ndryshme nga ato të mëparshmet, falë edhe arritjeve të Bashkisë socialiste. Ajo lidhej me një program që raportonte në problem një koncept të përgjithshëm të zhvillimit të një qyteti modern. Në praktikë, blloqet e banesave e kanë

mohuar si konceptin e “lagjes” si një term që tregon një sasi të re ndërtimi, ashtu edhe atë të “bërthamës satelitore”, në shërbim të komunitetit.

Nuk është rastësi që baza e përvojës vjeneze, domethënë mundësia e zhvillimit të mëtejshëm të qytetit tradicional, organizimit të tij në linjat e tij të përgjithshme dhe ndërtimin e blloqeve të banesave, aspak të vetë-mjaftueshëm, por të lidhura ngushtë, pra një mundësi e jetës për qytetin "kompakt" merrej vetëm në vendet socialiste, ku pikërisht çështja e strehimit, e kuptuar në tërësinë e saj, mund të zgjidhej vetëm në një kontekst të vetëm urbanistik, me praninë e një periferie të re. Në kuptimin që zhvillimi për blloqe banesash paraqet probleme të tjera nga ato që paraqiten nga zhvillimi nga blloqet spekulative ose nga ato për rrethet satelitore (Aymonino, 1971, p. 34).

## 3.2 CIAM[5] – International Congresses of Modern Architecture

Në fillim të viteve ’30 problemet e urbanizimit kaotik, pasojë e zhvillimit të plotë industrial, u ngritën në mënyrë dramatike, veçanërisht në lidhje me kushtet e jetesës së klasës punëtore dhe klasave më pak të pasura. Për këtë arsye lindi nevoja e shtrimit të problemit dhe gjetjes së zgjidhjeve për të në arenën ndërkombëtare. Arkitektët e të gjithë botës arritën të organizoheshin dhe të diskutonin projektimin e banesës për klasën punëtore.

Dy Kongreset e Arkitekturës Moderne të mbajtur në Frankfurt në 1929 dhe Bruksel në 1930 kishin si temë përpunimin e modeleve të zgjidhjes optimale rezidenciale për standardin minimal të jetesës. Temat e përfshira në mbledhjet e para të Kongresit të CIAM ishin rezultat i qasjeve të mëparshme teorike dhe zgjedhjeve operacionale, ndërkohë që ende nuk ishte dhënë zgjidhje praktike në përditshmërinë e ndërtimit. Kjo gjë kishte ndodhur jo vetëm në vendet kapitaliste, ku kushtet strukturore të shoqërisë i kanë theksuar kontradiktat, që u përpoqën të zgjidheshin në vitet ‘30, por edhe në vendet socialiste.

Menjëherë nga 1930-1945 (me përjashtim të atyre vendeve që përkufizohen afërsisht si “social-demokratë” si Holanda apo Skandinavia), Evropa, përfshirë Bashkimin Sovjetik, pushon të jetë një fushë eksperimentale e aplikimit për postulatet arkitektonike të strehimit ekonomik, të paktën në kushtet në të cilat ato u ekspozuan në dy Kongreset (Aymonino, 1971, p. 80).

Në Kongresin e Frankfurtit u diskutua dhe u paraqitën shembuj mbi “Strehimin në nivel minimal të ekzistencës”, apo Ekzistencminimumm siç përdoret më vonë, duke trajtuar vetëm problemet e shkaktuara specifikisht nga ajo periudhë. Në fakt ky lloj trajtimi i strehimit në arkitekturë solli dhe diskriminimin social dhe klasor sepse ato projektime i dedikoheshin një klase të caktuar, siç ishin: punëtorët.

### Qeliza e jetesës si jetesë minimale

[5]CIAM u themelua në 1928 në kështjellën e La Sarraz, Zvicër. Më pas pjesëmarrësit u mblodhën në Frankfurt dhe Bruksel, e pas tyre në 1933 në një anije që lundronte nga Marsilia në Athinë (asnjë document nuk u publikua dhe vetëm në 1941 Le Corbusier do t’i kthehet temave duk i publikuar tek “*Karta e Athinës*”). Mbledhja tjetër e CIAM u zhvillua në 1937 në Paris, me temëm “*Banim dhe rekreacion*” (publikuar nën drejtimin e J. L. Sert me temën “*Munden qytetet tona të mbijetojnë?*”) dhe u pasua nga të tjera si: në 1947 në Bridgeëater, në 1949 në Bergamo, në 1951 në Hoddersdon, në 1953 në Aix-en-Provence, në 1956 në Dubrovnik dhe në 1959 në Otterlo.

C.I.A.M. II i Frankfurtit (1929) (International Congresses of Modern Architecture, Kongresi Ndërkombëtar i Arkitekturës Moderne):

Relacionet e mbajtura nga prezantimet e "Lëvizjes moderne" evropiane në kongres, paraqesin tre grupe argumentash, që raportojnë shumë pozicione dhe tre metodologji të ndryshme (Quilici, et al., 1978, p. 33).

a. Grupi i pare është ai që analizon paralelisht arsyet biologjike(të lidhura me kushtet e mbijetesës) me arsyet sociale (të lidhura me kushtet e bashkëjetesës).
   Ky arsyetim mbështetet nga argumentat e W.Gropius. Në relacionin e tij "Supozimet sociologjike të strehimit minimal (për popullsinë industriale urbane), Gropius mbështet mundësinë dhe domosdoshmërinë e funksionimit nëpërmjet projektimit racional brenda arsyes.
   Në kontekstin e kësaj hipoteze, parametri psikologjik është i privilegjuar: është e mundur sipas G: të racionalizohet si dhe të përcaktohet sasia e kërkesës sociale, < në rastin tonë duke mbuluar, përveç nevojave ekonomike, veçanërisht nevojat psikologjike dhe sociale > (Aymonino, 1971, p. 102).
b. Një grup i dytë i atribuon një rol parësor elementëve të shpërndarjes, të identifikuar dhe izoluar në zgjidhjen minimale të shtratit dhe kompozimit numerik të grupit familjar.
   Elementët e shpërndarjes vareshin nga zvogëlimi i hapësirës kolektive të ditës, hapësirës gatim-ngrënie dhe asaj të pushimit individual, hapësirës së shtratit. Standardi bazë përcaktohet si modul-matjeje: 40-42 m² për 4-5 shtretër (Aymonino, 1971, p. 84). Si pasojë, edhe lloji i ndërtesës kushtëzohet nga grupi i faktorëve dimensional.
c. Në fund, një grup i tretë mbështet nevojën për të hipotekuar marrëdhëniet homogjene midis qelizës dhe qytetit, domethënë zgjidhje të ekuilibruara në kushtet në të cilat qelizat gjenden përballë qytetit.

E. May shkruan: "mund të përpiqemi të fusim të gjitha këto njësi banimi brenda kornizës së qytetit, në mënyrë që të krijohen kushte po aq të favorshme për secilën njësi individuale" (Aymonino, 1971, p. 100).

Interesi kryesor i C.I.A.M. dhe punimeve të tij zbulohet mbi të gjitha në raportin hyrës të paraqitur nga Giedion dhe nga ai i Le Corbusier e Pierre Jeanneret. Flitej për interesin ndaj prodhimit të industrializuar dhe më saktësisht ndaj një rregullimi dhe tipizimi të ofertës (duke u mbështetur gjithmonë në standardin minimal), i cili bën të mundur ekonomikisht miratimin e metodave të prodhimit industrial në fushën e ndërtimit.

Në Kongresin e Brukselit u diskutuan "metodat e ndërtimit racional", duke nënkuptuar jo aq shumë të dhënat teknike të konstruksionit (të ndërtesës individuale), por të dhënat tekniko-ekonomike të ndërtimit të vendbanimeve të reja (nga rrugët tek shërbimet më të përshtatshme për ndërtesa të ndryshme). Në këtë kongres Gropius u prezantua me artikullin e tij me temën "Ndërtime të ulta, të mesme apo të larta?", Le Corbusier paraqiti diskutimin mbi "Fragmentimi i tokës urbane", etj.

**Konkluzionet e Kongreseve**

Tezat që u diskutuan në Frankfurt dhe Bruksel mbetën të pandryshuara për 30 vitet e ardhshme dhe ato ende sot nuk kanë gjetur një zgjidhje të përshtatshme, sidomos në marrëdhëniet midis vendimeve politike dhe zgjidhjeve tekniko – arkitekturore. Asnjë rast optimal në zgjidhje nuk u prodhua në seri dhe te vazhdonte ecurinë e projektimit në vazhdimësi (duke mos konsideruar këtu prototipe përshtatjet që iu bënë tipeve "funksionale" të viteve '30 në fushën e parafabrikimeve). Një fakt interesant është se modeli më i kritikuar në Kongreset e CIAM, ato të mesmet me lartësi- kate, me dy apartamente në kat, ishin më të përhapurat në projektim dhe zbatim pas debateve dhe përpjekjeve të projektuesve gjatë viteve '20.

Kjo dukuri vihet re dhe në Shqipëri sepse në vitet '20 u projektuan dhe propozuan disa variante të banesave me lartësi të ulët, me skemën e dy apartamenteve në kat.

Ajo që midis viteve 1920 dhe 1930 dukej se kundërshtonte dhe pengonte ligjin e zhvillimit spekulativ të ndërtimeve urbane si: përcaktimi, matja, përqindjet në lidhje me papërcaktueshmërinë urbane dhe të këtyre banesave spekulative, me kalimin e viteve do të bëhej niveli i ri i "racionalizuar" në projektim, ku vet tregu kapitalist do t'i duhet të promovojë në qoftë se kostot ekonomike do të jenë të përshtatshme. Karel Teige ishte i mendimit se shtëpia / banesa duhet të garantojë mundësi të mira për shitje, duhet të lejojë koefiçientin më të madh të shfrytëzimit dhe nuk ka rëndësi nëse në të do të jetojnë një apo njëzet njerëz, por rëndësi ka që gjithçka të mos planifikohet dhe të realizohet me madhësi racionale.

Mbetet fakti se në kongreset e Frankfurtit dhe Brukselit, pavarësisht mungesës së arkitektëve sovjetikë, austriak dhe holandezë që kishin përvoja të rëndësishme, përpjekja më e madhe nga arkitektët "inovatorë" u bë për të zgjidhur problemin sasi / cilësi në banesat e qyteteve të mëdha; një përpjekje e cila, brenda vetë CIAM-it, rrjedhimisht paraqet momentin e "kompromisit" më të madh me problemet politike dhe sociale.

Disa vjet më vonë, si interesat dhe problematikat kanë tendencë të riafirmojnë "arritjet" e dekadës së mëparshme duke u munduar të zvogëlojnë brenda kufijve ndikimin ekonomik dhe politik në projektim. Në vitin 1932, Martin Wagner (Wagner, 1961) prezanton rezultatet e konkursit "Banesa e zgjeruar", totalisht individuale dhe dy vjet më vonë është Alexander Klein (Alexander Klein, 1934) i cili publikon studimin e tij "Banesa një familjare", një zbatim i pjesshëm dhe i kufizuar i studimeve mbi metodën optimale të dizajnit që kishte paraqitur në 1928, në Paris tek Kongresi Ndërkombëtar i Strehimit dhe Urbanistikës.

Rezultati final mund të sintetizohet me pak fjalë si e ka përmbledhur në shënimet e tij Bruno Taut për "Situatën e arkitekturës në Rusi": *"Por, funksionaliteti, shpjeguar në kuptimin e të gjithë ndërtesës, në të gjitha pjesët e saj, në të gjitha hapësirat dhe në fund edhe në veshjen e saj të jashtme, plot gjallëri, pa kontradikta, i siguron edhe arkitekturës impulse të reja, e rinovon atë si art dhe për këtë arsye dhe si estetikë. E njëjta gjë ndodh për racionalitetin. Nga pikëpamja pozitive, rezultatet e tij janë identike me ato më lart, në një kuptim negativ, megjithatë, pasojat mund të jenë shumë më serioze: arkitekti e shikon detyrën e tij, jo në ndërtesë, por në programin e vetë ndërtesës"* (Lissitzky, 1969, p. 146).

CIAM krijoi një raport të ri midis metodave konstruktive racionale dhe dendësisë së vendbanimit. Racionaliteti fillon që me zhvillimin urban dhe zgjidhjet e planeve rregullues, mënyren se si vendosen objektet në raport me njëri tjetrin dhe me vet strukturën urbane.

Sipas Gropius (Quilici, et al., 1978, p. 28), koncepti i racionalitetit nuk lidhet vetëm me problemet ekonomike, edhe pse dy aspektet kane rëndësinë e vet, si ai relativi i mjeteve të komunikimit (detyrë e urbanistikës të përpiqet t'i unifikojë, thjeshtojë dhe fuqizoj), ashtu dhe ai i kostove të urbanizimit (si rasti i M.Wagner, që në funksion të zvogëlimit të tyre, mbështet parimin e shpërndarjes së shtëpive të larta). Çështja kryesore mbetet ajo e spekulimit të terreneve, e cila lidhet me densitetin e popullsisë, vlera e të cilit do të varej nga luhatja ekonomike.

Gropius propozoi të ndryshonte rregulloret e ndërtimit në instrumente të racionalizimit të prodhimit, të çlirimit, të proçesit të urbanizim-ndërtimit nga kufizimet dhe kushtëzimet historike (Aymonino, 1971, p. 178).

Deri në atë kohë zhvillimet urbane bazoheshin tek rrugët kryesore duke vendosur objektet në anë të rrugëve, por CIAM e kishte ngritur shumë herë si problem duke evidentuar përmbajtjen sociale të konceptit të racionalizimit: *"Çdo racionalizim ka kuptim vetëm kur vepron me qëllimin për të pasuruar jetën, për ta shpjeguar me gjuhën e ekonomisë, kursen mallin më të shtrenjtë: punëtorët".*

Të gjitha këto koncepte filluan të pasqyroheshin në metodat e reja konstruktive racionale dhe zgjidhjet e reja për densitetin. Kjo çoi në zgjidhje të reja urbane si:

1. *Shpërndarje sistematike në rrugët kryesore, rrugët rezidenciale dhe vendkalimet e këmbësorëve*
2. *Kursim të shpenzimeve për urbanizimin e zonave tek të cilat nuk kishte mundësi shfrytëzimi*
3. *Një ekonomi të teknologjisë dhe komunikimit*

Për *Boehm* dhe *Kaufman* ishte e rëndësishme të përcaktonin një distancë optimale midis objekteve (tipet me kurriz, me rreshta paralel, përgjatë rrugës, pingul me rrugën) sepse kjo do të vendoste nivelin e kërkesave të terrenit. Në këtë mënyrë do të mund të kalohej nga ndërtesat me tre kate tek ato me dymbëdhjetë. Ata vendosën tre mundësi për të përcaktuar një "model standard ndërtimi":

1. Vendosja e këndit të dritës nga një ndërtesë në tjetrën me 45˚.
2. Sipërfaqja e zonave të lira rritet paralelisht me numrin e kateve.
3. Duhej përcaktuar koefiçenti i shfrytëzimit, i cili del nga raporti i numrit të kateve me sipërfaqen që shfrytëzojnë, duke lënë konstante densitetin e popullsisë.

Për projektet e reja urbane Boehm dhe Kaufman, rekomandojnë një densitet të vazhdueshëm të popullsisë (400-600 banorë/ha) duke propozuar kështu, një zgjidhje planimetrike të rregullt dhe homogjene, e cila ul koston e punimit të tokës dhe urbanizimit.

Ndryshe ndodh me Le Corbusier, i cili kritikon konceptin "shtëpi të larta, shtëpi të ulta" duke këmbëngulur se pamja e përgjithshme e qytetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme. Ai

zhvendos interesin e tij tek konflikti historik midis “qytetit kopsht” dhe “përqendrimit urban”, të cilat përkthehen në realitetin e “qyteteve të mëdha” dhe “qyteteve të vogla”.

*Qytetet e mëdha*, - thotë Le Corbusier – *janë vende komanduese, kurse të voglat janë parcela urbane të tokës. Realiteti tregon se nuk ka mundësi të krijimit artificial të qyteteve të mëdha ose të vogla. Qytetet, në përgjithësi shërbejnë për të jetuar dhe punuar*. Në këtë mënyrë shpjegohen krijimet e shumë qyteteve, të cilat janë zhvilluar në afërsi të fabrikave apo minierave të ndryshme. Një shembull i tillë është krijimi i 400 qyteteve të vogla prej 50 000 banorësh të projektuara nga ish Bashkimi Sovjetik, por qendra të tilla Le Corbusier i quan: “qendra pushtimi nga kolonistët (Aymonino, 1971, p. 191)”.

### 3.3 Alexander Klein

Aleksander Klein është një arkitekt i lindur në 1879 në Odessa. Në 1920 ai vendosi të zhvendosej në Gjermani. Më vonë, në 1927 ai u emërua këshilltar për planifikim e qytetit të Berlinit, duke e fokusuar punën e tij në përcaktimin e standardeve të strehimit për klasën punëtore, duke respektuar kërkesat minimale për të jetuar. Për këtë arsye, ai filloi një periudhë studimi dhe kërkimi mbi ekonominë dhe problemet e lidhura me zhvillimin e ndërtesave rezidenciale.

Natyra urbane e projekteve të tij, analiza e tij e thellë e marrëdhënies midis njeriut dhe qytetit, duke adresuar problemin e strehimit nga shtëpia individuale në atë të një zone të tërë urbane, na lejon ta vendosim Klein në një nivel me arkitektët më të famshëm modernë që kanë punuar në banesa, si p.sh. Walter Gropius, Bruno Taut, Martin Wagner dhe Le Corbusier (Bevilacqua, 2011, p. 298).

Çdo epokë ka pasur temat e veta arkitektonike; në antikitet kanë qenë më shumë tempuj dhe ndërtesa publike, në Mesjetë kisha dhe dhe kështjella, në kohën e Rilindjes vila dhe pallate, më vonë shtëpi borgjezësh dhe sot banesat e punëtorëve, së bashku me ndërtesat industriale (Baffa Rivolta & Rossari, 1975, p. 141).

Berlini ka qenë ndër qytetet që patën më shumë ndikim në projektimin e banesave për punëtorët, kjo si rezultat i rritjes së menjëhershme të numrit të popullsisë në 1920, duke u shndërruar në qytetin me densitet popullsie më të lartë në botën perëndimore. Pas Luftës së Parë Botërore, Republika e Weimar (1918-1933) dhe qeveria social-demokratike vendosi ti merrte seriozisht kërkesat e strehimit.

#### Alexander Klein dhe racionalizmi

Kriza e thellë ekonomike, e cila pushtoi të gjitha vendet e Evropës pas Luftë së Parë Botërore i nxiti arkitektët të ishin më të përgjegjshëm, duke e parë arkitekturën si një shërbim shoqëror. Ishte e nevojshme të shkonin përtej kulturës dhe traditës shoqërore – borgjeze të fundit të shekullit të XIX, e cila kishte filluar të tregonte pamjaftueshmëri në përballimin e problemeve të reja, të cilat rriteshin paralelisht me zhvillimin shkencor, ekonomik dhe industrial. Per arsye të këtyre faktorëve, u zhvillua në mënyrë autonome lëvizja racionaliste në arkitekurë. Ajo përpunoi një metodë planifikimi që e vendos arkitekturën në shërbim të shoqërisë, duke njohur në të aftësinë për të ndikuar thellë në rendin politik dhe për të sjell

zgjidhjen e problemeve sociale. Problemi i kërkesave të strehimit për klasën punëtore kishte përparësi.

Fokusi kryesor i aktivitetit të arkitektëve si: Gropius, May dhe Klein ishte përcaktimi i *Ekzistencminimum*, i cili filloi duke dimensionuar qelizën e banimit në kërkesat e domosdoshme për të kënaqur nevojat e meshkujve, në një vision socialist që konsideronte të gjithë burrat janë të barabartë, pavarësisht nga klasa e tyre shoqërore.

Kjo detyrë çoi në formulimin e standardeve universale për ndërtimin, të cilat gjithashtu shërbyen për të promovuar proçesin e industrializimit, *"rezultatin e të gjithë logjikës së teknikës së racionalizmit, domethënë marrjen e rezultatit maksimal shoqëror me minimumin e përpjekjeve ekonomike"* (De Fusco, 1982, p. 219).

Në lidhje me ekzistencminimum është shprehur dhe Le Corbusier, i cili ka thënë:

*Ne duhet të shohim vendosjen e standardeve në mënyrë qe te mund të përballemi me problemin e perfeksionit......Arkitektura funksionon me standarde. Standardet janë çështje logjike, të analizës, studimeve të përpikta: ato bazohen në një problem të shtruar mirë. Eksperimenti përcakton përfundimisht standardin... Të vendosësh një standard është të mbarosh te gjitha mundësitë praktike dhe të arsyeshme, të arrish në një tip të njohur në përputhje me funksionin, kthim maksimal me shpenzime minimale të mjeteve, fuqisë punëtore dhe materialeve, fjalëve, formave, ngjyrave, tingujve* (Le Corbusier, 2008, pp. 182-186).

Duke përcaktuar karakteret tipologjike të qelizave të banimit, vëmendja ishte shtrirë nga apartamentet individuale në ndërtesë, si një kombinim i shumë njësive të bazuara në të njëjtat parime konformuese, disa ndërtesa të organizuara në principet bazë të orientimit, mjetet e komunikimit dhe infrastrukturës, përcaktonin lagjen, disa lagje përbënin qytetin. Një ndjenjë optimiste përshkoi traktatet e arkitektëve racionalistë (Bevilacqua, 2011, p. 300); Klein shkroi: *"ne mendojmë se një qytet i krijuar në këtë mënyrë dhe bazuar në parimet shkencore dhe njerëzore do të ndihmojë komunitetin të formoj qytetarë më të mirë, të cilët rrjedhimisht do të krijojnë një komunitet më të mirë"* (Baffa Rivolta & Rossari, 1975, p. 184).

### 3.4 Banesa popullore kolektive dhe banesa individuale

Teoria e vërtetë e strehimit në periudhën para 1943 në të gjithë botën lidhet me trajtimin e disa çështjeve siç janë: kushtet e jetesës së klasave më pak të mira në lagjet urbane jo-sanitare dhe të mbi populluara të vendeve të ndryshme evropiane; masat legjislative dhe financiare të marra nga qeveritë për të përmirësuar këto kushte dhe aspektet e ndryshme teknike që dhoma e këshillit merrte në vende të ndryshme, falë rinovimit urban.

Qelizat e akomodimit nuk konsiderohen kurrë si unitet në vetvete, por kanë kuptim nga organizmi në të cilin bëjnë pjesë dhe kjo (trupi i ndërtesës që i përmban ato) nga rregullimi urban. Në vazhdimësi të këtij koncepti, metoda e ekspozitës fillon nga elementët më të përgjithshëm të rregullimit por duke analizuar gradualisht elementët më të vegjël të qelizës, duke demonstruar kështu varësinë reciproke midis qelizës elementare dhe organizmit më kompleks.

Giuseppe Samonà (Samonà , La casa popolare, 1935) në analizat e librit të tij në lidhje me banesat e viteve '30 është përpjekur të nxjerrë në pah, përveç meritave organike të teknikës së shpërndarjes (skemat qarkulluese në qelizën e banimit), edhe ato ekonomike, por jo gjithmonë këto përkojnë me të parën. Kjo mungesë përputhje dhe adoptimi i domosdoshëm i disa elementëve që kombinohen për të formuar tipin e banesës (shtëpisë) racionale, theksojnë ndryshimin që ekziston midis banesës minimale dhe banesës për punëtorët (banesa popullore sipas gjuhës italiane). Banesa minimale përfaqëson organizimin më të përsosur të strehimit nga këndvështrimi i funksionimit të mënyrës së shpërndarjes, por kufizon çdo funksion në minimum. Banesa popullore përshtat organizimin teknik racional me nevojat e ekonomisë më të rreptë financiare, duke lënë mënjanë disa rafinime të kërkuara nga strehimi minimal teorik dhe që nuk njihen si të nevojshme për jetën e asaj klase shoqërore, të cilës deri dje i mohohej çdo mundësi e mirëqenies.

Një organizim i ri, tipik i civilizimit bashkëkohor u formua për të përvetësuar një fizionomi të mirëpërcaktuar me karakteristika të spikatura: banesa popullore kolektive. Ky organizëm i ri përmban elementët themelor të Banesës individuale, por është krejtësisht i dallueshëm prej tij nga qëllimet dhe konceptet që e mbulojnë atë dhe për mënyrën e tij të organizimit në vetvete.

Banesa individuale korrespondon me nevojat më subjektive të individit dhe shprehet me elementë të karakterizuar nga liria e zgjedhjes. Ndryshe ndodh me Banesën popullore, e cila vjen si një organizëm dhe sintezë e faktorëve objektivë, të përcaktuar qartë nga domosdoshmëria e tyre dhe të specifikuar nga përgjithësimi i disa elementëve karakteristikë. Ndërkohë që banesa individuale është e përvaktuar plotësisht në vetvete, banesa popullore nuk ka vlerë si një unitet, por si një qelizë që është pjesë e një organizmi kolektiv më kompleks.

Në jetën bashkëkohore janë dy elementë që veprojnë dhe ndikojnë në Banesën individuale, nga njëra anë personaliteti i arkitektit që e projekton dhe nga ana tjetër klienti, dy testamente arbitrare që mund të frymëzohen nga disponime të veçanta, nga nevoja të jashtëzakonshme familjare, nga tekat, etj.

Banesa popullore, duke qenë se është një organizëm i realizuar për masën dhe duhet të dijë të dallojë nevojat e domosdoshme që lidhen me vlerat universale të jetesës, e trajton karakterin e saj nga nevoja për elementët e tij dhe nga përgjithësimi i tyre objektivisht.

Banesa popullore paraqet një organizëm modern sepse në atë periudhë ishte e nevojshme që njerëzit të organizoheshin në ndërtesa më të përshtatshme, të cilat do t'i tërhiqnin ata nga shtëpitë e errëta dhe jo të shëndetshme, ku ata ishin mësuar të jetonin për shekuj, duke u dhënë atyre minimumin e mirëqenies. Problemi i urbanizimit u bë urgjent dhe i tmerrshëm duke kërkuar vendosjen e masave të duhura për jetën civile dhe kushtet higjenike të asaj kohe.

Nga ana tjetër, banesa individuale nuk është organizëm modern, por është një shtëpi historike e cila reflekton, si dje dhe sot, në radhë të parë, nevojat fizike, morale dhe shpirtërore të një njeriu të vetëm.

Në përfundim si konkluzion mund të thuhet se nuk mund të ketë ligje teorike të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e banesave individuale, aq më pak për krahasimin e tyre më banesat kolektive sepse të dyja nuk kanë asgjë të përbashkët. Dy organizma kaq të dallueshëm si për nga vlera shoqërore ashtu edhe për qëllimet artistike nuk mund të ngatërrohen në një kompleks të vetëm (Manieri-Elia, 1982).

Një përmbledhje e disa qyteteve në Evropë për gjendjen e tyre në raport me problematikat e urbanizimit dhe strehimit, sidomos në periudhën pas Luftës së Parë Botërore.

***Italia*** – Problemi për banesat popullore në Itali për herë të parë u mor në konsideratë nga ligji në vitin 1903, me qëllimin të promovonte dhe nxiste iniciativat e mëparshme të grupeve të vogla private. Deri në krijimin e enteve përkatëse, shteti italian i lejoi komunave dhe bashkive të menaxhonin fondet për ndërtimin e banesave popullore që ishin të domosdoshme pas industrializimit në të gjithë arenën ndërkombëtare. Më vonë krijimi i Instituteve për banesat popullore, ku vetëm në vitin 1926 ekzistonin 846 të tilla në qytetet e mëdha dhe të vogla në Itali, çoi në ndërtimin e shumë banesave popullore. Në vitin 1865 për shkak të epidemisë së kolerës u aprovua një ligj në Napoli që lejonte ndërhyrjen në banesat e vjetra popullore me qëllim përmirësimin e kushteve higjenike. Këto ndërhyrje ishin veçanërisht të vështira për tu realizuar nga frika e ndryshimeve të mëdha në konfigurimin historik dhe artistik të ndërtesave dhe lagjeve të vjetra.

***Gjermania*** – Fenomeni i urbanizimit në Gjermani ka nisur që në vitin 1871 me federimin e shteteve gjermane duke shkaktuar një rritje të popullsisë urbane të menjëhershme. Në vitin 1925 popullsia urbane zinte 67% të popullsisë totale në raport me 36% që zinte në vitin 1871. Përpjekjet që ky shtet bëri në periudhën pas Luftës së Parë Botërore për të zgjidhur problemin e strehimit të popullsisë kanë qenë të mëdha. Për të qenë në gjendje të realizonte një program kaq të gjerë dhe intensiv, legjislatura gjermane u përshtat me nevojat, të cilat i zgjidhi rast pas rasti. Kështu qytetet e mëdha kanë zhvilluar një politikë të gjerë toke për të qenë të lirë për të vepruar pa kufizime në zbatimin e planeve të rregullimit të ndërtesave.

***Vjena*** – Para Luftës së Parë Botërore, Vjena kishte kushte shumë të këqija të banimit për njerëzit sepse pjesa më e madhe e tyre jetonte në apartamente të përbërë nga një dhomë gjumi dhe kuzhinë ose një tualet dhe kuzhinë, ku tualeti ishte një ndarje që korrespondonte me gjysmën e dhomës së zakonshme. Asnjë apartament nuk kishte banjë individuale, por ato ishin për grupe apartamentesh në fund të ballkonit që i lidhte ato. Në shumicën e rasteve, në secilën banesë jetonte një familje me pesë ose gjashtë persona. Pas luftës kushtet u përkeqësuan dhe numri i të pastrehëve u rrit. Në vitin 1919 u vendos të ndërtohej një qytet-kopsht me 150 shtëpiza, por që për shkak të shpenzimit të madh arritën të realizoheshin 48 prej tyre me 308 apartamente gjithsej. Në 1923 u mor vendimi të ndërtoheshin banesa kolektive popullore me shumë kate për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e larta për strehim. Këto lloj ndërtimesh vazhduan deri në vitin 1930 dhe patën rezultat shumë pozitiv. Sipas Samonà, e theksuar në librin e ribotuar nga Mario Manieri-Elia (Manieri-Elia, 1982, p. 14), situata e banesave popullore në Vjenë mund të konsiderohet si më të mirat në Evropë.

[6] E dhënë e marrë nga libri i Samonà por i ribotuar nën drejtimin e Mario Manieri-Elia (Manieri-Elia, 1982, p. 11). Në këtë kapitull janë paraqitur shumë informacione dhe data të shkëputura nga ky libër.



*Figura 3-1. Apartamente për punëtorë në një Banesë popullore në Vjenë pas Luftës së Parë Botërore*

***Anglia*** – Në Angli planifikimi urban mori përmasa të konsiderueshme në periudhën e pasluftës; fenomeni i rritjes graduale të popullsisë në qytet nga braktisja e fshatit është ndjerë më shumë se kurrë në ato vite. Për shkak të kësaj rritje të popullsisë u rrit përqendrimi në bërthamat urbane duke rritur dendësinë e njerëzve. Në të njëjtën kohë vihej re ende në zemër të Londrës së vjetër prania e *slums*[7]. Në Angli donin t'i jepnin prioritet zhvillimit urban dhe ndërtimit sipas konceptit qytet-kopsht, sidomos deri në vitin 1925 por përdorimi i konsiderueshëm i shumave që kërkonin këto tipe ndërtimesh për blerjen e tokave e bëri këtë tipologji zhvillimi pak më të vështirë.

***Franca*** – edhe në Francë, si në vendet e tjera të Evropës, problemi i urbanizimit paraqet dukuri të ngjashme. Nga viti 1861 në 1927 popullsia rurale u zvogëlua shumë, kurse ajo urbane u rrit. Në shtetin francez ndodhi një dukuri e veçantë sepse rritje më drastike patën zonat periferike të qyteteteve se sa qendrat e tyre. Lufta përshpejtoi krizën e strehimit dhe mungesën e banesave duke shkaktuar nevojën emergjente të krijimit të lagjeve të reja urbane dhe prishjen e atyre më të vjetra. Meqenëse në Francë nuk ekzistonte një ligj që parashikonte shpronësim për shërbimet publike. Prishjet shkaktuan konflikte shumë serioze midis të dëbuarve dhe autoriteteve lokale. Pavarësisht këtyre problemeve, banesa të shumta u ndërtuan në Francë në fushën e banesave kolektive popullore.

***Suedia*** – Në Suedi, kriza e ndërtimit nuk pati të njëjtat pasoja si në vendet e prekura nga Lufta e Parë Botërore, duke u ndaluar në kohë, jo vetëm nga dispozitat moderne të legjislacionit, por edhe për ndikimin efektiv të iniciativës private. Ndërtesat e pas luftës janë ndërtuar kryesisht nga kompani të mëdha ndërtimi të organizuara midis ndërtuesve dhe inxhinierëve, të cilët ndërtojnë dhe më pas menaxhojnë vet, ose nga kompani të mëdha financiare të promovuara nga qiramarrësit, të cilët sipas një plan amortizimi bëhen pronarë të banesave pas 20 vjetësh.

***Belgjika*** – Pas luftës, në Belgjikë situata e strehimit prezantohej si një nga vendet më problematik sepse kishte ndalim të ndërtimeve gjatë periudhës së luftës, por edhe shkatërrim të ndërtesave ekzistuese. Për të zgjidhur një krizë të tillë kërcënuese, shteti belg krijoi

[7] Slums janë lagje të varfra, zona rezidenciale urbane mjaft të populluara, të përbëra nga njësi banimi të vendosura afër dhe ngushtë me njëra-tjetrën, pjesërisht të shkatërruara dhe të shoqëruara me një infrastrukturë të keqe dhe jo të plotë. Këto zona, kryesisht banohen nga persona të varfër.

Shoqërinë e Banesave dhe Strehimit duke u frymëzuar nga eksperienca italiane me institutet autonome. Kjo shoqëri, ndryshe nga Italia dhe Franca nuk kishte për detyrë të ndërtonte vetë banesat, por të menaxhonte dhe shpërndante fondet e vëna në dispozicion nga shteti midis ndërmarrjeve të ndërtimit që bashkëpunojnë me të. Në të gjithë vendin duhej të shembeshin me mijëra *taudis*[8] dhe të ndërtoheshin banesa të reja kolektive popullore.

***Holanda*** – Në Hollandë, lufta kundër urbanizimit ka pasur karakteristika të veçanta për vet situatën që paraqiste vendi. Tokat e lira përreth qytetit u pushtuan nga një popullsi e tepërt. Pavarësisht rritjes së popullsisë dhe dendësisë së madhe, situata e strehimit në këtë vend nuk ishte e keqe. Kjo ndodhte për dy arsye:

1. Hollandës nuk i duhej të strehonte të pastrehët dhe zonat që duhej të shembtë ishin shumë të pakta në numër për shkak se banorët hollandez kishin të edukuar një kulturë jetese individuale në shtëpitë e tyre duke iu larguar zonave me dendësi të lartë.
2. Shteti mori disa masa inteligjente duke kontribuar me kapital në ndërtimin e banesave popullore dhe duke lejuar arkitektët më të mirë të zbatonin ide racionale dhe moderne mbi këtë tipologji banese.

### 3.5 Tipologjitë e banesave kolektive në vende të ndryshme në Evropë

Vet banesat popullore mund të ndahen në dy grupe kryesore që janë: banesat popullore me banim individual dhe banesat popullore me sistem kolektiv. Në këtë pjesë të kapitullit do të paraqiten disa shembuj nga këto tipologji banesash dhe do të pasqyrohet një përshkrim sipërfaqësor i tyre me anët pozitive dhe negative që ato kanë sjell në arkitekturën e banesave në botë dhe ndikimin e tyre në kushtet e jetesës për njerëzit. Nga përvoja është parë se tipi i banesave populore kolektive është më i përhapur se ai individual dhe vazhdon të afirmohet çdo ditë e më shumë. Një nga faktorët kryesor që ka ndikuar në zhvillimin e banesave kolektive ka qenë dhe ekonomia, e cila ndihmon në zgjidhjen praktike të shumë problematikave të strehimit. Banesa individuale ka ngarkesë financiare shumë të lartë se sa banesat kolektive duke përfshirë: koston më të lartë të blerjes së tokës, atë për trajnimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, energjisë elektrike, ujin, etj. Patjetër që vlejnë për tu theksuar përparësitë e sistemit të shtëpive individuale me tarraca në qytetet kopsht, larg qytetit dhe qendrës së bizneseve, ku secila familje ka shtëpinë e saj individuale, kopshtin e saj dhe përfiton maksimumin e ajrit të pastër, diellit dhe pushimin e mirë.

Por fenomeni i urbanizimit të menjëhershëm dhe rrethanat ekonomike e bëjnë të vështirë zhvillimin individual dhe në shumë qytete evropiane u ndalua ndërtimi i qyteteve kopsht në zona shumë të kufizuara.

Në vitin 1924, në Kongresin mbi Banesat dhe Planet Rregulluese, në Amsterdam u propozuan për strehimin zgjidhje të qytetit-kopsht dhe qyteteve satelit si zgjidhjet më radikale dhe praktike në zbatim për ti dhënë fund rritjes së vazhdueshme të qyteteve të mëdha.

*"Njeriu që punon në qytet ka nevojë për fshatin për tu ndjerë i rrethuar nga natyra, për të ekuilebruar ndikimin e shtypjes dhe dëmeve të jetës në qytet"* (Manieri-Elia, 1982, p. 26).

[8] Lagje të vjetra dhe shumë të varfra

Këto propozime dhe konkluzione të arkitektëve dhe urbanistëve të nxjerra në Amsterdam janë shumë ndryshe nga ato të Kongresit të Brukselit në 1930.

Kongresi i Brukselit, në 1930 diskutonte mbi banesat e ulta, të mesme apo të larta. Ky përfundoi seancat e veta duke shprehur disa mendime në lidhje me banesat e ulta se edhe pse janë shumë të favorshme nga autoritet, nuk lejojnë të njëjtin shfrytëzim dhe përdorim që lejojnë banesat kolektive me një lartësi të mesme. Banesat kolektive të larta, duke qenë se nuk kanë pasur eksperiencë të mjaftueshme deri në ato vite, mund të çonte në një zgjidhje të banesës minimale dhe për këtë arsye duheshin studiuar mirë të gjitha mundësitë e banesës së lartë dhe efektiviteti i saj në modelet e kryera.

Siç mund të shihet, nga viti 1924 deri në 1930, mendimi i studimeve ndërkombëtare në lidhje me llojin e banesave popullore u përmbys rrënjësisht: mendimi i parë i rënë dakord ishte i orientuar drejt favorizimit të zhvillimit të qyteteve-kopsht dhe banesave popullore me shtëpi me tarraca; më pas është banesa kolektive ajo që imponohet, dhe jo vetëm me një numër katesh të kufizuar, por edhe banesa e lartë kolektive (më shumë se shtatë kate).

Në vitet ’30, në lidhje me këto probleme, situata në Evropë ishte si vijon: një grup kombesh, të cilët për shekuj, tradicionalisht kane ruajtur karakterin individual të shtëpive të tyre edhe në qytet preferuan të përhapnin tipin e banesës me tarraca me akomodim në dy kate, ku salloni dhe kuzhina ishin në katin përdhe dhe dhomat e gjumit e tualeti në katin sipër. Vendet që respektuan këtë tipologji janë: Holanda me ndërtimin e saj tradicional me tulla, Belgjika, Anglia dhe Zvicra.

Në vendet e tjera të Evropës, shtëpitë seri me një ose dy kate, me apartamente individuale në qytetet-kopsht u miratuan pjesërisht. Këto lloj akomodimesh përfshinin zona të kufizuara, kurse zonat e tjera u zhvilluan me ndërtime dhe banesa popullore kolektive shumëkatëshe.

Në ndërtimin e banesave popullore, në Itali u eksperimentuan disa qytete-kopsht me tipet e shtëpive (viletave) individuale të bashkangjitura, por ato nuk dhanë rezultate të pëlqyeshme dhe të bindshme. Në periudhën 1919-1924, Instituti i Banesave ndërtoi katër fshatra me këtë tipologji. Ato ishin: Campo dei Fiori, Baravalle, Gran Sasso dhe Tiepolo. Pas këtyre ndërtimeve, ky lloj eksperimenti nuk u përsërit më sepse pavarësisht se vetë ndërtimi ishte ekonomik, vet kostoja e përgjithshme ishte mjaft e konsiderueshme, si për koston e tokës të shkaktuar nga krijimi i kopshteve, për koston e rrugëve, për koston e mirëmbajtjes vjetore dhe atë të shërbimeve të ndryshme si: uji, gazi, energjia elektrike, etj.

Siç u përmend dhe më sipër, në pjesën më të madhe të Evropës u zhvillua banesa popullore kolektive me shumë kate, e cila pati një përhapje më të madhe pas Luftës së Parë Botërore. Banesa kolektive ndahej në dy tipologji që ishin: tipi *bllok* dhe *linear*.

***Banesa tipi linear*** pati një zhvillim të madh në vitet e pas luftës për shkak të avantazheve të saj si: orientimi uniform për të gjitha rreshtat e banesave, e cila lejon një përqasje të përgjithshme uniforme për gjithë shtëpitë; format e thjeshta të planimetrive, të cilat duke mos pasur apartamente në qoshe të lejojnë të projektosh elementë në seri; distanca midis banesave të tipit linear është më e madhe se ajo e tipit bllok duke lejuar apartamentet e godinave përballë njëri-tjetrit të jenë më larg.

Përveç të gjithave banesa kolektive, ***banesa tipi bllok*** është më shumë e përhapur, jo vetëm në zonat urbane, por edhe jashtë qytetit si rasti i lagjeve-kopsht të ndërtuara me godina kolektive të tipit bllok i hapur. Tre arsyet e shpërndarjes dhe zhvillimit të banesave kolektive tip bllok janë:

1. Kjo tipologji lidhet ngushtë me zakonet e vjetra sepse korrespondon me sistemet tradicionale të ndërtimit.
2. Faktori estetik-urban preferon tipin bllok të banesave kolektive sepse ai jep mundësinë e formimit të shesheve të mbyllura dhe të grupimeve piktoreske të godinave. Ndërkohë që tipi linear paraqet monotoni për shkak të shpërndarjes uniforme të elementëve të përsëritur.
3. Arsyeja ekonomike që e bën tipin bllok të preferueshëm është shfrytëzimi më i mirë i zonave në dispozicion, veçanërisht kur ato ndodhen në qytet sepse realizon në sistemimin e blloqeve një ekonomi relative të rrugëve të reja.

Në *konkluzion*, banesat kolektive tip bllok preferohen në zonat urbane të qyteteve ku rrugët dhe sistemi rrugor është tashmë i ngritur duke shfrytëzuar perimetrin e tyre, pa qenë nevoja të krijojnë rrugë të brendshme.

Ndryshe ndodh në zonat periferike, jashtë qyteteve ku ndërtohet në sipërfaqe të mëdha dhe duhet një kosto sa më e ulët dhe modeste. Aty sistemi rrugor duhet të ngrihet nga e para dhe rrit kështu koston e ndërtimit total të blloqeve të banimit. Në këtë rast preferohen banesat kolektive tipi linear ku mund të ndërtohet me elementë të përsëritur njëtrajtësisht në seri dhe një numër më i lartë apartamentesh dhe shtretërish duke kompensuar përdorimin e vogël të tokës dhe shpenzimet e rrjetit rrugor.




*Figura 3-2. Plani i vendosjes së lagjes "Solari" në Milano (nga kujtesa e "Instituti për banesat popullore të Milanos dhe vepra e tij me rastin e Kongresit të XII Ndërkombëtar të Strehimit dhe Planeve Rregulluese", 1929 )9*

[9] Figura dhe informacioni janë marrë nga libri i ribotuar i Samonà nën drejtimin e Mario Manieri-Elia (Manieri-Elia, 1982, p. 30)

Tipi bllok i banesave kolektive pati më shumë zhvillim në vendet si Italia, Franca dhe Austria, kurse tipi linear pati një përhapje më të madhe se tipologjia tjetër në Gjermani, Suedi dhe Norvegji.




*Figura 3-3. Plani i vendosjes së lagjes "Regina Elena" në Milano(referenca si figura më lart) (Manieri-Elia, 1982, p. 31)*

Në Çekosllovaki, ku arkitektura akoma nuk kishte marrë një konfigurim të sajin, në Belgjikë, Hollandë, Angli dhe Zvicër, ku përdorimi i shtëpive të bashkangjitura ishte më i shpeshtë, sistemi i banesave kolektive tip bllok dhe linear u alternuan në mënyrë sporadike në përdorim sepse arkitektura e këtyre ndërtesave iu besua brezit të ri të arkitektëve, të cilët synojnë problemet moderne të teknikës së ndërtimit.

Në *Itali*, sistemi i banesave kolektive tip bllok kishte këto karakteristika:

- Ndërtesa të vendosura përgjatë rrugëve kryesore dhe që mbyllin pjesët më godina zakonisht unike dhe të njëjta.
- Lagja ndahej në zona simetrike në raport më një aks të caktuar, me godina të hapura drejt oborreve të brendshme dhe që ndërpriteshin nga njëra-tjetra nga intervale hapësirash relativisht të ngushta, por të mjaftueshme për qarkullimin e ajrit.
- Sistemimi i këtyre lagjeve shumë të mëdha realizoheshin nëpërmjet rrugëve të brendshme, të cilat e ndanin zonën në zona më të vogla, mundësisht me sa më shumë element simetrik midis tyre.
- Hapësirat e brendshme, brenda oborreve krijoheshin nga distanca jo më shumë se 20 metra nga objekti në objekt, ku lartësia e tyre zakonisht shkonte deri në pesë kate.



*Figura 3-4. Plani i vendosjes së lagjes Villapizzone në Milano (referenca si figurat më lart) (Manieri-Elia, 1982, p. 32)*

Ky lloj akomodimi të ofron mundësi lëvizje arkitektonike në perspektivë, rregullim në hapësirat piktoreske, por nuk të lejon një ilustrim të mirë të të gjitha ndriçimeve sepse krijon shumë zona me hije. Është pak e vështirë që të krijosh ndërtesa me element konstant për t'u përsëritur në seri duke qenë se vet ndërtesat nuk kanë formë dhe dimensione të njëjta por përshtaten sipas formave gjeometrike për secilin rast. Sa më shumë që dikush të përpiqet të ndajë intervalet me hapësira sa më të rregullta, aq me shumë gjen ndryshime të konsiderueshmë nga një godinë në tjetrën. Kjo tipologji ka vështirësi edhe në zgjidhjet këndorë të planimetrive.

Për arsyet e sipër përmendura, rasti i banesave kolektive të tipit linear filluan të shpeshtoheshin në projektimin e arkitektëve modern. Një rast i tillë është edhe një nga shumë banesat kolektive të realizuara nga arkitekt Griffini si: lagja "alla Fontana" në Milano.



*Figura 3-5. Plani vendosjes së lagjes "alla Fontana" në Milano (Manieri-Elia, 1982, p. 35)*

Ndërtesat krijonin oborr të brendshëm duke u vendosur përgjatë trupit të rrugës. Ndërtesat e gjata orientoheshin sipas drejtimit veri-jug, kurse objektet e shkurtër i kishin të projektuara ambientet nga jugu. Në këtë lagje krijoheshin hapësira të lira të konsiderueshme.

Sistemimi i godinave nuk ishte plotësisht linear, por zgjidhja këndore e tyre ishte e tillë që nyjet e apartamenteve përsëriteshin në seri dhe nuk kishte probleme në menaxhimin e tyre.

Në vitin 1933, në një nga konkurset e Milanos për banesat popullore kolektive u paraqit një projekt për lagjen e re të banesave popullore “Francesco Baracca” në San Siro me konceptin e banesave lineare.



*Figura 3-6. Aksonometria e projektit nga arkitektët: Albini, Camus, Palanti, Kovacs (fitues të konkursit) (Manieri-Elia, 1982, p. 36)*

Deri në vitin 1933, në Itali preferohej banesa popullore kolektive e tipit bllok i mbyllur ose i hapur me forma gjeometrike të rregullta ku mbizotëronte simetria dhe të dominuara nga estetizmi tradicional, duke mos lejuar që në qelizat elementare të banimit të zbatoheshin disa kritere standarde që mund të çonin në një kursim të konsiderueshëm të shpenzimeve. Një nga faktorët që ndikonte në kosto ishte dhe lartësia e kateve që duhej të realizohej 3.35 metra për katet sipër dhe 3.5 metra për katin përdhe, rregull ky që ndryshoi në 1933 duke parë se shumë vende të Evropës kishin shumë kohë që punonin me lartësi respektivisht 2.5 dhe 3 metra për katet sipër dhe përdhe në ndërtesat e banesave popullore kolektive.

Këto dy arsye shoqëruese, mungesa e ndërtimit masiv dhe humbja e vëllimit për shkak të lartësisë së tepërt të dyshemesë, i kanë detyruar arkitektët dhe rregulloret të kufizojnë numrin e dhomave dhe shërbimeve sa më shumë që të jetë e mundur. Në vend të kësaj, do të kishte qenë shumë më e dobishme për banueshmëri, nëse banesa do të ishte proporcionale me numrin e njerëzve të destinuar të jetonin në të, me statistika rigoroze që do të theksonte përqindjen e familjeve me 2, me 4, me 6 persona dhe më shumë. Nëse marrim parasysh që klasa më pak e pasur zakonisht përbëhet nga familjet më të mëdha dhe se është e destinuar të jetojë në apartamentet më të vogla, ne shohim se si sistemi i ndjekur në përgjithësi në Itali nuk ishte shumë racional. Me një rregullore pak më ndryshe të ndërtimit, e cila do të lejonte të kursente në lartësinë e dyshemesë dhe me një teknikë ndërtimi më të përparuar, e cila do të lejonte një kriter standard më rigoroz, do të kishte qenë e mundur të studioheshin apartamente me kosto të barabartë, në të cilën numri i shtretërve do të ishte në përputhje me numrin e personave të familjes. Megjithatë, ky kriter i përshtatjes së pajisjeve minimale jo në minimum të dhomave, por në hapësirën minimale të nevojshme për person, bëri rrugën e tij edhe në Itali; prova e kësaj mund të gjendet në konkursin e fundit të nisur nga Instituti për strehim

publik në Bolonjë për projektet e banesave publike me apartamente të përshtatshme për familje të mëdha me pesë ose nëntë anëtarë.

Në Vjenë u vendos të vazhdohej me prodhim intensiv të banesave kolektive për zgjidhjen e problemit te strehimit nga urbanizimi. Tipologjia që u zgjodh të ndërtohej në këtë qytet ishte ajo e banesave të bashkangjitura me konceptin e qytet-kopsht, duke nisur me nje projekt masiv me 42 shtëpi të tilla me 308 apartamente gjithsej në veri perëndim të qytetit. Këto banesa të ndërtuara në Vjenë janë të ngjashme me baneaat e tipit bllok të Italisë, me vendosje përgjatë rrugëve, studim simetrik dhe shpërndarje gjeometrike me qëllim efektin skenografik dhe piktoresk. Gjithsesi, banesat vjeneze ndryshojnë nga ato italianet sepse kanë përqendrim më të ulët të godinave më raport me pronën duke i dhënë të paktën 50% të rrenit mundësi zhvillimi për gjelbërim. Sistemimi i këtyre lagjeve realizohej me qëllim arritjen e një efekti të përgjithshëm, krijuar nga distancat e mëdha objekt-objekt.



*Figura 3-7. Plani i vendosjes së lagjes "Kreuzgasse", Vjenë, ark. C.Ehn (Manieri-Elia, 1982, p. 40)*



*Figura 3-8. Plani i vendosjes së lagjes "Rottstrasse" në Vjenë, ark. C. Holsmeister (Manieri-Elia, 1982, p. 41)*

Kompozimi i blloqeve të banimit ishte më pak i fragmentuar se ato italiane, duke sjell një pamundësi të shpërndarjes racionale të apartamenteve në seri, mungesë të orientimit dhe lëvizje të detyrueshme estetike të volumeve të brendshme që krijonin hije të panevojshme dhe shpenzime të tepërta. Shembuj të tillë lagjesh banimi ka shumë në Vjenë.

Për sistemimin e brendshëm të blloqeve individuale arkitektura popullore vjeneze ka këto karakteristika: numri i kateve jo më pak se 3, tendencë të theksuar të lëvizjes në lartësi të objekteve individuale me qëllim arritjen e efektit skenografik duke ndryshuar në seksione të caktuara brenda të njëjtit bllok lartësinë nga 9 në 3 kate.

Zakonisht këto banesa kishin katër apartamente në kat me një shkallë qëndrore në seksion. Kriteret e përgjithshme filluam të përkeqësoheshin në të njëjtën mënyrë si në Itali, për shkak të mungesës së shpërndarjes racionale të elementëve në seri, për një kujdes të tepruar në estetikë duke çuar në lëvizje ekstreme në lartësi dhe në thellësi. Arkitektët ishin të detyruar të përshtasnin banesën minimale, jo më me hapësirat minimale të nevojshme që i duhej çdo pjesëtari të familjes por me një minimum numër hapësirash. Për të rritur sipërfaqet e apartamenteve u rrit thellësia e tyre duke krijuar kështu ambiente të pa shfrytëzuara mirë e të përshtatahme n mobilim dhe të pa ndriçuara mjaftueshëm.

Edhe në Francë pati një zhvillim të dukshëm të banesave popullore kolektive të tipit bllok pas Luftës së Parë Botërore. Ato ishin të ngjashme me banesat italiane në koncept, në vendosjen urbane edhe në paraqitjen e tyre.




*Figura 3-9. Plani i vendosjes së një grupi banesash ekonomike përgjatë "Porta Chaumont" në Paris (Manieri-Elia, 1982, p. 46)*




*Figura 3-10. Plani i vendosjes së një grupi banesash ekonomike përgjatë "Bulevardit Brune" në Paris (Manieri-Elia, 1982, p. 46)*

Në lagjet periferike të ndërtuara jo shumë larg qytetit, lartësia e kateve shkonte 6 ose 7 kate me karakteristikën gjithmonë prezente në ndërtimet franceze të një kati të tërhequr dhe ballkonit tipik francez (bowindow).

Ndryshe nga skemat italiane dhe austriake, skema franceze parashikonte dy apartamente me një shkallë me qëllim ventilim më të mirë të apartamenteve duke shfrytëzuar secili prej tyre të dyja faqet e godinës.

Në Francë klasifikohen tre tipe banesash popullore kolektive:

1. Banesat ekonomike për klasat e varfra të punëtorëve
2. Banesat mesatare për klasën punëtore pak më të ngritur.
3. Banesat e tipit me qëra mesatare për borgjezët e vegjël.

Dy tipet e para (1 dhe 2), të cilët janë shumë të përhapur, zakonisht kanë në strukturën e tyre tre ambiente: dy dhoma gjumi dhe ndejtjen. Ndryshe nga banesat popullore italiane, kuzhina është e diferencuar nga ndejtja dhe shumë e vogël. Në nyjen sanitare, tek banesat ekonomike veç pajisjes së wc, ndodhej edhe dushi, kurse në banesat mesatare ndodhej banja.

Banesa popullore franceze kishte të gjitha difektet e banesave të të njëjtës tipologji të realizuara në Itali dhe Austri, por me disa ndryshime si më poshtë:

- Shfrytëzim më i mirë në lartësi i godinave duke i dhënë një hapësirë relative më të madhe
- Ndarje e kuzhinës nga ndejtja
- Rritja e numrit të ambienteve
- Projektim pak më i madh i ambienteve kryesore dhe atyre ndihmëse
- Pajisje me dush edhe për apartamentet e klasës më të varfër të punëtorëve.

Banesat popullore franceze filluan të zhvilloheshin më shumë duke kaluar në tipologji më racionale dhe në shkallë urbanë të madhe si psh; banesat lineare me korridor të jashtëm shpërndarës (ballatoio esterno)

Në Gjermani u shpenzua shumë energji për të zgjidhur problemin e strehimit popullor me projektimin e banesave popullore kolektive. Rezultatet e arritura, sidomos për disa lagje të caktuara, renditen ndër më interesantet të realizuara në Evropë. Kjo ndodh dhe si rezultat i formimit shumë të mirë që projektuesit gjerman kanë krijuar ndër vite nga metodologjia dhe cilësia e shkollimit gjerman. Faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate projektimi shumë pozitive janë: arsimi i përgjithshëm i vendit, i përgatitur në radhë të parë mbi problemet më moderne të teknikës së ndërtimit, studimet e qarta dhe thellësisht analitike të arkitektëve dhe sociologëve të talentuar si: Gropius, Klein, Hilberseimer, Bruno Taut, etj; përgatitja shkencore e kryetarëve të bashkive (*Bürgermeister*) të çdo qyteti të madh, i cili në të njëjtën kohë është jurist, inxhinier dhe sociolog duke qenë se është arsimuar në mënyrën e duhur në një nga shkollat më speciale si ato të Düsseldorf, Köln, Breslau, Posen, ku studiohen lëndët inxhinierike, arkitektonike, juridike, sociale dhe rëndësia e studimeve dhe realizimeve urbanistike. Çdo qytet i rëndësishëm ka parashikuar planin e tij të shtrirjes dhe e ka zbatuar atë rigorozisht pa keqardhje. Strehimi social (popullor) i krijuar në këtë mjedis ka qenë në gjendje të krijojë plane të përgjithshme dhe të hollësishme, të cilat në shumë raste janë më të mirat që janë bërë për këtë temë. Ndërtimet popullore gjermane dallohen nga ato të çdo kombi tjetër evropian, për faktin se ato nuk kanë aplikime përgjithësuese me karakteristika unike, por në vende të ndryshme aplikimet ndryshojnë dukshëm nga njëra-tjetra, edhe pse ruajnë disa elemente themelore të përbashkëta. Kjo i detyrohet, më shumë se gjithçkaje tjetër, karakterit shkencor që ka përgatitur Gjermaninë në luftën për zgjidhjen e problemit të banesave popullore (publike), i cili është manifestuar në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme, dhe për këtë arsye zbatohet në mënyrë të ndryshme në praktikë. Nga kjo karakteristikë rrjedh se, megjithëse tipi tradicional i ndërtesave të bllokut është ende i përhapur në shumë vende të njohura, në nënndarjet e shumta moderne, lloji në linjë ka imponuar veten në format e tij më moderne dhe rigoroze të ndërtesave uniforme dhe me hapësirë të njëtrajtshme, të orientuara ver-jug me devijim të lehtë në perëndim për të pasur diellëzim maksimal të mundshëm.

Ndërkohë që banesa popullore tradicionale vazhdon të ndërtohet me apartamentet e saj të tipit minimal, të projektuara jo nga numri i njerëzve në familje, por nga mundësitë financiare të saj, duke u shoqëruar me numrin më të vogël të lokaleve, një përqindje e madhe e strehimeve moderne adoptojnë kritere standarde rigoroze dhe ia nënshtrojnë akomodimin e strehimit një studimi statistikor parandalues, jo vetëm për të përshtatur kapacitetin e saj me numrin e anëtarëve të familjes, por edhe për të përshtatur apartamentin me zakonet e kategorisë së punëtorëve që do të jetojnë në të. Shembujt e llojit më modern janë të shumtë: nga akomodimet e njohura në Frankfurt te ato të "*Bad-Durrenberg*"; nga lagjet popullore të "*Reinickendorf*" në Berlin në ato të kolonisë "*Rundling*" afër Leipzig, etj.



*Figura 3-11. Lagje popullore në Frankfurt (marrë nga revista "Rassegna di Architettura")*



*Figura 3-12. Grupi i 1000 banesave të lagjes "Bad-Nurrenberg", ark. A. Klein (Manieri-Elia, 1982, p. 53)*

## 3.6 Karakteristikat e banesës popullore në raport me qelizat

Me rëndësi është përcaktimi i llojeve të qelizave që përbëjnë elementët, meqenëse këto qeliza, të përsëritura automatikisht në organizëm dhe më pas të përgjithësuara në komplekset planimetrike të disa organizmave, përbëjnë bazën ekonomike për zbatimin praktik të konstruksioneve të këtyre ndërtesave.

Baza ekonomike, kërkesat higjenike dhe faktorët etikë përfaqësojnë principet bazë për studimin e qelizës. Duke u bazuar në këto koncepte çdo përpjekje është bërë për të zvogëluar qelizën në pak element themelor me dimensione të caktuara, ku shmangej humbja e hapësirës, qoftë dhe e vogël duke përfituar normalizim të elementëve individual.

Çdo qelizë ka një organizim funksional të hapësirave të sajin e cila përcaktohet nga tre faktorë:

1. organizimi i shërbimeve
2. nga vlera dhe prioriteti që i jepet elementëve të caktuar, të cilët i referohen karakteristikave etnike dhe shoqërore të njerëzve që jetojnë në banesa
3. nga tipi i organizmit strehues në të cilën qeliza bën pjesë.

Nga faktorët e mësipërm arrijmë të diferencojmë qartë karakteristikat e banesave kolektive me ato individuale historike, ku këto të fundit veçohen për hapësira më të mëdha.

Strukturat tipike të banesave popullore (sociale) mund të ndahen në dy grupe kryesore:

1. grupi me banesa individuale me qeliza të lidhura në seri të vazhdueshme
2. grupi i banesave kolektive me apartamente të mbivendosura, të lidhura për secilin kat me shkallë të përbashkëta.

Grupi i parë ndryshon nga tjetri për nga karakteristikat e banimit sepse secili apartament nuk ka elementë të përbashkët me të tjerët në seri; ndërsa apartamentet e grupit të dytë janë kolektive sepse kanë të përbashkët elementë dhe ambiente shërbimi si: ballkone, shkallë, korridor, etj. Në fakt termi "individuale" dhe "kolektive" nuk është plotësisht i saktë sepse në një kuptim të caktuar banesat e grupit të parë gjithashtu duhet të konsiderohen kolektive, duke qenë se qeliza i përket një organizmi kompleks.

Grupi i banesave individuale nënkupton shtëpi individuale, të bashkuara në seri të vazhdueshëm, të organizuara në një deri në dy kate, tipike të qyteteve-satelit dhe qyteteve-kopsht.

Grupi i banesave kolektive përfshin disa zgjidhje tipike si më poshtë:

1. tipi i bllokut të mbyllur më ndërtesa të rregulluara përgjatë rrugëve, rreth një oborri të mbyllur;
2. tipi i blloqeve të hapur me ndërtesat e vendosura përgjatë rrugëve, duke lënë një hapësirë të ndërmjetme, të hapur të paktën në njërën anë;
3. tipi linear me ndërtesa të drejta të vendosura përgjatë rrugëve ose në një seri elementësh paralel.

Në raport me numri e kateve, banesat popullore ndahen në:

1. banesa të ulta që i përkasin grupit të parë
2. banesa të mesme, me lartësi 2-6 kate
3. banesa të larta, me lartësi 7 kate e sipër.

Një konfirmim i strehimit në vitet '30 ishte se: çdo organizëm banesash kolektive pajtohej me konceptin e banesës minimale, e cila u theksua dhe saktësua dhe në kongreset e CIAM. Një banesë racionale konsiderohej si një mjet i preferuar, përdorimi i të cilit ishte efikas për individët me arsim të lartë. Duke hequr të gjitha barrierat e vlerave sociale dhe psikologjike për shkak të edukimit sistematik të njerëzve, mjeti i strehimit do të kishte atribute të përbashkëta për të gjitha racat, përvec kufizimeve si pasojë e kushteve klimaterike. Si

përfundim, duke u bazuar tek të gjitha praktikat e realizuara nga banesat popullore, vlen për të patur parasysh idetë teorike të banesave minimale, por duhet konsideruar si një model i evoluar i banesave popullore, i cili nuk duhet të realizohet plotësisht i atillë. Banesa *minimale* përfaqëson një shembull, i cili mund të konsiderohet si manual për tu orientuar dhe mbështetur në realizimin e qelizës së banesës kolektive popullore.

Banesa popullore duhet të përshtatet me kushtet etnike, sociale, ekonomike dhe teknike të secilit vend ku projektohen dhe ndërtohen. Faktorët që kontribuojnë në formimin e organizmit të banesës popullore janë:

1. numri i apartamenteve që do ndërtohen
2. mundësia financiare për ndërtimin e tyre
3. përshtatja me terrenin (në plan të rrafshët, në mal, në zona bregdetare, në pyje, etj.)
4. lloji i materialeve më të favorshme për tu përdorur sipas vendit ku do ndërtohet (duke korresponduar me përdorimet, industritë lokale, fuqia punëtore, etj.)
5. kushtet klimatike
6. kushtet e konomike të qirramarrësve
7. statistikat e familjes në lidhje me numrin e anëtarëve
8. statusi i pjesëtarëve të familjes dhe kushtet e tyre (nëse familja është me fëmijë të vegjël, ose me fëmijë që studiojnë apo punojnë, nëse gruaja merr pjesë në jetën e shtëpisë apo punon jashtë saj)
9. statusi social dhe politik i racës

Në varësi të shërbimeve të përgjithshme të shkallëve dhe korridoreve mund të vendosen rregullat e mëposhtme për formimin e organizmave të banesave popullore:

1. Tipi i ndërtesës së dendur me korridorin qëndror dhe i përshtatshëm për apartamente shumë të vogla dhe në rajone shumë të ftohta;
2. Tipi i ndërtesës së dendur me akomodime të shkëputura nga një shkallë dhe i përshtatshëm për apartamente shumë të vogla, ku tualeti dhe kuzhina janë të vendosura në mënyrë të tillë që të ajrosen nga një bosht;
3. Tipi i ndërtesës gjysëm të dendur i cili përgjigjet më racionalisht akomodimit me apartamente të mëdha; ;
4. tipi i rrallë i ndërtesës me ballkon të jashtëm dhe i përshtatshëm për apartamente shumë të vogla dhe gjithmonë mund të zëvendësojë tipin e dytë.

**Analizë e elementëve që përbëjnë një qelizë banimi (apartament)**

Elementët që përbëjnë dhe ndihmojnë në akomodimin e një apartamenti janë nga një numër i kufizuar dhomash, të cilat në tërësi ndihmojnë në funksionimin e mirë të jetës familjare. Të gjitha këto ambiente grupohen në dy grupe kryesore:

1. Zona e banimit që përfshin dhomat e gjumit dhe ndejtjen
2. Zona e shërbimit që përfshin kuzhinën, banjën, dushin dhe korridoret.

## Konkluzione

Interesi i lartë për tipologjinë rezidenciale, që karakterizonte veprimtarinë e arkitektëve të mëdhenj të atyre viteve mund të shpjegohet me opinionin gjithnjë e më të përhapur se çdo vepër ka kuptim vetëm nëse ruan një marrëdhënie të gjallë me kohën dhe me mjedisin në të cilin kryhet. Kjo e vërtetë e thjeshtë, e cila na është komunikuar në mënyrë eksplicite nga të gjitha veprat e mëdha arkitekturore të së shkuarës, tani po rikonfirmohet, sepse për një kohë të gjatë prirja e natyrshme drejt asaj që është vërtet e dobishme është penguar dhe mbytur nga zakoni i kopjimit të modeleve të lashta. Arkitektët mëkatuan për akademizmin, ata iu referuan një mënyre jetese të cilës nuk ia dinin më kuptimin dhe i injoruan kushtet reale të jetesës së klasës më pak të pasur, klasës punëtore (Grassi, 1975, pp. 30-34).

Në ekspozitën e dytë të Werkbund-it, në vitin 1927 Mies Van de Rohe së bashku me një grup arkitektësh prezantuan projektin e një lagje me objekte të përhershme, “Siedlung Weissenhof”, në Shtutgard. Kjo ekspozitë ishte rasti i parë ku publiku u përball me idetë e arkitektëve të rinj- që trajtonin temën e banesës dhe në veçanti atë të “banesës së punëtorëve”. Në librin e tij, Saggio (Saggio, 2010) argumenton se për të përballur sfidat në lidhje me këtë frymë të re u përpunuan shumë instrumenta që përfshinin konstruksionin, materialet dhe ndarjet organizative, duke ndikuar në të gjitha fushat e projektimit. Në vazhdimësi të kësaj fryme ishin dhe konceptet e ndarjes së qytetit, e cila nënkuptonte “ndarjen në pjesë homogjene sipas përdorimeve”. Pikërisht, kjo mënyrë të arsyetuari do të quhej “funksionalizëm” dhe strategjia ishte që qyteti të ndahej në pjesë në mënyrë që të përmirësonte efiçencën. Të gjitha këto duhet të zëvendësonin raportet e ngurta dhe jo efektive ndërmjet rrugës dhe bllokut të banimit të shekullit të XIX. Për këtë arsye, do të vazhdohej në këtë mënyrë deri sa të arrihej tek qeliza e banimit, e cila mund të realizohej vetëm nëpërmjet një studimi të detajuar të funksioneve që zhvilloheshin në të, por dhe minimizimit e shpërdorimit të hapësirave të pa nevojshme. Këto parime u prezantuan dhe në kongresin e parë të CIAM-it, në Zvicër, ku pohohej se thelbi i urbanistikës ishte funksioni. Ndërkohë në kongresin e dytë të CIAM-it, në 1929 u shtrua qartazi çështja e banesës minimale duke u shoqëruar në kongreset e tjera me trajtimin e temave të lagjes dhe qytetit. Përmirësimi i kushteve të higjienës, ajrimi dhe ekspozimi në mënyrë uniforme ndaj dritës së diellit ishin disa standarde që u morën parasysh në atë periudhë në projektimin e banesave, kushte të cilat sot mund të duken të reduktuara, por në fakt përfaqësonin një hap të rëndësishëm përpara.

# BANESAT E PUNËTORËVE NË TIRANË 4

# 4. BANESAT E PUNËTORËVE NË TIRANË

## 4.1 Zonat kryesore të banimit

Duke u mbeshtëtur tek harta e Planit Rregullues të 1939-1943 dhe konkretisht tek "Plani krahinuer dhe caqet", i punuar në shkallën 1:10 000, shohim disa zona industriale të propozuar dhe rreth tyre banesat e punëtorëve, duke krijuar lagje me karakter të shtrirë (harta 3 e planit). Ideja ishte të zhvilloheshin zona të reja në periferi të Tiranës, të cilat lejonin një shtrirje më të madhe të qytetit, por edhe lehtësonin qendrën historike të kryeqytetit. Këto modele vendbanimesh, që reflektonin modelin e lagjeve satelit industriale, ishin menduar të lidheshin nëpërmjet sistemit hekurudhor, si në nivel lokal, ashtu dhe rajonal.

Zona industriale në veri e vendosur ndërmjet Lumit të Tiranës dhe rrugës së Shkodrës do të kishte dy lagje punëtorësh që do të vendoseshin në veri të unazës së jashtme, në brezin e tokës midis unazës dhe zonës industriale. Këto lagje popullore do të kishin një rregullore të posaçme për të favorizuar ndërtimet publike dhe ndërtimet me karakter të përhershëm, gjysmë të përhershëm dhe të përkohshëm, për t'i dhënë zhvillim një zone të papërshtatshme (Hartat 19 dhe 19' të planit rregullues) (Dhamo, Thomai, & Aliaj, 2016, p. 108).

Në kodrat Jugore të qytetit nga Rruga e Elbasanit ishin parashikuar zonat për "lagjet e zotnive" me karakter të shtrirë, ndërsa në Lindje të qytetit dhe në Jug të zonës sportive ishte parashikuar një lagje me karakter mesatarisht të shtrirë e me vileta mesatare . Kjo lagje do të kishte edhe një qendër të vogël në mënyrë që të formonte një lagje autonome.

Banesat kolektive për nëpunës propozoheshin në zonën e Tiranës së re në Jug-Perëndim midis zyrave të Fashos dhe Lanës. Këto banesa do të kishin një lartësi prej 6 katesh, me hapësira e me lulishte ndërmjet tyre (këto tregohen në hartën 2' të Planit Rregullues). Këto do të ndërtoheshin nga një Ent për banesa popullore në mënyrë që pas një periudhe, pasi të kishin paguar një pjesë, nëpunësit të mund të bëheshin pronarë të tyre. Kjo mënyrë jo vetëm do të favorizonte shtresën e nëpunësve, por edhe do të frenonte spekulimet me tokën në Tiranën e re duke ofruar zgjidhje për banesat në avantazhin e Entit, i cili kështu mund të zotëronte parcela të tjera për të ndërtuar. Këto ndërtesa, të cilat konsideroheshin të larta për kohën, do të krijonin gjithashtu edhe një perspektivë interesante nga ana estetike dhe do të formonin një lloj konturi të qytetit. Shohim kështu që rreziku i spekulimit me trojet në Tiranë ka ekzistuar që në atë kohe, e po ashtu edhe përpjekjet për të trajtuar këtë problem përmes krijimit të Entit të banesave i cili do të krijonte avantazhe ekonomike dhe sociale me dobi publike.

Për t'i paraprirë zhvillimeve edhe më të mëdha të qytetit, plani parashikonte për ndërtimet private edhe zona ekstra urbane në formën e lagjeve satelite përreth Tiranës, të konceptuara si qytet kopsht. Këto zona përcaktoheshin në veri të Lumit të Tiranës në kodrat e sotme të Paskuqanit (sot vendbanimi informal Bathore-Paskuqan); dhe në kodrat e Jugut e të Lindjes së Tiranës. Pjesë e këtij plani ishte dhe zona e Laprakës e quajtur ndryshe "Villaggio del Littorio" ose "Villaggio Dux".

Një dukuri e rëndësishme që filloi në këtë periudhë ishte edhe ndërtimi i vilave urbane, të cilat ndërtoheshin nga shtresa e mesme borgjeze e kohës. Sipas Bushatit (Bushati, 2012, pp.

8-9) këto vila paraqesnin shprehje të ndryshme arkitektonike, duke nisur nga ato më tradicionalet që ndërtoheshin pa arkitektë e duke vazhduar me neoklasiket, eklektiket dhe deri tek ato ku dalloheshin elementët racionalist si rryma më e përparuar e kohës. Pronësia dhe zotërimi  i një vile të atillë në atë kohë ishte dhe nje konfirmim i një statusi social të caktuar sepse kjo kategori objektesh zotëroheshin kryesisht nga politikanë, intelektualë, nëpunës të qeverisë, tregatrë dhe familje të njohura në Tiranë. Gjuha arkitektonike e përdorur në këto vila, si për eksterierin dhe interierin ishte shumë e pasur duke u shoqëruar dhe jashtë me rrethime cilësore të oborreve. Duke iu referuar Rossit (Rossi, The Architecture of the City, 1984, pp. 77-82) që thotë se banesa është përfaqësuese e një kulture të caktuar, mund të kuptojmë ndryshimet e dukshme në banesat private në Tiranë, e cila po hynte në një epokë të re.

Ndikimi i revolucionit industrial botëror u ndje edhe në Shqipëri duke u shqëruar me lindjen e një fenomeni, strehimin. (Boriçi & Nepravishta, Apartament typologies in the residential buildings in Tirana during the period 1929-1943, 2019) Domosdoshmëria e ndërtimit të banesave për punëtorët lindi si rezultat i rritjes së menjërshme të numrit të punëtorëve shqiptare dhe italian në Tiranë, me hapjen e vendeve të reja pune nga zhvillimi urban që po merrte kryeqyteti shqiptar. Strehimi i punëtorëve ishte një nga problematikat kryesore në atë periudhë dhe kërkontë një strategji të mirëfilltë. Arkitkët italian, duke qenë se gjatë konceptimit të planeve rregulluese (sidomos ai i 1939-1943) merrnin parasysh rritjen e popullsisë, janë munduar ti reflektojnë lagjet e reja të banimit të punëtorëve në hartat e planeve.

Në Tiranë vihet re edhe prania e objekteve të veçuara, jo pjesë e një lagjeje të strukturuar, të cilat që gjatë projektimit të tyre ishin të destinuara për punëtorët dhe familjet e tyre. Edhe këto ndërtesa do të jenë pjesë e disertacionit dhe do të analizohen si objektet e tjera të strehimit.

Para se të bejme një përshkrim më të detajuar të banesave të punëtorëve do të doja të ndalesha pak tek terminologjia dhe kocepti i “banesave të punëtorëve”. Kjo është një terminologji e cila në vende të ndryshme të botës është përdorur me emra të ndryshëm por ajo çka përfaqëson është e njëjtë. Në Itali banesat e tilla janë quajtur “case popolare”, banesa popullore dhe ato projektoheshin e ndërtoheshin për shtresën e punëtorëve. Në disa vende të tjera ato janë quajtur “public houeses”, banesat publike, duke qenë se ato ndërtoheshin nga institucione të caktuara nga shteti, por në to jetonin familjet e punëtorëve.

Gjatë studimit të materialeve, përfshirë hartat e planeve rregulluese, planet pjesore të detajuara dhe planimetritë e ndërtesave të punëtorëve është nxjerr konkluzioni se banesat e punëtorëve në Tiranë mund të ndahen në tre kategori:

1. banesat e punëtorëve me shtëpi të bashkangjitura
2. banesat e punëtorëve kolektive të tipit bllok
3. banesat e punëtorëve kolektive të tipit linear

Grupi i parë i banesave është karakteristikë për fshatin “Littorio” (Laprakë) dhe kjo tipologji banese dhe në vendet e tjera zhvilloheshin kryesisht jashtë qendrave të qyteteve për shtrirjen e madhe që ato kërkojnë. Arkitektët në këtë periudhë i kushtonin rëndësi të veçantë

distancave midis shtëpive dhe ndërtesave. Ata projektuan në zonat në periferi të Tiranës, lagje me densitet të ulët. (Boriçi, Typologies of Tirana apartaments before 1990. An approach for understanding two important historical periods (1919-1943 and 1945-1990), 2018)

Grupi i dytë dhe i tretë u zhvilluan në Tiranë, kryesisht në lagjen e "Tiranës së Re" dhe në disa zona me sipërfaqe më të vogël përreth qendrës së Tiranës. Më poshtë do të shpjegohen më qartë ndërtesat e këtyre grupeve.

### 4.2 Banesat e punëtorëve me shtëpi të bashkangjitura – fshati "Littorio"

Zona e Laprakës e quajtur ndyshe "Villaggio del Littorio" është pozicionuar në pjesën veri-perëndimore të Tiranës dhe u projektua për të akomoduar punëtorët me familjet e tyre (Fig. 4-1).




*Figura 4-1. Plani i përgjithshëm i Tiranës, vendodhja e "Villaggio Littorio", sh 1:5000, 1942. Burimi: AQTN*




*Figura 4-2. Plani i vendosjes së banesave në lagjen e Laprakës "Villaggio del Littorio", viti 1940. Burimi: AQTN*

Kjo lagje u konceptua si një lagje satelit e qytetit të ri të Tiranës që po zhvillohej sipas një plani rregullues, i cili bazohej te koncepti i qytetit-kopsht. Në këto banesa të projektuara do të jetonin punëtorët që do të punonin në zonat industriale përreth. Tipologjia e këtyre banesave ishte e ngjashme me zhvillimet që kishin ndodhur në disa shtete të Evropës si Anglia, Belgjika dhe Holanda. Lagja e Laprakës u dizenjua me banesa të bashkangjitura ku secila do të kishte oborrin e vet për ta shfrytëzuar.

## 4.3 Banesat kolektive të tipit bllok

Kjo tipologji banese është karakteristikë për shumë vende të Evropës, si Italia, Franca dhe Austria, të cilat i kanë realizuar më së shumti këto banesa në vitet '30. Në figurën 4-3 është prezantuar një pjesë nga plani rregullues i 1939-1943 (harta me fletën 8) me njollat me të kuqe të banesave kolektive të cilat u projektuan dhe propozuan për tu zhvilluar në lagjen e "Tiranës së Re". Jo të gjitha ndërtesat që lexohen në hartë janë realizuar, por për pjesën më të madhe të tyre disponohen nga arkiva materialet e projekteve të dizenjuara nga arkitektët italian. Në këtë lagje vihet re tendenca e organizimit të objekteve duke krijuar sheshe dhe hapësira midis tyre. Lagja ndahet nëpërmjet rrugëve në blloqe banimi më të vogla, të cilat kompozohen nga vendosja e disa objekteve në një parcelë të madhe.



*Figura 4-3. Harta e Planit Rregullues 1939-1943 duke evidentuar banessat kolektive të propozuara për tu ndërtuar. Burimi: Baza e hartës nga AQTN, përpunuar me njollat e objekteve nga autori*



*Figura 4-4. Foto nga lagja "Tirana e Re", viti 1979, Tiranë. Burimi: AQTN*

Megjithatë, duhet theksuar se disa prej objekteve kanë një ngjashmëri me tipologjinë lineare, për nga organizmi linear që ato kanë në planimetri dhe paralelizmi i vendosjes së tyre më rrugët (Boriçi (Hoxha), Nepravishta, & Thomai, 2021).

## 4.4 Banesat kolektive të tipit linear

Kjo tipologji banese në Tiranë është përdorur në disa zona më të vogla por edhe në lagjen e "Tiranës së Re", siç janë pallatet "Moskat". Zhvillim patën edhe zonat në krah të lumit "Lana" (fig. 4-5), ku mund të përmendim katër objektet e banesave kolektive për nëpunësit të projektuara në vitin 1940. Këto ndërtesa janë vendosur pingul me drejtimin e rrugës përgjatë "Lanës" dhe paralel me njëra-tjetrën duke respektuar tipologjinë lineare të banesave. Ato përsëriten në mënyrë të rregullt dhe respektojnë një distancë prej 31.4 deri në 33 metra nga objekti në objekt. Në këto tipe banesash dhe zgjidhjet planimetrike të qelizave të jetesës realizohen të tilla qe të ketë një përsëritje lineare të tyre brenda ndërtesës, për një racionalizim sa më të mirë.




*Figura 4-5. Planvendosja e banesave kolektive lineare përgjatë "Lanës". Burimi: AQTN*



*Figura 4-6. Planvendosja e banesave kolektive "Moskat", viti 1940. Burimi: Harta e AQTN punuar mbi të nga autori*

Në Tiranë përveç lagjeve të mëdha të projektuara për nëpunësit shqiptar dhe të huaj u realizuan dhe disa banesa kolektive të veçanta, të pozicionuara në disa pika të qytetit. Një ndër to është dhe rruga “Bardhyl”, pranë së cilës u propozuan dhe realizuan dy banesa kolektive, të destinuara për nëpunësit (fig. 4-7). Autorizimi nga ana e “Ufficio Lavori Del Genio Militare” për ndërtimin e këtyre banesave u dha në prill të vitit 1940.



*Figura 4-7. Planvendosja e dy banesave kolektive në rrugën "Bardhyl", viti 1940. Burimi: AQTN*

Banesa të tjera kolektive për punëtorët u ndërtuan në lagjen e “Tiranës së Re” por të shkëputura nga grupi i parë që është përmendur më sipër me tipologjinë bllok. Ato u propozuan si blloku me gjashtë godinat shtetnore[10], me emërtimet nga 1 deri në 6 dhe brenda do të kishin shtëpitë e nëpunësve zyrtar. Blloku tjetër i projektuar ishte ai me ndërtesat me numrat IX, X dhe XI.



*Figura 4-8. Planvendosja e gjashtë banesave I, II, III, IV, V, VI për nëpunësit në lagjen "Tirana e Re", viti 1940.*

*Burimi: AQTN*

[10] Ky emër është huazuar dhe marrë siç është përdorur në dokumentet shkresor që shoqërojnë fletët e projekteve që disponohen në arkivë.




*Figura 4-9. Planvendosja e banesave IX, X dhe XI në lagjen "Tirana e Re", viti 1940. Burimi: AQTN*

Në mbyllje të këtij kapitulli është e rëndësishme të sqarohen disa terminologji të përdorura në tezën e disertacionit për të krijuar një paralelizëm me dukuritë e të njëjtës periudhë në Evropë dhe për të kuptuar ngjashmërinë dhe ndryshimet e termave të ndryshëm. Në projektet e banesave kolektive, të marra në ambientet e A.Q.T.N, gjatë leximit të letrave përballemi me terminologji të ndryshme për kategorinë e njerëzve për të cilët ato janë projektuar. Në tërësinë e projekteve, tek titujt e letrave apo tek shkresat zyrtarë lexohen fjalët; *nëpunës civil*, *punonjës zyrtar* ose *punëtorë.*

Terminologjia e përdorur në të gjitha projektet e rasteve studimore të tezës për banesat kolektive në Tiranë:

*"Palazzine alloggio ufficiali con famiglia"* - Banesa për oficerët dhe familjet

*"Palazzina alloggi sottufficiali"* - Banesë për nënoficerët

*"Palazzine Comanda Aeronautica"* - Banesa për Komandën e Forcave Ajrore

*"Shtëpit e nënpunsave, Tiranë"*- Shtëpitë e nënpunsave, Tiranë (Godinat e Aeronautikës)

*"Case per impiegati in Tirana"*- Banesa për punonjës (punëtorë) në Tiranë

Terminologji të përdorura në literaturën ndërkombëtare për tipologjitë e banesave kolektive:

*"Casa popolare"* - Banesë kolektive, banesë popullore

*"Casa collettiva popolare"* - Banesë kolektive popullore

*"Casa popolare per li operai"* - Banesë kolektive për punëtorë

Në vitet '30 në Evropë është përdorur shumë termi *banesa popullore* ose *banesa për punëtorë*, nëpërmjet të cilave nënkuptojnë banesa kolektive të ndërtuara dhe subvencionuara nga shteti dhe politikat sociale të tij. Për këtë arsye edhe rastet studimore të banesave kolektive në Tiranë janë kategorizuar si banesa punëtorësh apo banesa popullore duke u analizuar paralelisht me projektet e ngjashme ndërkombëtare.

# BANESAT KOLEKTIVE DHE ANALIZA ARKITEKTONIKE 5

# 5. BANESAT KOLEKTIVE DHE ANALIZA ARKITEKTONIKE

## 5.1 Banesat e vitit 1929 – projektet austriake

Materialet e para të projekteve për banesat publike të dokumentuara në Tiranë datojnë në periudhën e ndikimit austriak në Shqipëri. Këto banesa kanë pasur tipologji kolektive dhe individuale. Ato identifikoheshin nga numri idhomave që do të kishte secila banesë duke marrë dhe emërtimin në varësi të këtij elementi. Ashtu si është përmendur dhe në kapitujt më sipër prezenca e arkitektit austriak Hans Köhler është ndjerë jo vetëm në urbanistike dhe në planet rregulluese, por edhe në projekte të tjera. Ndër to mund të përmendim projektet e propozuara nga ai për banesa publike në Tiranë. Sipas dokumenteve të arkivit ai krijoi disa tipologji banesash individuale dhe kolektive për shtresa të ndryshme popullsie në Tiranë. Nuk dihet në qoftë se këto projekte janë realizuar apo jo, por ato vlejnë të jenë pjesë e studimit sepse ato përfaqësojnë ndër gjurmët e para[11] të projekteve për banesat publike kolektive në Tiranë. Arkitekti Köhler i tipizoi banesat sipas dy elementëve kryesorë:

1. numrit të dhomave
2. numrit të apartamenteve në ndërtesë.

Sipas konceptit të arkitektit ambienti i kuzhinës dhe ato ndihmëse nuk llogariteshin në numërimin e dhomave. Sipas numrit të dhomave banesat i klasifikonte në:

a. banesat tip me dy dhoma
b. banesat tip me tre dhoma
c. banesat tip me katër dhoma
d. banesat tip me pesë dhoma
e. banesat tip me 6-8 dhoma

Banesat me 2-3 dhoma i propozonte për shtëpi dyshe të bashkangjitura. Ato mund të ishin banesa një katëshe me dy apartament në kat ose banesa dy katëshe me secilin apartament duplex, të cilët zhvilloheshin në dy kate. Në të dyja rastet ai propozonte që në një ndërtesë të akomodoheshin dy familje gjithsej. (figura 5-1)

[11] Ky informacion është dhënë duke u bazuar tek dokumentet shkresore që disponohen në institucionet shtetërore dhe sidomos në Arkivën Qendrore Teknike të Ndërtimit, nga ku janë marrë të gjitha projektet e këtyre tipologjive banesash.




*Figura 5-1.Planimetria e katit përdhe dhe pamja nga mbrapa e banesës dyshe me 2 dhoma. Burimi; AQTN*

Banesat me më shumë se tre dhoma ai i projektonte në lartësinë e dy kateve dhe planimetritë zhvilloheshin në mënyrë të tillë që të shfrytëzoheshin nga një familje e vetme.




*Figura 5-2. Planimetritë e banesës me 4 dhoma. Burimi: AQTN*

Projektet datojnë të gjitha në vitin 1929 dhe duhet patur parasysh se ato janë një reflektim i mentalitetit shqiptar të asaj periudhe dhe përshtatje me familjet e mëdha shqiptare. Ishin vitet kur kushtet e jetesës duhet të përmirësoheshin duke nisur fillimisht nga ambienti i banimit, nyja e apartamentit, qeliza bazë e të jetuarit.

## 5.2 Banesat e periudhës 1939-1943 – projektet italiane

### 5.2.1 “Villaggio Littorio”

Zyra e Inxhinierisë Civile për Ndërtime dhe Punë Sanitare (UFFICIO DEL GENIO CIVILE PER L'EDILIZIA E LE OPERE IGIENICHE[12]) vendosi të ndërtonte 125 shtëpi banimi (casette janë quajtur në dokumentet shkresor arkivore) në “Villaggio Littorio”, Laprakë. Shkresa thekson datën e paraqitjes së ofertës nga kompania “Ing. Aurelio AURELI”, 27 mars 1940, por dokumentet janë rifreskuar dhe rikontrolluar deri në 3 korrik 1941 nga kryeinspektori i I.O.P.A (Ispettorato Opere Pubbliche Albania).

Kontrata ka për qëllim ekzekutimin dhe realizimin e të gjitha veprave që janë pjesë e projektit për ndërtimin e 125 shtëpive, banesa publike (popullore të quajtura ndryshe nga italianët dhe shkresat arkivore), pjesë të fshatit “Littorio” në Tiranë. Ndërtimet do të pozicionoheshin në Laprake, në të djathtë të rrugës Tiranë-Durrës.

Ndërtimi i këtyre banesave u nda në dy faza, ku në fazën e parë (miratuar në qershor 1941 në përputhje me vendimin nr. 662 të 15 prill 1941) do të realizoheshin 39 banesa dhe në fazën e dytë (miratuar në 25 korrik 1941 në përputhje me vendimin nr. 662 të 15 prill 1941) 86 të tjerat.

Banesat e “Villaggio del Littorio” ishin dy katëshe dhe do të strehonin katër familje në secilën godinë. Secila ndërtesë kishtë katër apartamente me hyrje të pavarura nga njëra tjetra në disa tipe ose me hyrje të përbashkët nëpërmjet shkallëve për rastin e katit sipër. Njollat e ndërtesave në plan (Fig. 4-2) ishin të njëjtat por gjatë detajimit të planimetrive të tyre u propozuan disa variante kompozimi apartamentesh. Familjet që do të strehoheshin në këto ndërtesa ishin italiane dhe shqiptare, por të gjithë punëtorë në qytetin e Tiranës ose në rrethinat e saj.




*Figura 5-3. Fragment nga fshati "Littorio". Burimi: AQTN*

Duke parë planet më të detajuara nga sipër të një fragmenti të fshatit (Fig. 5-4) kuptohet qartë pastërtia e ndarjes së parcelës për hyrjen në secilin apartament duke e shoqëruar dhe me rrugë kalimi këmbësorësh të pavarur nga njëri-tjetri. Gjithë zona është ndarë në parcela kuadratike,

[12] Nga arkivat e AQTN disponohen materiale dokumentash shkresor në lidhje me korespodenca dhe shkresa që japin informacione për ndërtimin e “Villaggio del Littorio”.

ku secili objekt vendoset sipas një orientimi sa më të mirë, ku çdo katër prej tyre krijojnë hapësira të përbashkëta.



*Figura 5-4. Fragment nga planvendosja e fshatit "Littorio". Burimi AQTN*




*Figura 5-5. Banesa tip dy katëshe, plani i katit përdhe, Laprakë. Burimi: AQTN*

Apartamentet në katin përdhe hyjnë me dyer të ndara nga njëra-tjetra, të vendosura simetrikisht me aksin e objektit. Furnizimi i katit sipër realizohet nëpërmjet shkallëve, të cilat vendosen në qendër të ndërtesës ose nëpërmjet shkallëve të jashtme, një rampëshe, të vendosura në secilin krah të godinës.

Për tipologjinë e banesave të bashkangjitura në Laprakë janë propozuar disa tipe banesash të cilat në përgjithësi janë derivat i planit të mësipërm (fig. 5-5). Baza e projektit është të zhvillohen katër apartamente në një banesë dy katëshe, por ka përjashtime ku janë krijuar disa tipologji për familje më të mëdha, me shumë pjesëtarë të cilët kanë nevojë për hapësirë më të madhe. Në këto raste, banesa në katin e parë kthehet nga skema me dy apartamente në

kat në skemën me një apartament në kat dhe gjithsej në ndërtesë organizohen tre apartamente. Ndryshimet e këtyre projekteve të propozuara për banesat e "Villaggio del Littorio" reflektohen shumë mirë në skemat e mëposhtme planimetrike (fig. 5-6 dhe fig. 5-7).




*Figura 5-6. Banesa Tip me një apartament në katin e parë. Burimi: AQTN*



*Figura 5-7. Banesa Tip me një apartament në katin e parë. Burimi: AQTN*

Në të dyja këto tipologji apartamentesh vihet re shfrytëzimi maksimal i katit të parë të ndërtesës me një apartament të vetëm. Shihet prania e tre dhomave të gjumit me katër shtretër[13] gjithsej (krevati matrimonial është llogaritur për dy shtretër) dhe ndarja e pastër e zonës së natës me zonën e ditës. Hyrja në apartament zë një sipërfaqe të konsiderueshme dhe shërben si korridor shpërndarës në ambientet e tjera të banesës. Duke qenë se sipërfaqja është e madhe në të dyja rastet e paraqitura më sipër, ambientet e ndejtjes, ngrënies dhe gatimit janë të diferencuara nga njëra tjetra në hapësira të veçanta, duke komunikiuar dhe lidhur midis tyre nëpërmjet korridorit. Nyjet higjieno sanitare i kanë të përfshira në një hapësirë të gjitha pajisjet për funksionet bilogjike-fiziologjike dhe sanitare të banorëve. Edhe pse

[13] Shpjegimi bëhet me numër shtretërish sepse në vitet kur këto banesa janë projektuar në të gjithë botën llogariteshin sipërfaqet e apartamenteve në banesat publike në varësi të numrit të shtretërve që mund të mbante dhe detyrimisht përcaktohej kategoria e familjes me numrin e pjesëtarëve që do të akomodoheshin në këto ambiente. Metodologjia e dizertacionit bazohet në metodën e ark. Klein i cili e lidhte drejtpërdrejt hapësirën minimale të nevojshme të një apartamenti me numrin e shtretërve që do vendoseshin në të.

apartament është i madh, me disa dhoma gjumi, në planimetri vihet re prania e vetëm një nyje higjieno sanitare.

Një planimetri e ngjashme me atë tip të prezantuar më sipër është edhe "banesa tip 1-bis", e cila ka shumë pak ndryshime në disa ambiente brenda apartamenteve. (fig. 4-8) Planimetria është e mobiluar dhe dallohen qartë se në këtë rast është prezantuar skema me dy apartamente në kat. Hyrjet në banesa, në katin përdhe realizohen nga faqet anësore të ndërtesës, kurse në katin e parë aksesohet nëpërmjet shkallëve të mbyllura, të vendosur në aksin e simetrisë së godinës. Siç kuptohet dhe nga shënimet origjinale të materialeve të mara nga AQTN, këto banesa projektuesit dhe inxhinierët italian i kanë quajtur "villetta".




*Figura 5-8. Plani i katit përdhe të banesës tip 1-bis. Burimi: AQTN*

Secili apartament ka tre shtretër të vendosura në dy dhoma gjumi. Hyrja së bashku me ndejtjen shkrihen në një duke mos pasur një ambient të veçantë për ndejtjen si në rastet e mësipërme. Gatimi është ambient i veçuar me një sipërfaqe afërsisht 5 m². Nyja higjieno sanitare rendit në pajisjet e saj lavamanin, wc dhe vaskën e larjes. Në të gjitha tipet e banesave të bashkangjitura të gjitha ambientet shoqërohen me ndriçim natyral nëpërmjet çarjeve që krijohen nga dritaret.

### 5.2.2 Banesat kolektive në Tiranë

Siç është përmendur dhe më sipër në qytetin e Tiranës u propozuan disa banesa kolektive të tipit bllok dhe linear. Një pjesë e tyre sipas tipologjive përkatëse do të paraqiten të ilustruara më poshtë.

- **Banesat me një apartament në kat**

Tipologjia me një apartament në kat në projektet e propozuara në atë periudhë ishte ndër më pak të realizuara edhe pse ishte e konsiderueshme në numër në projektet e arkitektëve për zgjidhjet e strehimit të punëtorëve dhe nëpunësve. Në rastet e marra në studim në disertacion, kjo tipologji përfshin 17 % të rasteve të përgjithshme të studiuara. Kjo skemë zgjidhjeje e

nyjeve të banimit shoqërohej me strukturën vertikale të lëvizjes si pjesë përbërëse e planit ose si volum bashkangjitur godinës që ngrihej si rezultat i zgjidhjes së apartamentit. Kjo tipologji kishte një karakteristikë e cila vihet re në të gjitha rastet e analizuara, që është: apartamente me sipërfaqe të konsiderueshme dhe me prani të shumë ambienteve, kryesore dhe ndihmëse. Në çdo apartament janë propozuar dy nyje higjieno sanitare, ku vetëm në njërën prej tyre është vendosur dushi apo vaska. Të gjitha këto banesa janë projektuar me bodrum, një kat nën tokë dhe lartësia e tyre shkon nga dy deri ne tre kate. Sipërfaqja e apartamenteve varion nga 107 m² deri në 220 m². Tipologjia e apartamenteve për këtë kategori klasifikimi të paraqitur janë ato me dy dhe tre dhoma gjumi. Këto të fundit janë në përqindje më të vogël, ku përfshijnë 11 % të totalit të apartamenteve. Në të gjitha banesat ambienti i gatimit është i veçuar nga zonat e tjera dhe ka sipërfaqe variabël nga 10 deri në 12 m², që konsiderohet e madhe dhe e bollshme në raport me banesat e tjera të paraqitura në vazhdimësi të temës. Nga ana tjetër 75 % e apartamenteve ndajnë brenda të njëjtit ambient dy funksione jetik të ndryshëm, që janë ndejtja dhe ngrënia. Ky është një fenomen që haset shumë shpesh në objektet e studiuara. Numri i lartë i dhomave në brendësi të sipërfaqeve krijon rehati dhe komoditet për banorët e këtyre banesave. Në rreth 50 % të apartamenteve lexohet në sipërfaqe rreth 10 m² e dhomës së shërbimit, e cila në ato vite ka mbajtur funksionin e akomodimit të shërbyesve të punësuar nga një kategori e caktuar njerëzish. Më poshtë janë paraqitur tre nga rastet e marra në studim, në të cilat dallohen qartë veçoritë e sipër përmendura.




*Figura 5-9. Plani i katit të dytë të banesës nr.5 për nëpunësa në lagjen "Tiranë e Re". Burimi: AQTN*




*Figura 5-10. Plani i katit të parë dhe të dytë në Banesën tip 82N. Burimi: AQTN*




*Figura 5-11. Planet e banesës tip U2, viti 1940. Burimi: AQTN*



*Figura 5-12. Pamjet e banesës Tip U2, viti 1940. Burimi: AQTN*

- **Banesat me dy apartamente në kat**

Kjo është tipologjia më e përhapur në banesat kolektive në Tiranë para vitit 1944. Në projektet e marra në studim rreth 43 % e tyre prezantohen si banesa me një shpërndarje prej dy apartamentesh në kat dhe një nyje vertikale në qendër të objektit duke e ndarë atë simetrikisht. Në përqindjen më të madhe, apartamentet e prodhuara nga kjo skemë janë identike në katet përdhe dhe ndryshojnë në katet sipër, ku në disa raste ambienti i përbashkët i hyrjes për në objekt në katin zero, i dedikohet vetëm njërit prej apartamenteve në katin tip. Sipërfaqja në plan e këtyre objekteve fillon nga 136 m² dhe shkon deri në 696 m². Vlera më e

lartë arrihet nga një objekt në veçanti, i propozuar për tu realizuar në zonën e "Tiranës së Re", i cili prezanton dy apartamente të bollshme në kat, në planimetrinë e tij. Kjo tipologji banese projektohet në godina me lartësi nga dy deri në tre kate dhe 70 % e tyre kanë në strukturën e tyre edhe kat nën tokë. Në rastet ku bodrumi është i pranishëm, ai shfrytëzohet nga të gjithë banorët për ambiente shërbimi, në funksion të jetesës dhe apartamenteve të tyre. Numri total i apartamenteve në këto objekte shkon nga katër deri në gjashtë, në varësi të numrit të kateve. Tipologjia në përqindje më të lartë janë banesat me dy dhoma gjumi, të cilat zënë 50% të numrit të përgjithshëm të apartamenteve të analizuara për këtë kategori. Vendin e dytë në renditje e mban tipologjia me tre dhoma gjumi e apartamenteve me 41 % të rasteve dhe në një numër të reduktuar janë projektuar, me vetëm 9% të rasteve apartamentet me një dhomë gjumi. Gjatë proçesit të hedhjes së planimetrive në programin e AutoCad-it dhe nxjerrjes së të dhënave, është parë se numri i banesave me një nyje higjieno sanitare janë të barabarta me ato me dy nyje, ku këto të fundit janë të pranishme në apartamentet e mëdha me tre dhoma gjumi dhe në disa shembuj me dy dhoma gjumi. Analiza e ndarjeve funksionale të ambienteve të brendshme të apartamenteve ka ndihmuar në disa rezultate të rëndësishme, të cilat krahasohen në kapitullin tjetër me rastet studimore të paraqitura ne tezë duke nxjerrë disa përfundime. Një ndër këto rezultate është ndarja e të njëjtit ambient midis dy funksioneve të ndryshme jetike, siç janë: ndejtja dhe ngrënia. Ky fakt vihet re në pjesën më të madhe të rasteve të kësaj tipologjie. Në asnjë nga shembujt nuk kemi një bashkëjetesë funksionale në të njëjtin ambient të ndejtjes dhe gatimit, siç ndodh në projektimet e sotme. Dhoma e shërbimit është një hapësirë, e cila është e pranishme në 15 % të rasteve të këtyre banesave, të kategorisë me dy apartamente në kat. Ndërkohë një pjesë e konsiderueshme e banesave kanë ballkon në sipërfaqet e tyre dhe shumë pak prej tyre kanë verandë.

Shembulli i mëposhtëm prezanton planimetrinë e katit përdhe dhe të katit tip të një banese kolektive të projektuar në vitin 1939 për nëpunësit civil në qytetin e Tiranës. Ky është një shembull tipik i përshkrimit të karakteristikave të përmendura në paragrafet më sipër. Në katin përdhe dallohen qartë dy apartamente identike, simetrike me njëra tjetrën, kurse në katin tip njërës prej banesave i shtohet ambienti i përbashkët i katit poshtë duke rritur numrin e dhomave për këtë apartament. Secili apartament shoqërohet me ballkone të dala konsol në perimetër të ndërtesës.




*Figura 5-13. Plani i katit përdhe të një banese kolektive për nëpunës civil në Tiranë, viti 1939. Burimi: AQTN*




*Figura 5-14. Plani i katit tip të një banese kolektive për nëpunës civil në Tiranë, viti 1939. Burimi: AQTN*

Projektimi i banesave kolektive në vitet 1939-1940 u rrit ndjeshëm duke realizuar një numër të madh projektesh në letër, nga të cilat një pjesë e madhe u zbatuan në terren. Një nga ndërtesat e dizenjuara në vitin 1940, në lagjen "Tirana e Re" është shembulli i mëposhtëm, një modul i përsëritur në planvendosjen e përgjithshme të kësaj lagjeje. Thyerjet e shumta në planimetri sjellin një fragmentizim të volumeve në altimetri duke krijuar një lojë interesante dritë hijeje. Skema e shpërndarjes së apartamenteve dhe ndarjes së hapësirave të përbashkëta është njësoj si në shembullin e parë, dy apartamente simetrike në katin përdhe dhe dy të ndryshëm në katin sipër, ku njërit prej tyre i dedikohet një ambient shtesë, duke rritur sipërfaqen e këtij apartamenti. Veçanti për këtë rast studimor është nën çatia, e cila vjen si rezultat i një kati të tërhequr, dedikuar plotësisht ambienteve në shërbim të të gjithë banorëve dhe me akses të përbashkët. Secili apartament është i plotësuar me një ballkon. Në rastet kur projekti shoqërohet edhe me pamje tre dimensionale të ndërtesës (si në këtë shembull), ai paraqet një interes të veçantë në aspektin grafik në prezantimin e tij në disertacion.




*Figura 5-15. Plani i katit përdhe dhe të parë në banesën kolektive nr. I, "Tiranë e Re", viti 1940. Burimi: AQTN*




*Figura 5-16. Plani i katit të dytë (nën çatia) në banesën nr. I, "Tiranë e Re", viti 1940. Burimi: AQTN*




*Figura 5-17. Perspektiva e banesës nr. I në "Tiranën e Re", 1940. Burimi: AQTN*

Në këtë rast studimor përballemi me një volum të pastër, i cili sjell lëvizje të vogla nëpërmjet daljes së disa ballkoneve konsol në perimetër të ndërtesës në katet sipër. Vazhdon skema e simetrisë së apartamenteve në katin përdhe dhe ndryshimet e rritjes së sipërfaqes për njërin nga apartamentet në katet sipër. Kjo ndërtesë, e projektuar në lagjen “Tirana e Re” shkon në lartësinë e dy kateve mbi tokë dhe një kat bodrum. Apartamentet në këtë objekt kanë tre dhoma gjumi, dy nyje higjieno sanitare dhe ambientin e gatimit të diferencuar nga ndejtja dhe ngrënia. Numri i personave që mund të akomodohen në secilën banesë është pesë për shkak të sipërfaqes së vogël të njërës prej dhomave të gjumit. Në planimetri vihet re prania e çarjeve dhe ndriçimi natyral në secilin ambient të apartamentit, veçori karakteristikë për të gjitha projektimet e periudhës së marrë në studim.




*Figura 5-18. Plani i katit përdhe të banesës nr. I në grupin e 6 pallateve, "Tiranë e Re". Burimi: AQTN*




*Figura 5-19. Plani i katit të parë të banesës nr. I në grupin e 6 pallateve, "Tiranë e Re". Burimi: AQTN*

- **Banesat me katër apartamente në kat**

Banesat me katër apartamente në kat janë më shumë të tipit linear dhe janë të pranishme në disa lagje të Tiranës si: “Tirana e Re”, tek rruga “Bardhyl” dhe përgjatë lumit “Lana”. Më poshtë ilustrohen nëpërmjet figurave disa planimetri të këtyre banesave. Nga shembujt e marrë në studim vihet re se shumë prej këtyre projekteve, të kësaj tipologjie janë përsëritur në zona të ndryshme të Tiranës. Këto banesa shkojnë deri në lartësinë e tre kateve, por disa prej tyre ndërtohen deri në dy kate lartësi. Të gjitha rastet studimore të analizuara në këtë tezë disertacioni janë projektuar me një kat nën tokë dhe bodrumi është përdorur për shfrytëzim të përbashkët të të gjithë banorëve të pallatit. Në banesat e kësaj tipologjie janë të pranishme të gjitha tipet e apartamenteve, ku në përqindje të barabartë, respektivisht rreth 30 % secila zënë apartamentet me një dhe dy dhoma gjumi dhe 40% të shembujve përfshijnë apartamentet me tre dhoma fjetjeje. Gjatë studimit të rasteve, vihet re se ’67 % e apartamenteve kanë të pranishëm një tualet, por ato janë kategoria me dy dhoma gjumi dhe maksimumi katër krevat

fjetjeje. Në apartamentet e grupit “Moskat”dhe të pallateve të “Lanës”, të cilat kanë një strukturë ndërtimi shumë të ngjashme, por jo vetëm sepse të tilla janë dhe në zgjidhjet funksionale të apartamenteve dhe hapësirave lexohet prezenca e dy tualeteve në secilën nyje banimi. Vlen për tu përmendur që në shembujt e sipër përmendur janë projëktuar banesa me tre dhoma gjumi dhe të paktën pesë krevat[14] fjetjeje. Ambientet e zonës së natës projektoheshin me sipërfaqe të bollshme, duke filluar nga 12 m² e deri në 19 m². Në grupin e pallateve me katër apartamente në kat, nuk rezulton në asnjë nga apartamentet, një bashkëveprim funksional në të njëjtin ambient, i ndejtjes dhe gatimit. Në pjesën më të madhe të rasteve, ngrënia është mbivendosur në ambientin e kuzhinës, por në një pjesë të tyre ajo është e pranishme dhe në dhomën e ndejtjes.

Shembulli i mëposhtëm prezanton katin përdhe të pallatit të ndërtuar për nëpunësat, në rrugën “Bardhyl”, Tiranë. Nga imazhi dallohet qartë prania e katër apartamenteve në kat dhe tipologjitë e nyjeve të banimit me një dhe dy dhoma gjumi. Në disa prej apartamenteve mundësohet dhe hyrja për në banesë nëpërmjet shkallëve me akses nga ballkoni, duke mënjanuar nyjen vertikale të përbashkët për të gjithë godinën.




*Figura 5-20. Plani i katit përdhe e banesës tek Rr. "Bardhyl", viti 1940. Burimi: AQTN*

Rasti tjetër studimor për tezën janë pallatet përgjatë “Lanës”, të cilat paraqesin katin përdhe, katin tip dhe një pamje të objektit. Ato janë banesa lineare dhe përsëriten katër herë si një modul. Siç u përmend dhe më sipër, apartamentet në këto banesa janë të tipit me tre dhoma gjumi dhe dy tualete.

[14] Fjala krevat është përdorur në dizertacion sepse gjatë studimit të literaturës së huaj është evidentuar se në vitet 1925-1943 të projektimit, në të gjithë botën kishtë rëndësi numri i personave që do të akomodoheshin në një apartament. Në veçanti arkitekti A.Klein ka punuar dhe analizuar mbi ekzistenc minimumin e jetesës duke e konsideruar një zë të rëndësishëm numrin e krevateve në një banesë.




*Figura 5-21. Plani i katit përdhe e njërës prej banesave kolektive, tipi linear, përgjatë "Lanës", viti 1940. Burimi: AQTN*




*Figura 5-22. Plani i katit të parë e të dytë e njërës prej banesave kolektive, tipi linear, përgjatë "Lanës", viti 1940. Burimi: AQTN*




*Figura 5-23. Plani i katit të parë e të dytë dhe pamja nga mbrapa e njërës prej banesave kolektive, tipi linear, përgjatë "Lanës", viti 1940. Burimi: AQTN*



*Figura 5-24. Foto e pallateve të nëpunësve përgjatë "Lanës", viti 1989, Tiranë. Burimi: AQTN*

Grupi "Moskat" i pallateve është një tipologji projektimi e ngjashme me ato përgjatë "Lanës", por ndryshojnë në raport me sipërfaqet e përbashkëta dhe ambientet e ballkoneve. Hyrjet për në objekt, në katin përdhe janë në krahe të kundërt nga njëra tjetra duke ndryshuar me diferencë të vogël, raportin e apartamenteve të katit tip.




*Figura 5-25. Plani i katit përdhe për banesën e "Grupit Moskat", Tiranë e Re, viti 1940. Burimi: AQTN*




*Figura 5-26. Pamja nga jugu për banesën e "Grupit Moskat", Tiranë e Re, viti 1940. Burimi: AQTN*

- **Banesat me më shumë se katër apartamente në kat**

Kjo tipologji banese është më shumë e pranishme në banesat kolektive të tipit bllok. Arkitektët italian kanë propozuar projekte ndërtesash strehimi rreth fundit të viteve ’30 dhe deri ne 1943 për punëtorët dhe punonjësit e qytetit të Tiranës. Në Planin Rregullues të Përgjithshëm lexohen njollat e ndërtesave të projektuara nga arkitektët për strehimin e punonjësve. Një fragment i planit është paraqitur më poshtë për të prezantuar raportin hapësinor dhe parcelizimin që ato krijojnë në lagjen “Tirana e re”. Përpjekja për të krijuar oborre të përbashkëta dhe hapja e komunikimit të ndërtesave nëpërmjet korridoreve të kateve përdhe nga prezenca e kolonave të hapura është një dukuri e pranishme në këtë grup banesash të projektuara në vitin 1941. Për shkak të ngjarjeve historiko-politike që ndodhën pas vitit 1943, një pjesë e këtyre projekteve nuk u realizuan dhe mbetën vetëm në kuadrin e projekt idesë dhe propozimeve.




*Figura 5-27. Planvendosja e grupit të tretë të banesave për punëtorët, "Tiranë e Re", viti 1942, Burimi: AQTN*

Ndërtesat e kësaj tipologjie klasifikimi u propozuan të ndërtoheshin nga tre deri në katër kate lartësi, duke qëndruar brenda të njëjtës linjë projektimi.

Projekti i mëposhtëm (figura 5-28, 5-29, 5-30) është një shembull tipik i pasqyrimit të zhvillimit dhe evolucionit që mori projektimi në vitet 1940-1943 në Shqipëri dhe konkretisht në kryeqytet. Gjatë projektimit dhe propozimit të banesave të nëpunësve, u mendua nga arkitektët italian, paralelisht edhe zhvillimi që do të merrte zona dhe lagjet e reja nga ndërtimi i këtyre objekteve. Një pjesë e kateve përdhe të godinave, të cilat kishin akses të drejtpërdrejtë nga rruga u dizenjuan me dyqane dhe ambiente shërbimi. Prania e kolonave të hapura lejonte krijimin e disa korridoreve kalimi, të cilat mundësonin komunikim midis pjesëve të ndryshme të së njëjtës ndërtesë dhe mbronin këmbësorët gjatë qarkullimit nën

strehën e krijuar. Lëvizjet e shumta që realizoheshin në planimetritë e banesave reflektoheshin në krijimin e oborreve të brendshëm dhe të jashtëm. Përballja altimetrike e ndërtesave realizohej nëpërmjet një sheshi të hapur, i cili aksesohej nga makinat dhe këmbësorët.

Disa prej këtyre banesave u projektuan më një kat nën tokë, por rasti i pallatit civil nuk kishte bodrum në strukturën e ndërtesës. Siç lexohet qartë në planimetri, kati përdhe mban pjesërisht ambiente banimi dhe pjesa tjetër i është dedikuar hapësirave të shërbimit në funksion të banorëve dhe të gjithë zonës. Ky ishte ndër shembujt e parë që u prezantuan në këtë formë, duke sjell një risi për projektimin në Shqipëri, pavarësisht  pamundësisë për realizimin e tij.




*Figura 5-28. Plani i katit përdhe të banesës kolektive në bllokun e III, "Tiranë e Re", viti 1941. Burimi:*

Në tre katet sipër, ky objekt ngrihet mbi një planimetri tip, dedikuar vetëm banimit dhe strehimit të nëpunësve.



*Figura 5-29. Plani i katit përdhe dhe tip i banesës kolektive në bllokun e III, "Tiranë e Re", viti 1941. Burimi: AQTN*









*Figura 5-30. Pamjet dhe perspektiva e banesës kolektive në bllokun e III, "Tiranë e Re", viti 1941. Burimi: AQTN*

## 5.3 Analiza e banesave. Metodologjia

Në të gjithë Evropën, problemi i kërkesës për strehimin e klasës punëtore ishte prioritet për të gjitha qeveritë. Arkitektë të ndryshëm analizonin sipas këndvështrimeve të veta problemet dhe zgjidhjet e strehimit. Giuseppe Samonà (Samonà, L'urbanistica e l'avvenire della città, 1959, p. 83) shkruante se: "*Arkitektët racionalistë e shihnin shtëpinë si një simbol etik, dhe në të njëjtën kohë ajo i bëri ata të vepronin me ashpërsi logjike. Shtëpia dhe lagjja ishin në qendër të urgjencës morale ... për të arritur, me koherencën midis funksionit dhe formës, një harmoni që funksiononte nga brenda "qelizës" në të cilën jeton njeriu, duke treguar një mënyrë për të zgjidhur të gjitha konfliktet shoqërore*"

Një pjesë e rëndësishme e disertacionit, pas prezantimit të projekteve të zgjedhura për temën sipas tipologjive të tyre, është analizimi dhe nxjerrja e të dhënave të qelizave të banesave, pra apartamenteve. Të dhënat statistikore dhe sasiore janë arritur pas analizimit të çdo apartamenti në të gjitha banesat kolektive të studiuara në disertacion.

Për përshkrimin dhe rëndësinë e të dhënave të qelizave të strehimit kërkimi është bazuar tek metodologjia që ka ndjekur Alexander Klein në studimin e tij të *ekzistencminimum* për banesën e viteve '30 në Gjermani. Roli dhe rëndësia e këtij arkitekti në projektimin e banesave rezidenciale është përmendur dhe në kapitullin e sfondit teorik.

### Metoda e analizës në modelin minimal të një banese sipas A.Klein

Deri në periudhën që Klein filloi të analizonte banesat dhe kushtet që duhet të kishin ato për të plotësuar jetesën minimale për një familje, ndërtesat e larta që projektoheshin dhe ndërtoheshin, nuk mund të përballoheshin nga klasa punëtore[15]. Klein mori disa shembuj banesash e apartamentesh për të analizuar dhe krahasuar, me qëllim të gjente elementët dhe faktorët që përcaktonin më së miri banesën minimale.

Gropius e ka përcaktuar *Ekzistencminimum* si "*minimumin e hapësirës, ajrit, dritës dhe nxehtësisë së nevojshme për njerëzit për zhvillimin e funksioneve të tyre jetësore, pa kufizime për shkak të banesës*" (Gropius, Die soziologischen Grundlagen der Minimalwohnung. Die Wohnung fur das Existenzminimum, 1959).

Klein parashtroi problemin e strehimit duke e pasuruar analizën me parametra për vlerësimin e efekteve psikologjike që do të kishte tek njerëzit. Në këtë mënyrë ai nuk u bazua tek përmasat për krijimin e hapësirave, por tek numri i shtretërve, domethënë tek familja për të cilën ishte caktuar banesa. Numri i shtretërve u bë njësia matëse për të gjitha ekzistencat e jetesës dhe për pasojë përcaktoi sasinë e hapësirave të nevojshme për dhomat e pritjes dhe të ngrënies, kuzhinat dhe banjat. Para se të niste analizën e tij dhe të arrinte në konkluzionet e shumë kërkuara, Klein e shpërndau gjithë proçesin e kërkimit të tij në disa faza. Faza e parë kishte renditjen e disa pikave të domosdoshme të cilat duhet të plotësoheshin patjetër gjatë programit të tij të strehimit. Ato ishin si më poshtë:

[15] Një shtëpi duhet të kishte të paktën një dhomë, minimum 20 $m^2$, dhomat e tjera duhet të kishin një sipërfaqe jo më të vogël se 14 $m^2$, kuzhina duhet të ishte 10 $m^2$, 6 $m^2$ i jepeshin një ambienti ndihmës, i cili mund të shërbente si depo ose dhomë me një krevat tek. Sipërfaqja mesatare duhet të ishte 100 $m^2$ për një banesë me tre dhoma dhe 130 $m^2$ për një shtëpi me katër doma. Sipërfaqet e mëdha rrisnin ndjeshëm kostot e këtyre apartamenteve.

1. Banesa nuk duhet të kushtojë, duhet të jetë e lirë dhe çdo parametër që përcakton vlerën e banimit duhet të minimizohet.
2. Banesa duhet të jetë higjienike, duke u kompletuar me pajisjet sanitare dhe dhomat duhet të jenë të diellzuara dhe të ventiluara.
3. Banesa duhet të jetë pa probleme duke i siguruar familjes kushtet më të mira për jetesë dhe duke realizuar gjithë detyrat pa harxhuar kohë dhe energji.
4. Banesa duhet të përcjelli ndjesinë e hapësirës me hapësira që harmonizohen në formë, drita dhe ngjyra.

Metoda grafike, inovative dhe matematikisht rigoroze e Klein filloi me krahasimin e tipeve të ndryshme të apartamenteve duke synuar përcaktimin e termave objektivë për vlerësimin e cilësisë së projektimit. Ai e studioi problemin e banesës në kompleksitetin e vet, duke konsideruar ndikimin që kishin kushtet e jetesës tek psikika e njeriut. Ai e bazoi metodikën e tij më shumë në nevojat familjare dhe ato të individit se sa higjiena sanitare personale. Metodika e tij akoma është e rëndësishme dhe mund të merret si një pikë referimi për analiza të ngjashme.

Klein krijoi një tabelë (tabela 5-1) pikësimi ku rendiste disa të dhëna që ai mendonte se ishin të rëndësishmë për tu analizuar në një apartament.

*Tabela 5-1. Tabela e A.Klein e përdorur në analizimin e apartamenteve të marra në studim*

| 11 | 10 | 9 | 8 | 7 | 6 | 5 | 4 | 3 | PROJECT NR. | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 65.76 | 75.46 | 73.14 | 89.40 | 90.00 | 80.94 | 88.00 | 66.82 | 74.18 | 1 | BUILT AREA | MAIN CHARACTERS OF THE HOUSE | ECONOMIC ASPECTS |
| 274 | 324 | 314 | 393 | 387 | 360 | 392 | 283 | 319 | 2 | BUILT VOLUME | | |
| 51.47 | 53.18 | 64.45 | 63.02 | 65.45 | 61.33 | 65.90 | 51.10 | 58.35 | 3 | USED AREA | | |
| 2 | 1.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2 | 2 | 4 | AMOUNT OF ROOMS | | |
| 2 | 3 | 3 | 4 | 3 | 3 | 2.5 | 2 | 2 | 5 | AMOUNT OF BEDS | | |
| 32.90 | 25.15 | 29.76 | 22.26 | 30.00 | 26.98 | 29.33 | 33.41 | 37.09 | 6 | BETTEFFEKT: 1/5 | | |
| 137 | 108 | 128 | 98 | 129 | 120 | 131 | 141 | 159 | 7 | BUILT VOLUME PER BED 2/5 | | |
| 16.40 | | 20.60 | 20.00 | 17.30 | 20.00 | 21.00 | 20.25 | 24.10 | 8 | LIVING ROOM'S AREA | MAIN ROOMS | |
| 13.50 | 32.60 | 22.60 | 26.45 | 28.95 | 22.75 | 24.40 | 14.00 | 13.90 | 9 | BEDROOM'S AREA | | |
| 29.90 | 32.60 | 43.20 | 46.45 | 46.25 | 42.75 | 45.40 | 34.25 | 38.00 | 10 | RESULTING AREA 8+9 | | |
| 15.30 | 11.40 | 11.30 | 8.70 | 10.60 | 10.80 | 11.20 | 9.80 | 9.75 | 11 | KITCHEN'S AREA | SECONDARY ROOMS | |
| 3.85 | 4.32 | 4.75 | 3.92 | 4.30 | 4.00 | 5.00 | 3.65 | 4.20 | 12 | BATHROOM'S AREA | | |
| 2.42 | 4.86 | 5.20 | 3.95 | 4.30 | 3.78 | 4.30 | 3.40 | 6.40 | 13 | SERVICE AREA | | |
| 21.57 | 20.58 | 21.25 | 16.57 | 19.20 | 18.58 | 20.50 | 16.85 | 20.35 | 14 | RESULTING SERVICE AREA 11+12+13 | | |
| 0.783 | 0.705 | 0.722 | 0.705 | 0.727 | 0.758 | 0.749 | 0.765 | 0.787 | 15 | NUTZEFFEKT: 3/1 | COEFF. | |
| 0.455 | 0.432 | 0.483 | 0.520 | 0.514 | 0.528 | 0.516 | 0.512 | 0.512 | 16 | WOHNEFFEKT: (8+9)/1 | | |

Kjo metodë është përdorur dhe në disertacion duke krijuar dy tipe tabelash për çdo ndërtesë të marrë në studim dhe për tipologjitë e apartamenteve të secilës banesë.Çdo ndërtesë është punuar grafikisht në AutoCad duke arritur marrjen e të gjitha të dhënave të nevojshme për të plotësuar tabelat, të cilat prezantohen më poshtë.

Nga tabela 5-2 merret informacion mbi disa të dhëna të rëndësishme të projektimit të banesave në Shqipëri para vitit 1944. Ne mund të analizojmë se cila është tipologjia e ndërtesave sipas lartësisë së tyre, pra banesa të ulta apo të larta. Nga kjo tabelë arrijmë të diferencojmë ato objekte të cilat kanë në strukturën e tyre kat nën tokë, pra prani ose jo të bodrumit në ndërtesë. Në bazë të të dhënave të specifikuara në tabelë, arrijmë të nxjerrim konkluzionin se cila tipologji apartamenti është më shumë prezente në projektet e periudhës

se marrë në studim. Duke u bazuar tek kjo tabelë është bërë dhe klasifikimi i banesave sipas numrit të apartamenteve në kat, duke parë rezultatet se cila kategori mbizotëron.

*Tabela 5-2. Tabela e nxjerrjes së të dhënave në shkallë ndërtese*

| PALLATET MOSKAT | | |
|---|---|---|
| 731 | 1 | SIP.NJOLLE OBJEKTI |
| 3 | 2 | Nr.KATE (mbi tokë) |
| 1 | 3 | Nr.KATE (nën tokë) |
| 4 | 4 | Nr.AP./KAT |
| 12 | 5 | NR. APART./GODINE |
| - | 6 | Nr.Ap.1+1 TOTAL |
| - | 7 | Nr.Ap.2+1 TOTAL |
| 12 | 8 | Nr.Ap.3+1 TOTAL |
| 234 | 9 | SIP.SHKALLE E PERBASHKET / GODINE |
| - | 10 | KATI PERDHE KA SHERBIME APO JO/ DYQANE |

Tabela e mëposhtme (tabela 5-3) vjen si rezultat i një analize më të detajuar të secilit apartament në ndërtesë duke i ndarë ato në tipologji. Për secilën nyje banimi janë nxjerrë të dhënat e ambienteve brenda dhe të gjitha shërbimeve të pranishme, brenda apo jashtë sipërfaqes së shfrytëzueshme apo të shkelshme të apartamentit. Për të kuptuar si qëndron projektimi i ambienteve të ndejtjes, gatimit dhe ngrënies, ato janë ndarë si zëra të veçantë.

*Tabela 5-3. Tabela e nxjerrjes së të dhënave në shkallë apartamenti*

| PALLATET MOSKAT Ap.3+1 | Ap.2+1 | Ap.1+1 | | |
|---|---|---|---|---|
| 12 | | - | 1 | NR APARTAMENTESH |
| 161 | | - | 2 | SIP. BRUTO APARTAMENTI |
| 1932 | | - | 3 | SIP. BRUTO/ GODINE |
| 128 | | - | 4 | SIP. E SHFRYTEZUESHME, E SHKELSHME |
| 33 | | - | 5 | SIP. E MUREVE |
| 6 | | - | 6 | NR. DHOMAVE / APARTAMENT |
| 3 | - | - | 7 | NR. DHOMAVE TE GJUMIT/ APARTAMENT |
| 5 | - | - | 8 | NR. KREVATEVE |
| 1 | - | - | 9 | NR. TUALETEVE |
| 20 | - | - | 10 | SIP. NDEJTJE |
| 13 | - | - | 11 | SIP. GATIMI |
| - | - | - | 12 | SIP. NGRENIE |
| + | - | - | 13 | NDEJTJA + NGRENIA |
| - | - | - | 14 | NDEJTJE + GATIMI |
| + | - | - | 15 | GATIM + NGRENIE |
| 12 | - | - | 16 | SIP. DH.GJ. 1 |
| 19 | - | - | 17 | SIP. DH. GJ. 2 |
| 18 | - | - | 18 | SIP. DH.GJ. 3 |
| 49 | - | - | 19 | SIP. DHOMA GJUMI TOTALI |
| 5 | - | - | 20 | SIP. BANJE 1 |
| - | - | - | 21 | SIP. BANJE 2 |
| 5 | - | - | 22 | SIP. BANJE TOTALI |
| 25 | - | - | 23 | SIP. KORRIDOR/ HYRJE |
| - | - | - | 24 | SIP. BALLKONI |
| - | - | - | 25 | SIP. VERANDE |
| 16 | - | - | 26 | SIP. LAVANDERI/ DEPO/ SHERBYES |
| - | - | - | 27 | SIP. SHKALLE E BRENDSHME |

Pas plotësimit të tabelave, i gjithë informacioni është hedhur në Excel për të marrë rezultatet e kërkuara. Janë krijuar disa tabela sipas shembullit të tabelës 5-4 dhe 5-5 të cilat pasqyrojnë në mënyrë të përmbledhur dhe rigoroze të dhënat e grumbulluara nga të gjitha informacionet e marra nga matjet dhe rilevimet e ambienteve të tipologjive të ndryshme të apartamenteve. Duke parë raportin e zërave të ndryshëm të tabelave janë arritur disa konkluzione në lidhje me banesat kolektive të punonjësve të projektuara në Tiranë në periudhën 1925-1943.

*Tabela 5-4. Paraqitja e të dhënave në raport godine, të pesë banesave kolektive me tipologji të ndryshme*

| | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Tabela 1** | | Banese **TUDINI** | Italinet 1939-1945 Pallati Civil | Italinet 1939-1945 Pallati 9 Tirane e Re | Italinet 1939-1945 Banesa TIP 3 LITTORIO | Italinet 1939-1945 Banesa TIP 2 LITTORIO |
| 1 | Siperfaqe njolle | m2 | 278 | 1500 | 440 | 176 | 201 |
| 2 | Numri kateve(mbi toke) | njesi/Kat | 3 | 4 | 3 | 2 | 2 |
| 3 | Numri kateve(nen toke) | njesi/Kat | | | 1 | | |
| 4 | Numri apartamenteve/KAT | njesi/Kat | 3 | 8 | 4 | 2 | 2 |
| 5 | Numri apartamenteve/Godine | njesi/Kat | 9 | 24 | 12 | 4 | 4 |
| 6 | Numri apartementeve 1+1 total | njesi | 6 | 3 | 6 | | |
| 7 | Numri apartementeve 2+1 total | njesi | 3 | 12 | 6 | 4 | 4 |
| 8 | Numri apartementeve 3+1 total | njesi | | 9 | | | |
| 9 | Sip.perbashket /Godine | m2 | 66 | 270 | 76 | 10 | 9 |
| 10 | Siperfaqe shkalle e jashtme | m2 | | | | | |

*Tabela 5-5. Tabela e grumbullimit të të dhënave të disa rasteve studimore sipas ambienteve dhe sipërfaqeve të tyre*

| | **Tabela 2** | AERONAUTIKA TIP DJATHTAS B | | | | Italianet 1939-1945 Pallati CIVIL | | | Italianet 1939-1945 Pallat 9 Tirane e Re | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Apart 1+1 T1 | Apart 1+1 T2 | Apart 1+1 T3 | Apart 2+1 | Apart. 1+1 | Apart. 2+1 | Apart. 3+1 | Apart. 1+1 | Apart. 2+1 |
| 1 | Numer Apartamentesh | 2 | 6 | 6 | 4 | 3 | 12 | 9 | 6 | 6 |
| 2 | Siperfaqe Bruto/Apart.i | 90 | 100 | 108 | 110 | 140 | 150 | 213 | 88 | 119 |
| 3 | Siperfaqe Bruto/Godine | 180 | 600 | 648 | 440 | 420 | 1800 | 1917 | 528 | 714 |
| 4 | Siperfaqe e shfrytezueshme ,e shkelshme | 74 | 75 | 84 | 87 | 121 | 125 | 177 | 70 | 94 |
| 5 | Siperfaqe e mureve | 16 | 25 | 21 | 20 | 19 | 25 | 36 | 18 | 25 |
| 7 | Numer dhomave/Apart. | 3 | 3 | 3 | 4 | 3 | 4 | 5 | 3 | 4 |
| 7 | Numer te gjumit/Apart. | 1 | 1 | 1 | 2 | 1 | 2 | 3 | 1 | 2 |
| 8 | Numer Krevateve | 2 | 2 | 2 | 3 | 2 | 3 | 4 | 2 | 3 |
| 9.3 | Numer Tualeteve | 1 | 1 | 1 | 1 | 2 | 2 | 2 | 1 | 1 |
| 10 | Siperfaqe ndejtje | 24 | 25 | 20 | 24 | 16 | 17 | 20 | 19 | 19 |
| 11 | Siperfaqe gatimi | 16 | 16 | 20 | 16 | 15 | 16 | 12 | 13 | 15 |
| 12 | Siperfaqe ngrenie | | | | | 13 | 15 | 17 | | |
| 13 | Siperfaqe zona dite | 40 | 41 | 40 | 40 | 44 | 48 | 49 | 32 | 34 |
| 14 | Ndejtja+Ngrenia | | | | | | | | | |
| 16 | Ndejtje+Gatim | | | | | | | | | |
| 17 | Gatim+Ngrenie | 1 | 1 | 1 | 1 | | | | 1 | 1 |
| 18 | Siperfaqe Dhome Gjumi 1 | 19 | 16 | 20 | 19 | 26 | 20 | 20 | 15 | 17 |
| 19 | Siperfaqe Dhome Gjumi 2 | | | | 13 | | 20 | 14 | | 19 |
| 20 | Siperfaqe Dhome Gjumi 3 | | | | | | | 12 | | |
| 21 | Siperfaqe dhoma gjumi Totale | 19 | 16 | 20 | 32 | 26 | 20 | 46 | 15 | 36 |
| 22 | Siperfaqe banjo 1 | 5 | 5 | 4 | 5 | 9 | 6 | 6 | 7 | 5 |
| 23 | Siperfaqe banjo 2 | | | | | 3 | 3 | 7 | | |
| 24 | Siperfaqe banjo total | 5 | 5 | 5 | 4 | 12 | 5 | 13 | 7 | 5 |
| 25 | Siperfaqe koridori/Hyrje | 10 | 13 | 20 | 10 | 30 | 24 | 47 | 13 | 13 |
| 26 | Siperfaqe Ballkoni | | | 3 | 3 | 12 | 7 | 23 | 8 | 14 |
| 27 | Siperfaqe verande | | | | | | | | | |
| 28 | Siperfaqe Lavanderi/Depo/Sherbyes | | 3 | | | | | 9 | | 6 |
| 29 | Siperfaqe shkalleve te brendshme | | | | | | | | | |

Konkluzioni që do të arrihet në fund pas analizimit të këtyre ambienteve do na qartësojë mënyrën e të konceptuarit të komoditetit të jetesës në ato vite nga arkitektët projektues, të cilët gjithmonë i përshtaten mentalitetit të jetesës së shoqërisë dhe banorëve që akomodohen në këto ndërtesa. Ky rezultat i arrirë na ndihmon për një krahasim[16] të mëtejshëm të mënyrës së projektimit në intervalin kohor të marrë në studim me projektimet e huaja, sidomos të shembujve ndërkombëtar. Ky kapitull i paraprin rezultateve, të cilat reflektojnë grafikët e arritura nga tabelat e mësipërme, mbeshtetur në metodologjinë e zgjedhur. Në këtë pikë të kërkimit shfrytëzohet metoda analitike, e cila do të ndiqet nga metoda krahasimore pas prezantimit të rasteve studimore ndërkombëtare në kapitullin 7, të banesave të punëtorëve të zgjedhura për këtë tezë disertacioni. Përdorimi i programit Excel dhe kombinimi i qelizave të tabelave me informacion të njëtë, sipas numrit të apartamenteve, tipologjisë së apartamentit, llojit të ambientit, numrit të ambienteve, etj, ka sjell ndërtimin e grafikëve të ndryshëm, të cilët kanë ndihmuar në rezultatet e banesave kolektive në Tiranë dhe në seleksionimin e informacionit në lidhje me këto banesa.

[16] Mund të shërbejë në të ardhmen për kërkues të tjerë, të cilët mund të krahasojnë periudha të ndryshme kohore projektimi, brenda apo jashtë Shqipërisë me vitet e para 1944 në vendin tonë.

# REZULTATET E APARTAMENTEVE NË TIRANË 6

# 6. REZULTATET E APARTAMENTEVE NË TIRANË

## 6.1 Tipologjitë e ndërtesave

Analiza e llojeve, modeleve dhe morfologjive është realizuar në këndvështrimin e identifikimit të tyre si kulturë ndërtimi e projektuar dhe finalizuar në ato vite. Ky kapitull është një plotësim i rezultateve të arritura nga analiza statistikore, funksionale dhe arkitektonike e banesave të projektuara në Tiranë, përgjatë zhvillimeve të ndryshme historike, të ndodhura në vendin tonë. Duke hedhur sytë drejt ndërtesave të projektuara e ndërtuara në këtë fazë, tentohet të kuptohet se si këto struktura jetike reflektojnë zhvillimet e kohës dhe ndikimet e Evropës. Duke kaluar në mënyrë kronologjike trajtohen tipologjitë e banesave dhe analizohen ngjashmëritë ose ndryshimet në raport me njëra tjetrën[17].

Në vitet 1925-1943 në Tiranë u projektuan banesa të mesme, me lartësi dy deri në katër kate. Se si qëndron raporti dhe përqindja midis tyre lexohet qartë në figurën 6-1, të paraqitur më poshtë. Sipas tipologjive të projekteve të analizuara dhe jo objekteve[18] të ndërtuara në qytetin e Tiranës, 50% e rasteve studimore janë projektuar në lartësinë e dy kateve. Në përqindje shumë më të ulët, rreth 4% shihet prania e ndërtesave katër kate në projektet e propozuara dhe 46% e të gjitha rasteve studimore janë objekte, që ngrihen në lartësinë e tre kateve mbi tokë.

•



• *Figura 6-1. Paraqitja grafike e raportit në përqindje të godinave sipas numrit të kateve, projektuar para 1944, Tiranë*

• Një pjesë e godinave të banimit në Tiranë u konceptuan me bodrume. Ato përfshijnë përqindjen më të madhe në krahasim me ndërtesat pa bodrum dhe saktësisht 75 % e tyre (figura 6-1) kanë një kat nën tokë. Kat ky që ishte në shërbim të komunitetit të pallatit dhe ambientet e tij rezultuan në vitet e demokracisë si shumë funksionale dhe të domosdoshme për zhvillimet tregtare kapitaliste në kryeqytet duke u kthyer në ambiente shërbimi, me akses direkt nga rrugët kryesore apo dytësore. Ndërkohë, 25 % e ndërtesave para vitit 1944 u projektuan pa kat bodrumi dhe kryesisht ato ishin banesa deri në 2-3 kate.

---

[17] Krahasimi dhe analiza me banesat e tipologjive të ngjashme në Evropë do të jetë pjesë e kapitullit më poshtë.
[18] Një pjesë e objekteve të ndertuara janë e së njëjtës tipologji dhe ato janë konsideruar si një rast studimor në nxjerrjen e të dhënave dhe rezultateve të marra nga analiza e tyre. Për shembull, pallatet e Lanës janë katër objekte të ndërtuara, por ato janë konsideruar si një shembull i vetëm duke përcjell një tipologji banimi. Në të njëjtën mënyrë është vepruar dhe me rastet e tjera studimore.




*Figura 6-2. Paraqitja grafike e përqindjes së godinave me dhe pa bodrum*

- Pas konkluzioneve të përgjithshme të mësipërme, do të hyjmë në një analizë më të detajuar të tipologjive të apartamenteve. Marrëdhënia e ambienteve të përbashkëta të banesave kolektive me ambientet individuale familjare të banorëve qëndrojnë respektivisht në raportin 19 % me 81 %. Pothuajse 1/5 e ndërtesës shërben për levizjen horizontale dhe vertikale të qytetarëve, duke përfshirë ambientin e shkallës si nyje vertikale, korridoret shpërndarëse dhe hollet hyrëse në disa raste të godinave.




*Figura 6-3. Paraqitje grafike e përqindjes së hapësirave të përbashkëta në godinë me sipërfaqen bruto të apartamenteve*

- Një nga pyetjet kryesore të kërkimit të tezës së disertacionit është ajo në lidhje me tipologjinë e apartamente dhe organizimin funksional të hapësirave të brendshme të tyre. Në rastet studimore të paraqitura vihet re një prani më e madhe e apartamente me dy dhoma gjumi, me rreth 41 % të apartamenteve të projektuara në skema të ndryshme tipologjish banesash. Të dytët, me 32 % renditen apartamentet me tre dhoma gjumi, të cilat janë projektuar me sipërfaqe të konsiderueshme dhe me hapësira të bollshme. Apartamentet me një dhomë fjetjeje zënë 27 % të numrit total të apartamenteve të analizuar në tezë, gjithmonë sipas tipologjive të projektimit dhe jo numrit total të ndërtesave të projektuara apo të realizuara. (figura 6-4)

Këto konkluzione lidhen drejtpërdrejtë me faktor të politikave të jashtme dhe faktorë shoqëror të brendshëm.




*Figura 6-4. Paraqitja grafike në përqindje e tipologjive të apartamenteve sipas numrit të dhomave të gjumit*

## 6.2 Tipologjitë e apartamenteve

Pas analizës së përgjithshme të banesave kolektive të projektuara për punëtorët dhe punonjësit e atyre viteve në Shqipëri, në vazhdim të tezës së disertacionit vjen një vështrim më i detajuar i qelizës së banimit duke marrë të dhëna më të detajuara dhe specifike për tipologjitë e ndryshme të apartamenteve. Çdo qelizë banimi ka një organizim funksional të hapësirave të sajin e cila përcaktohet nga tre faktorë:

1. Organizimi i shërbimeve

Mënyra si vendoset që të realizohet skema e shpërndarjes së funksioneve në një qelizë banimi ndikon drejtpërsëdrejti në formën përfundimtare të strukturës së apartamentit dhe në jetesën bazike të banorëve.

2. Nga vlera dhe prioriteti që i jepet elementëve të caktuar, të cilët i referohen karakteristikave etnike dhe shoqërore të njerëzve që jetojnë në banesa

Në varësi të kategorisë së banorëve që do të strehohen në banesat kolektive caktohen dhe detyrat paraprake të projektimit. Klasa shoqërore është një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e disa kritereve jetik në projektim dhe në shtimin apo jo të disa elementëve të veçantë, që vijnë si rezultat i mënyrës së të jetuarit.

3. Nga tipi i organizmit strehues në të cilën qeliza bën pjesë.

Kjo do të përcaktohej nga tipologjia e ndërtesës në të cilën qeliza bën pjesë dhe nga lloji i strukturës që i përket ky objekt. Sipas klasifikimeve të ndryshme të lagjeve që projektohen dhe grupimit të ndërtesave, ndryshojnë edhe tipologjitë e apartamenteve dhe konceptimi i tyre.

Nga faktorët e mësipërm arrijmë të diferencojmë qartë karakteristikat e banesave kolektive dhe të nxjerrim konkluzionet për banesat e para kolektive në Tiranë.

Apartamentet janë klasifikuar sipas numrit të dhomave të gjumit, të cilat lidhen ngushtë dhe drejtpërdrejt me numrin e personave që do të akomodoheshin në këto banesa. Gjatë leximit të shembujve nuk është marrë parasysh në klasifikim diferencimi ose jo i dhomës së ndejtjes

nga gatimi apo ngrënia por ato janë paraqitur si element plotësues në paraqitjen e të dhënave, që të çojnë në rezultatet e mëposhtme.

**Apartamentet me një dhomë gjumi**

- Disa prej shembujve të analizuar janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm duke paraqitur raportin që zënë ambientet e ndryshme të apartamente me një dhomë gjumi në raport më sipërfaqen bruto të banesës.

Dhoma e gjumit në këtë tipologji apartamenti zë nga 15 % deri në 21 % të sipërfaqes totale, që do të thotë nuk ka diferenca të mëdha nga projektimi i kësaj kategorie në ndërtesa të ndryshme. Vlera e sipërfaqes fillon nga dhoma më e vogël me 11 m² deri në hapësirën më të madhe, me sipërfaqe 20 m², në banesa me ambiente të bollshme.




*Figura 6-5. Raporti i sipërfaqeve të ambienteve për disa raste apartamentesh me një dhomë gjumi*[19]

Nga grafiku lexohet qartë rëndësia që ka pasur zona e ditës, e cila përfshin ndejtjen, gatimin dhe ngrënien në projektimin e apartamenteve me dy krevat. Ajo përfshin të pakten 25% të ambienteve dhe shkon në disa banesa deri në 48 % të saj. (figura 6-6). Tualeti në këtë tipologji është vetëm një i pranishëm dhe zë nga 5 % deri në 10 % të sipërfaqes bruto të gjithë banesës. Në qoftë se do të përpiqeshim ti caktonim një formulë zhvillimit të hapësirave në projektimin e banesave, do të fokusoheshim më shumë tek dhomat e fjetjes dhe tualetet, të cilat duket sikur ndjekin një ligjshmëri në raport me njëra tjetrën, nga një apartament në tjetrin. Nuk ka diferenca të mëdha, të dukshme të përqindjes që ato zënë në ambientin e përgjithshëm të banesës nga njëri rast studimor në tjetrin.

[19] Në zonën e ditës janë përfshirë vetëm ambientet e ndejtjes, ngrënies dhe gatimit




*Figura 6-6. Paraqitja e përqindjes së disa prej ambienteve në apartamentet me një dhomë gjumi*

## Apartamentet me dy dhoma gjumi

• Të njëjtët grafikë (figura 6-7) dhe rezultate janë realizuar dhe për apartamentet me dy dhoma gjumi duke pasqyruar raportin në përqindje të sipërfaqeve të ambienteve të pranishme brenda hapësirës totale të banesës. Për shkak të shtimit të një dhome fjetjeje, në këtë kategori projektimi vihet re një përmbysje në disa raste e raportit të zonës së ditës me zonën e fjetjes, ku kjo e fundit është më e madhe në sipërfaqe. Kjo dukuri ndodh dhe për faktin se dhomat e gjumit janë projektuar me hapësira të konsiderueshme dhe zënë një rol të rëndësishëm në projektimin e banesës para vitit 1944 në Tiranë. Rreth 40 % e apartamenteve të kësaj topologjie kanë ambiente shërbimi ose depo dhe 85 % e këtyre banesave kanë ballkone ose veranda në planimetritë e tyre.




*Figura 6-7. Raporti i sipërfaqeve të ambienteve për disa raste apartamentesh me dy dhoma gjumi*

Nga grafiku i mëposhtëm arrijmë të përforcojmë konkluzionet e arritura më sipër në raportin e zonës së ditës me atë të natës[20]. Duke krahasuar grafikun e figurës 6-6 për apartamentet me një dhomë gjumi me grafikun (figura 6-8) e apartamentit me dy dhoma fjetjeje interpretojmë

[20] Zona e natës përfshin vetëm dhomat e fjetjes për secilin apartament.

vijën grafike me anë të së cilës kuptojmë se si shtimi i një dhomë gjumi, ndryshon të gjithë raportin e ambienteve në banesë. Kurba e zonës së ditës ndërthurret me kurbën e zonës së natës duke treguar se sipërfaqet e tyre ndryshojnë në apartamente të ndryshme të tipologjisë me dy dhoma fjetjeje. Zona e ditës nuk ndryshon shumë në sipërfaqe nga banesat me një dhomë gjumi nga ato me dy dhoma, por rritja e sipërfaqes së zonës së natës vjen si derivat i rritjes në numrit të dhomave. Grafiku i tualeteve qëndron pothuajse i pa ndryshueshëm për shkak të dy faktorëve: rritja e sipërfaqes totale të apartamentit dhe shtimit të numrit të tualeteve ose rritje të sipërfaqes së nyjes higjieno sanitare dhe kur ajo është vetëm një në numër. Nga të gjitha rastet studimore të tipologjive të ndryshme, nga apartamentet me dy dhoma fjetjeje, 41 % e tyre janë projektuar me dy nyje higjieno sanitare. Pra, jo detyrimisht numri i një dhomë gjumi ka çuar dhe në shtimin e një tualeti.




*Figura 6-8. Paraqitja e përqindjes së disa prej ambienteve në apartamentet me dy dhoma gjumi*

## Apartamentet me tre dhoma gjumi

- Në tipologjitë e nyjeve të banimit, në Tiranë u projektua dhe banesa me tre dhoma gjumi , e cila zinte 33 % të numrit total të apartamenteve. Ajo kishtë një rol të veçantë dhe shumë të rëndësishëm sepse në disa kategori ndërtesash, si p.sh. ato me katër apartamente në kat, konkretisht pallatet Moskat dhe ato të Lanës ishin dizenjuar vetëm kjo tipologji banimi. Këto apartamente janë të bollshme dhe me disa ambiente shtesë nga tipologjitë e tjera të analizuara më sipër. Grafikë shoqërues janë paraqitur dhe për këtë tipologji duke pasqyruar të gjitha të dhënat dhe raportet e të gjitha ambienteve për disa raste studimore apartamentesh me tre dhoma.




*Figura 6-9 Raporti i sipërfaqeve të ambienteve për disa raste apartamentesh me tre dhoma gjumi*

Në rastin e kësaj tipologjie mbizotërimi në përqindje i zonës së natës me dhomat e gjumit është më i dukshëm në krahasim me rastin e mëparshëm. Në grafikun e mëposhtëm (figura 6-10) janë ilustruar kurbat për secilin ambient. Në pjesën më të madhe të apartamenteve, janë pikërisht dhomat e fjetjes ato që shtrihen në sipërfaqe më të madhe të banesës. Këto lloj banesash ndryshojnë nga njëra tjetra, jo vetëm për faktin se i përkasin objekteve të ndryshme por edhe nga konceptimi i dimensioneve të ambienteve me të njëjtin funksion duke reflektuar më së miri larmishmëri dhe diversitet në projektim nga arkitektët e huaj. Të gjitha rastet studimore të apartamenteve me tre dhoma gjumi pasqyrojnë në projektet dhe planimetritë e tyre dy nyje higjieno sanitare, ku vetëm njëra prej tyre ka elementin e dushit apo vaskës.




*Figura 6-10. Paraqitja e përqindjes së disa prej ambienteve në apartamentet me tre dhoma gjumi*

Po të lexosh me kujdes të gjithë grafikët e paraqitur kupton se në ato vite në Tiranë nuk është projektuar sipas një standardi të caktuar apo normave të paracaktuara nga faktorë të jashtëm politik apo ekonomik. Projektimi i banesës në vendin tonë qëndron shumë larg konceptit të ekzistenc minimum të diskutuar shumë në Evropë.

# PROJEKTIMI I BANESËS SË PUNËTORËVE NË EVROPË 7

## 7. PROJEKTIMI I BANESËS SË PUNËTORËVE NË EVROPË

Në qoftë se do të na duhej të bënim një analizë krahasimore të projektimit rezidencial në Shqipëri duke e paralelizuar me konceptet dhe skemat e projektimit të banesave në botë atëherë do të lindte, domosdoshmërish nevoja për një përmbledhje të tipologjive të apartamenteve në botë në vitet 1920-1945, periudhë që përfshin temën e disertacionit.

Janë përzgjedhur dhe dizenjuar grafikisht për tu paraqitur në këtë kapitull disa skema të projektuara nga arkitektë gjerman në një nga komplekset më të njohura në Berlin, “Gross – Siedlung Britz”, projektuar në vitin 1925.

### *1. Rasti i parë studimor*

Lagja “Britz” përfaqësonte një përvojë të rëndësishme në kuadrin e ndërhyrjeve ekonomike dhe sociale të strehimit të administratës së Berlinit, pasi ai përpiqet të pajtojë problemin e një organizimi të ri të prodhimit të ndërtesave dhe kantierit me nevojën për të gjetur një individualitet morfologjik që karakterizon zgjidhje konkrete.

“Britz” përbëhet nga 1027 apartamente, të grumbulluara sipas tipit linear (një shkallë furnizon dy apartamente për kat). Elementet e konstruksionit si dyer, dritare etj. janë të parafabrikuara. Qelizat reduktohen në një numër të kufizuar dhe studiohen sipas kritereve të racionalizimit maksimal. Akomodimi përbëhet nga dy dhoma ose më shumë dhoma me kuzhinë, banjo dhe ballkon. Veçanërisht interesante është përdorimi i ngjyrës në perspektivat për të dalluar pjesët e ndryshme të tërësisë (Quilici, et al., 1978, p. 123).




*Figura 7-1. Shembuj planimetrish në Gross – Siedlung Britz, 1925-1931, 1.Tipologji banimi projektuar nga Max Taut, 2.Tipologji banimi projektuar nga Bruno Taut. Burimi:* (Quilici, et al., 1978), *përpunuar dhe dizenjuar nga autori*




*Figura 7-2. Shembuj planimetrish në Gross – Siedlung Britz, 1925-1931, 3 Tipologji banimi projektuar nga Martin Wagner, 4 Tipologji banimi projektuar nga Bruno Taut. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

**GROPIUS:**

Gropius në “Il lavoro di preparazione sistematico per la costruzione razionale di abitazioni” (1927) mundohet të shpjegoj nevojat e njerëzve dhe familjarëve për kushtet bazike të jetesës duke justifikuar kështu edhe mënyrën racionale të projektimit. Sipas tij ndërtimi do të thotë të gjesh forma hapësinore që përshtaten ndaj nevojave të jetës. Shumica e individëve kanë nevoja të ngjashme, rrjedhimisht logjike, dhe në përputhje me nevojat e ekonomisë. Këto nevoja të ngjashme duhet të plotësohen në mënyrë unitare dhe të ngjashme. Prandaj nuk ka asnjë justifikim për faktin se çdo shtëpi ka një planimetri të ndryshme, një pamje të jashtme të ndryshme, se është e ndërtuar me materiale të ndryshme dhe se paraqet një stil të ndryshëm. E gjithë kjo do të thotë humbje dhe ekzaltim i gabuar i individualitetit. Çdo individ mbetet i lirë të zgjedhë midis llojeve të ndryshme që kanë lindur njëri mbi tjetrin.

Qëllimi përfundimtar i zhvillimit të banesës arrihet kur të gjitha dëshirat e justifikuara të individit për shtëpinë e tij mund të plotësohen, pa humbur avantazhin ekonomik të prodhimit masiv: shtëpitë dhe orenditë e tyre do të jenë të ndryshme në pamjen e tyre. në përgjithësi sipas numrit dhe karakterit të banorëve, ndërsa pjesët individuale të ndërtimit do të jenë të njëjta. Tipi standard në vetvete nuk paraqet pengesë për zhvillimin e lartë kulturor, por përkundrazi ndikon pozitivisht. Rreziku i shpërndarjes dhe i një mënyre irracionale të ecurisë në punën përgatitore konceptuale dhe shkencore mbetet i pranishëm për sa kohë që nuk merret seriozisht nga institucionet përkatëse për tia deleguar specialistëve të duhur për menaxhimin dhe projektimin e tyre. Ky i fundit ka qenë një problem i pranishëm në atë periudhë, i cili ka ndikur në mos respektim të kërkesave bazike të të jetuarit dhe mos funksionim i mirë i zgjidhjeve të banesave dhe konceptit jetik të nyjes së akomodimit.

## 2. *Rasti i dytë studimor*

*Eksperienca e Siedlungen, Gjermani* administruar nga Martin Wagner, Hamburgu i Fritz Schumacher dhe Amsterdami i Cor van Eesteren, janë tre shembujt më të rëndësishëm në historinë e menaxhimit social-demokratik të qytetit. Por krahas oazeve të rendit të Siedlungen, utopi të vërteta të ndërtuara, në buzë të një realiteti urban ku ata kanë pak ndikim, qytetet historike dhe territoret prodhuese vazhdojnë të grumbullohen dhe shumëfishojnë kontradiktat e tyre. Përvoja e Evropës Qëndrore e shoqërisë së arkitektëve demokratë kanë si kusht të respektojnë unifikimin e pushtetit administrativ dhe propozimin intelektual. Propozimi arkitektonik, modeli urban që artikulohet mbi të, premisat ekonomike dhe teknologjike që ai nënshtron, pronësia publike e tokës dhe impiantet e industrializimit. të dimensionuara në ciklet e prodhimit të programuara në mjedisin urban janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëri-tjetrin. Shkenca arkitekturore është tërësisht e integruar në ideologjinë e planit dhe vetë zgjedhjet formale janë vetëm variabla të varura prej saj (Tafuri, 1973, pp. 104-105).

Lagjet më poshtë të paraqitura, janë të krijuara si pjesë e përvojave të menaxhimit socialdemokratik të qytetit të republikës së Weimar (1924-1933). Ato përbëjnë një nga momentet më të rëndësishme të shfajësimit të parimeve teorike të racionalizmit gjerman mbi qytetin dhe të ideologjisë antiurbane të lagjes, në kundërshtim me idenë e një qyteti kompakt.

Ato përfaqësojnë një evolucion dhe racionalizim të fshatrave të punëtorëve dhe të qytet - kopshtit të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Më poshtë janë pasqyruar tre shembuj vendbanimesh të qyteteve: Frankfurt (1928-1929), Berlin (1929-1932) dhe Karlsruhe/Lagja Dammerstock projektuar nga Walter Gropius(1927-1929) ( (Quilici, et al., 1978, p. 140).

**LAGJA “RÖMERSTADT”**




*Figura 7-3. Shembuj planimetrish në lagjen “Römerstadt” në Frankfurt, 1928-1929. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*




*Figura 7-4. Shembuj planimetrish në lagjen “Römerstadt” në Frankfurt, 1928-1929. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

a. Banesë dy familjare ndërtuar në dy kate e tipit Zwofadolei
b. Banesë me katër kate e tipit Mefadolei
c. Banesë me dy kate e tipit Efa

**LAGJA "SIEMENSSTADT":**




*Figura 7-5. Shembuj planimetrish në lagjen "Siemensstadt" në Berlin, 1929-1932. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*




*Figura 7-6. Shembuj planimetrish në lagjen "Siemensstadt" në Berlin, 1929-1932. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

a. Banesë e tipit linear e ark. H.Scharoun

b. Banesë e tipit linear e ark. H.Scharoun
c. Banesë e tipit linear e ark. W.Gropius
d. Banesë me korridor - ballkon (ballatoio esterno) e ark. W.Gropius

**LAGJA "DAMMERSTOCK"**




*Figura 7-7. Shembuj planimetrish në lagjen "Dammerstock" në Karlsruhe, 1927-1929. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*




*Figura 7-8. Shembuj planimetrish në lagjen "Dammerstock" në Karlsruhe, 1927-1929. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

a. Banesa të bashkangjitura të W.Gropius
b. Banesë lineare e ark. W.Gropius
c. Banesë me korridor - ballkon (ballatoio esterno) e ark. W.Gropius

### 3. *Rasti i tretë studimor*

***Projektet e Ark. Figini dhe Pollini në Ivrea***

*A. Plani për krijimin e një lagje të re, Ivrea, Itali, 1936-1937*

Ky projekt, ashtu si dhe shumë të tjerë të përfshirë në harkun kohor nga 1934 në 1957, është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të arkitektëve L. Figini dhe G. Pollini me investitorin Adriano Olivetti. Lagja ishte parashikuar si zgjerim industrial dhe rezidencial i qytetit të Ivreas dhe ishte i kompletuar me të gjitha shërbimet e nevojshme për rezidencë banimi. Tipologjitë e banesave të projektuara ishin dy: banesat e ulta (tre kate) dhe banesat e larta (12 kate), të dyja me korridor – ballkon shpërndarës.

*B. Më poshtë prezantohen tipologjitë e apartamenteve, respektivisht për banesat e larta dhe të ulta në këtë lagje.*




*Figura 7-9. Shembuj planimetrish në lagjen e re në Ivrea, Itali, 1936-1937. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

*C. Banesa popullore për punëtorët Olivetti, Ivrea 1939-1940*

Brenda të njëjtës lagje janë projektuar në vitin 1940 banesa për strehimin e punëtorëve të kompanisë "Olivetti". E ndërtuar nga IACP e Aostës dhe shoqëria Olivetti, kjo ndërtesë u vendos pranë çerdhes, projektuar nga të njëjtët arkitektë duke formuar në të përgjithshmen një kompleks unik. Godina shkon në lartësinë e tre kateve dhe është e strukturuar me katër nyje shkallësh, të vendosura në mënyrë lineare duke furnizuar secila prej tyre dy apartamente në kat, me dy deri në tre ambiente për secilin prej tyre.




*Figura 7-10. Banesa për punëtorët e Olivetti, Ivrea 1940. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*




*Figura 7-11. Banesa për punëtorët e Olivetti, Ivrea 1940, planimetria e apartamentit tip. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

### *D. Banesa për punonjësit Olivetti, Ivrea 1940*

Bërthama e parë e një lagjeje të vogël punonjësish Olivetti, kompletuar më vonë në vitet ’50, ky grup banesash me tarraca është padyshim një nga krijimet më interesante të Figinit dhe Pollinit, si për shpikjen tipologjike ashtu edhe për cilësinë formale. Në projektin fillestar, të paraqitur këtu, ishin planifikuar ndërtesa me nga nëntë apartamente secila. Më pas rrethi u ndërtua me blloqe prej katër apartamentesh. Lloji i përdorur është ai i një shtëpie njëfamiljare në tre kate; kati perdhe, 2.20 m i larte, perfshin garazhin, bodrumin dhe nje oborr te mbuluar me pamje nga kopshti.

Muri me pamje nga shërbimet dhe shkallët, është i çarë nga dritare të vogla me vrima, ndërsa në pjesën e përparme kryesore, dritare të mëdha franceze hapen në llozhë që kalon përgjatë gjithë ndërtesës.




*Figura 7-12. Banesa popullore për punonjësit Olivetti, Ivrea 1940. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*




*Figura 7-13. Banesa popullore për punonjësit Olivetti, Ivrea 1940, planimetria e apartamentit tip. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

## 4. *Rasti 4 studimor:*

### *Projekti i lagjes satelit në Rebbio, (Como), viti 1938, Ark. A.Sartoris dhe G.Terragni*

Lagja satelit e Komos është e karakterit ekonomik dhe popullor. Sistemimi urban është i tipit intensiv në zonën qëndrore ku ndodhen edhe shërbimet dhe për pjesën tjetër është i shpërndarë; orientimi i ndërtesave ndjek aksin termik diellor veri-jug.
Tipologjitë: tipi i banesave të bashkangjitura me tarraca me një kat mbi tokë ose dy kate, 22 metra larg njëra-tjetrës, me pamje nga lindja mbi kopshte të vogla dhe nga perëndimi mbi

parcela toke, të ndara sipas numrit të apartamenteve; dhe tipe intensive në linjë në blloqe gjashtëkatëshe me ballkone të jashtme 52 m larg njëri-tjetrit, me hapësira të gjelbra të mëdha ndërmjet blloqeve.

Ky projekt shembullor i lagjes së klasës punëtore të arkitektëve Terragni dhe Sartoris që kanë studiuar për rrethinat e Komo-s, nuk patën ekzekutim të menjëhershëm sepse rritja demografike në rajonin e Komos nuk ishte e tillë që të justifikonte, në momentin e projektimit shpenzimet. Nga ana tjetër, nuk dukej se ishte e nevojshme të tregohej praktikisht interesi i shtetit ndaj atyre klasave që japin kontributin maksimal të mundshëm që në lindjen dhe krijimin e tyre. Për të favorizuar rritjen demografike nuk mjaftojnë shpërblimet "jo të drejpërdrejta" apo lehtësimet pak a shumë të vonuara, por mbi të gjitha është e nevojshme parandalimi i ngjarjeve dhe ndërtimi i shtëpive higjienike, të shëndetshme, të bukura, të bollshme jo vetëm aty ku janë absolutisht të domosdoshme, por edhe aty ku prania e tyre mund të çojë në një ritëm më të shëndetshëm dhe më pjellor të jetës: fillimisht ku janë shtëpitë dhe më pas fëmijët (Pagano, Progetto di un quartiere operaio, 1941).

*A. Banesa me një kat*

Ky është rasti tipik i një banese tipi i ulët, një kat banim dhe dy apartamente të bashkangjitura. Secilit apartament i shkon sipërfaqja e shfytëzueshme 33.92 m².




*Figura 7-14. Lagja satelit në Rebbio (Como), Itali. Rasti i Banesës 1-katëshe, 1938. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*




*Figura 7-15. Lagja satelit në Rebbio (Como), Itali. Rasti i Banesës 1-katëshe, 1938. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

*B. Banesa me dy kate*

Rasti tipik i një banese të ulët, ndërtuar në dy kate banim. Çdo apartament ka një sipërfaqe të shfytëzueshme 40.06 m².




*Figura 7-16. Lagja satelit në Rebbio (Como), Itali. Rasti i Banesës 2-katëshe, 1938. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

*C. Banesa me 6 kate*

Rasti më poshtë është i tipit me korridor shpërndarës në formën e ballkonit, ndërtuar në gjashtë kate lartësi. Çdo apartament ka një sipërfaqe të shfytëzueshme 31.17 m².




*Figura 7-17. Lagja satelit në Rebbio (Como), Itali. Rasti i Banesës 6-katëshe, 1938. Burimi: (Quilici, et al., 1978), përpunuar dhe dizenjuar nga autori*

# KONKLUZIONET 8

# 8. KONKLUZIONET

Në këtë kapitull do të paraqiten në një mënyrë më të përmbledhur të dhënat e marra si rezultat i analizës së banesave kolektive në Tiranë dhe në Evropë. Përballja e rezultateve të analizave të veçanta për secilën kategori projektimi na ndihmon për të arritur përfundimet e kërkuara duke u dhënë përgjigje dhe pyetjeve kërkimore të tezës së disertacionit. Matjet dhe të dhënat e nxjerra nga çdo tabelë për secilën tipologji banimi në Tiranë tregojnë modelet e projektuara duke na krijuar mundësinë e analizës krahasimore me vendet evropiane. Duhet patur parasysh se të gjitha rastet studimore të prezantuara në studim janë përzgjedhur sipas tipologjive të ndryshme që ato përfaqësojnë dhe konkluzionet bazohen mbi larmishmërinë e ndryshme në projektim të banesave dhe jo mbi ndërtesat fizike që janë ndërtuar në qytetin e Tiranës. Në disa raste e njëjta godinë është dizenjuar për tu ndërtuar disa herë brenda një zone urbane, por në këtë rast ajo është konsideruar si një tipologji dhe është listuar vetëm një herë në analizën e tabelave dhe nxjerrjen e rezultateve. Pra, duhet theksuar se të gjitha konkluzionet dhe përfundimet bazohen mbi tipologjinë e projekteve të projektuara, por jo detyrimisht të ndërtuara në Tiranë.

## 8.1 Konkluzionet e tipologjisë së banesës së projektuar në Tiranë

Piacentini (Piacentini, 1931) shkruan në një nga revistat e viteve ’30 se: “Banesa është tema tipike, ndërtesa simbolike e kohës”. Problemi i strehimit dhe ai social, që ka qenë i pranishëm në vitet e pas Luftës së Parë Botërore dhe sidomos në vitet ’30 ku arriti kulmin, përfshiu të gjithë urbanistët dhe ndërtuesit e kohës duke i dhënë një prioritet të veçantë ekspozitave dhe projekteve për qytetet-kopsht dhe banesat (Patetta, 1972, p. 277).
Kjo dukuri e pranishme edhe në Tiranë kërkon një analizë krahasimore me tipologjinë e projektimit evropian në varësi të terminologjisë së përdorur në Evropë sipas kategorive dhe tipologjive të projektimit. Duke u mbështetur tek kapitulli 3 i tezës së disertacionit, pra sfondit historik mund të përshkruajmë projektimin në Tiranë në lidhje me termin banesa “individuale” dhe “kolektive”.
Në Tiranë vihet re prania e të dyja tipologjive të banimit:

1. Grupi i banesave individuale nënkupton shtëpi individuale, të bashkuara në seri të vazhdueshëm, të organizuara në një deri në dy kate, tipike të qyteteve-satelit dhe qyteteve-kopsht. Në shembujt e paraqitur në kapitujt e mësipërm dallohet qartë kjo kategori projektimi si në fshatin “Littorio”, Laprakë.

2. Tipologjia tjetër e banesave në Tiranë janë grupe banesash kolektive me apartamente të mbivendosura, të lidhura për secilin kat me shkallë të përbashkëta. Ato quhen të tilla sepse kanë të përbashkët elementë dhe ambiente shërbimi si ballkone, shkallë, korridor, etj. Prania e kësaj tipologjie vihet re në të gjithë qytetin, ku përqendrimi më i madh është në lagjen “Tirana e Re”.

Pas krijimit të tabelave të të dhënave dhe mbledhjes së informacionit të nevojshëm, është e rëndësishme të paraqiten disa konkluzione për të kuptuar tipologjitë e banesave para vitit 1944. Disa element dallues, të cilët lexohen menjëherë në planimetritë e apartamenteve paraqiten në vazhdimësi të këtij kapitulli. Ato janë pjesë e analizës funksionale të realizuar më sipër në kërkim dhe të reflektuar në konkluzionet e mëposhtme.

Sipas rezultateve të arritura në kapitullin 6, në vitet 1925-1943 në Tiranë u projektuan banesa të mesme, me lartësi dy deri në katër kate, ku 50% e rasteve studimore janë objektet në lartësinë e dy kateve, rreth 4% janë ndërtesat katër kate dhe 46% janë objektet që ngrihen në lartësinë e tre kateve mbi tokë.

Një nga pyetjet kryesore të kërkimit të tezës së disertacionit është ajo në lidhje me tipologjinë e apartamente dhe organizimin funksional të hapësirave të brendshme të tyre. Në rastet studimore të paraqitura vihet re një prani më e madhe e apartamente me dy dhoma gjumi, me rreth 41 % të apartamenteve të projektuara në skema të ndryshme tipologjish banesash. Të dytët, me 32 % renditen apartamentet me tre dhoma gjumi, të cilat jane projektuar me sipërfaqe të konsiderueshme dhe me hapësira të bollshme. Apartamentet me një dhomë fjetjeje zënë 27 % të numrit total të apartamenteve të analizuar në tezë.

Pas analizimit me kujdes të grafikëve në kapitullin e rezultateve u mblodhën të dhënat e mjaftueshme për të paraqitur një grafik tjetër (figura 8-1), i cili na ndihmon të krahasojmë raportin e të njëjtit ambient të brendshëm të qelizës së banimit, por në tipologji apartamentesh të ndryshme.




*Figura 8-1. Raporti në përqindje i zonës së ditës me sipërfaqen bruto të apartamanetit për secilën tipologji apartamenti (me 1, 2 dhe 3 dhoma gjumi)*

Nga grafiku i krahasimit të përqindjeve që i përket ambientit të ditës në secilin prej tipeve të apartamenteve, përkatësisht ai me 1, 2 dhe 3 dhoma fjetjeje, arrijmë në konkluzionin se duke rritur numrin e dhomave të gjumit, zvogëlohet raporti i zonës së ditës me sipërfaqen bruto të apartamentit. Ka raste të rralla kur ka përjashtime, të cilat pasqyrohen në grafik me ndërthurje të kurbave, veçanërisht midis apartamenteve me dy dhe tre dhoma gjumi. Kjo dukuri ndodh për shkak të shtimit të dhomës së ngrënies si ambient i veçantë në disa prej rasteve studimore të apartamenteve me tre dhoma gjumi.

Të njëjtën mënyrë dhe arsyetim ndjekim dhe për një ambient tjetër të qelizës së banimit, që është zona e dhomave të gjumit. Në grafikun e mëposhtëm (figura 8-2) paraqiten kurbat e ndryshueshme të përqindjeve që zënë dhomat e gjumit në hapësirën bruto të secilit tip

apartamenti. Në këtë rast vihet re një përmbysje e grafikut të mëparshëm duke na lejuar neve në perceptim një rrjedhshmëri logjike sinkrone me konkluzionin e arritur nga zona e ditës. Në apartamentet e vogla, me një dhomë gjumi përqindja e këtij raporti është e vogël, ashtu dhe si është logjike të jetë. Edhe në këtë grafik, në raste studimore të veçanta lexohet një kapërcim i kurbës së apartamenteve me dy dhoma në raport me ato me tre dhoma. Kjo dukuri vjen si rezultat i shtimit të ambienteve të tjera në apartamente dhe rritja e sipërfaqes së përgjithshme.




*Figura 8-2. Raporti në përqindje i dhomave të gjumit me sipërfaqen bruto të apartamanetit për secilën tipologji apartamenti (me 1, 2 dhe 3 dhoma gjumi)*

## 8.2 Konkluzionet e analizës krahasimore të banesës në Tiranë në raport me banesën minimale dhe racionale të punëtorëve në Evropë

Baza ekonomike, kërkesat higjenike dhe faktorët etikë përfaqësojnë principet bazë për studimin e qelizës. Duke u bazuar në këto koncepte në Evropë u bënë shumë përpjekje për të zvogëluar qelizën në pak element themelor me dimensione të caktuara, ku shmangej humbja e hapësirës, qoftë dhe e vogël duke përfituar normalizim të elementëve individual. Kjo dukuri ishte veçanërisht e pranishme në banesat popullore, të cilat u krijuan në pjesën më të madhe të rasteve në kushte të veçanta nevojash dhe kërkesash.

Një konfirmim i strehimit në vitet ’30 ishte se: çdo organizëm banesash kolektive pajtohej me konceptin e banesës minimale, e cila u theksua dhe saktësua dhe në kongreset e CIAM. Një banesë racionale konsiderohej si një mjet i preferuar, përdorimi i të cilit ishte efikas për individët me arsim të lartë. Duke hequr të gjitha barrierat e vlerave sociale dhe psikologjike për shkak të edukimit sistematik të njerëzve, mjeti i strehimit do të kishte atribute të përbashkëta për të gjitha racat, përvec kufizimeve si pasojë e kushteve klimaterike.

Në librin e Samonà janë arritur disa konkluzione për banesat e punëtorëve në Evropë në vitet ’30. Ato janë një përmbledhje e disa tipologjive karakteristike në shtete të ndryshme.

*Raporti i sipërfaqes së shfrytëzueshme me numrin e krevateve*

Sipas konkluzioneve të nxjerra nga Samonà dhe të ilustruara e shpjeguara më së miri në librin e kuruar nga Mario Manieri-Elia (Manieri-Elia, 1982, pp. 180-183), janë arritur të dhëna interesante mbi raportin e sipërfaqes së shfrytëzueshme me numrin e krevateve në apartament

në tipologji të ndryshme banesash për punëtorë të studiuara në vitet ’30. Në pjesën më të madhe të rasteve ky raport është më i madh se 10 dhe lexohet qartë në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 8-1. Tabela e sipërfaqeve të shfrytëzueshme për disa tipologji banesash për punëtorë në vitet ’30, në Evropë*

| Tipologji banesash për punëtorë në vitet '30 në Evropë | *Breslau:* Banesa në 3 kate me densitet të mesëm *Apartament me 2 krevatë* | *Frankfurt:* Banesa me korridor shpërndarës të jashtëm (ballatoio esterno) *Apartament me 2 krevatë* | *Lodz:* Banesa me korridor shpërndarës të jashtëm (ballatoio esterno) *Apartament me 2 krevatë* | *Hamburg:* Banesa në 4 kate me densitet të mesëm *Apartament me 3 krevatë* | *Karlsrub:* Banesa në 3 kate me densitet të mesëm *Apartament me 6 krevatë* | *Breslau:* Banesa individuale në një lagje me shtëpi të bashkangjitura *Apartament me 7 krevatë* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Sipërfaqja e shfrytëzueshme (m2) | 40.1 | 46 | 34.4 | 43.6 | 66 | 85 |

Tabela e mësipërme paraqet disa prej shembujve të ilustruar dhe analizuar në atë libër për të arritur më pas në përfundimet e mëposhtme, të cilat janë më të përgjithshme dhe do të na ndihmojnë të realizojmë më lehtë një analizë krahasimore midis këtyre rezultateve dhe atyre të paraqitura nga banesat kolektive shqiptare .

*Tabela 8-2. Tabela e sipërfaqeve të shfrytëzueshme sipas tipologjive të apartamenteve për banesat e punëtorëve në Evropë në vitet ‘30*

| Tipologjia e apartamentit | Apartamentet me 2 krevatë | Apartamentet me 3 krevatë | Apartamentet me 4 krevatë |
|---|---|---|---|
| Sipërfaqja e shfrytëzueshme (m2) | 35-40 | 40-45 | 48-50 |

Në studimin dhe konkluzionet e Samonà nuk përjashtohen dhe rastet kur apartamentet kanë një sipërfaqe të shfrytëzueshme më të vogël se të sipër përshkruarat, por ato nuk do të jenë pjesë e analizës sonë krahasimore.

Nga rezultatet e paraqitura në kapitujt e mëparshëm për banesat kolektive të projektuara në Tiranë para vitit 1943 arrihet në disa të dhëna statistikore të rëndësishme, të cilat duke u krahasuar me përfundimet e tabelave të mësipërme do të na japin konkluzionet e kërkuara. Tabela 8-3 përmbledh sipas kategorive të apartamenteve të rasteve studimore shqiptare sipërfaqet e shfrytëzueshme për secilën tipologji.

*Tabela 8-3. Tabela e sipërfaqeve të shfrytëzueshme sipas tipologjive të apartamenteve për banesat kolektive para 1943, Tiranë*

| Tipologjia e apartamentit | Apartamentet me 2 krevatë (1 dhomë gjumi) | Apartamentet me 4 krevatë (2 dhoma gjumi) | Apartamentet me 6 krevatë (3 dhoma gjumi) |
|---|---|---|---|
| Sipërfaqja e shfrytëzueshme (m2) | 41-84 | 64-120 | 97-170 |

Nga gjithë konkluzionet e mësipërme, të arritura për banesat kolektive popullore në Evropë, të projektuara brenda racionalizimit dhe banesat kolektive në Tiranë arrijmë në konkluzionin final se në vendin tonë, qeliza e banimit është projektuar me sipërfaqe të shfrytëzueshmë më të mëdha se apartamenti në vendet evropiane. Pra, banesat kolektive shqiptare të viteve ’30 janë ndryshe nga banesa minimale dhe racionale në Evropë duke pasqyruar një standard jetese më të lartë.

Ndërkohë në Tiranë kishte një veçori në kriteret e marra parasysh para nisjes së projektimit, që ishte dhe faktori kryesor nga lindi nevoja e ndërtimit të banesave kolektive: nëpunësit civil. Kjo shtrese shoqërore ishte në rritje të menjëhershme në vitet '30 në vendin tonë dhe siç janë përmendur dhe në kapitujt e fillimit, nevoja e strehimit të tyre ishte domosdoshmëri. Por, ndryshe nga projektimi masiv në shumë vende të Evropës për projektim të banesave popullore, në Tiranë, banorët që do të strehoheshin i përkisnin një kategorie banorësh me kërkesa jetike më të larta. Nga konkluzionet e mësipërme përforcohet ndikimi që pati pozita shoqërore e familjeve që do të akomodoheshin në këto tipologji banesash.

## 8.3 Konkluzionet e analizës krahasimore të banesës në Tiranë në raport me banesën e nëpunësve në Evropë

Për realizimin e këtij studimi janë marrë në analizë rreth 50 projekte të ndryshme të projektuara në qytetin e Tiranës, në harkun kohor 1925-1943. Banesat e këtyre rasteve studimore, pas leximit të organizimit të tyre në kontekstin urban dhe planimetrive për secilën godinë janë klasifikuar sipas disa tipologjive të mbështetura në: formën e njollës së ndërtesave dhe raportin që ato kanë me njëra tjetrën me zhvillimet urbane të kohës dhe numrin e apartamenteve në kat. Ky klasifikim ishte i domosdoshëm në ecurinë e zhvillimit të tezës, me qëllim arritjen në fokusin kryesor, që ishte qeliza e banimit, apartamenti.

Në shumë shtete të Evropës, banesat popullore filluan të zhvilloheshin më shumë duke kaluar në tipologji më racionale dhe në shkallë urbane të madhe si psh; banesat lineare me korridor të jashtëm shpërndarës (ballatoio esterno, figura 8-3). Nga rezultatet e marra nga analiza e banesave kolektive në Tiranë, vihet re se kjo tipologji projektimi nuk është e pranishme në asnjë nga rastet studimore të trajtuara në studim. Skemat shpërndarëse të apartamenteve në objektet e propozuara përfaqësojnë ato me korridor të brendshëm, zakonisht simetrike me bllokun e shkallës vertikale në qendër të korridorit të një seksioni të godinës (figura 8-2). Kjo linjë projektimi e organizuar në seksione përsëritet disa herë brenda një ndërtese.




*Figura 8-3. Skema e paraqitjes së banesave me korridor shpërndarës të jashtëm (ballatoio esterno), rastet në projektimet e huaja*




*Figura 8-4. Skema e shpërndarjes së apartamenteve në banesat kolektive në Tiranë, para 1943.*

Leximi, studimi i rasteve të huaja të projektuara për nëpunësit dhe rezultatet e marra nga analiza e tyre na tregoi se në shumë llojshmërinë e tipologjive të projektimit ishin dhe banesat e tipit *duplex*, aparatmente të organizuara në dy kate me komunikim vertikal me shkallë të brendshme. Ndryshe ndodh me projektet e banesave në Tiranë, ku nuk vihet re asnjë rast me tipologji *banese duplex,* edhe pse shumë herë qeliza e banesës kolektive me dy apo tre dhoma gjumi, të shtrira në një kat e kalojnë sipërfaqen që zënë këto apartamente duplex në Evropë.

Organizimi i hapësirave dhe leximi i interierit të apartamenteve me elementët kryesor apo dytësor që formojnë banesën ka qenë pjesë e fokusit të studimit. Duke shqyrtuar me kujdes kampionët vendas dhe të huaj të projekteve, të cilat kanë qenë pjesë analitike e këtij studimi arrijmë në disa konkluzione të lidhura ngushtë me hapësirat e brendshme dhe raportin që ato krijojnë me njëra tjetrën dhe ndriçimin natyral. Si në Evropë, ashtu edhe në Tiranë të gjitha banesat kolektive kanë të përbashkët qasjen me ndriçimin natyral, i cili është i pranishëm në të gjitha ambientet e banesave.

Një këndvështrim tjetër në këtë studim është realizuar mbi mënyrën e ndarjes së funksioneve jetike në banesë dhe raportit të krijuar midis funksioneve dhe hapësirave që ato zënë. Nga projektet e banesave kolektive të arkitektëve në vendet evropiane, vihet re një ndarje funksionale e pastër e gatimit nga ambientet e tjera të apartamentit. Dhoma e gatimit është dizenjuar si ambient i veçantë në të gjitha tipologjitë e banesave, ato me një, dy apo tre dhoma gjumi. Me të njëjtin fenomen përballemi edhe në projektimin e banesës kolektive në Tiranë. Ambienti i gatimit është i veçuar dhe aksesi i tij arrihet nëpërmjet korridorit kryesor të apartamentit. Ndryshe ka ndodhur me ambientin e ngrënies, ku vetëm 10 % e apartamenteve në Tiranë janë propozuar të realizoheshin me një dhomë të veçantë për këtë funksion, duke mos u integruar në ambientin e ndejtjes apo të gatimit. Kjo dukuri nuk ka ndodhur në rastet e shembujve të huaj, ku është realizuar një shfrytëzim maksimal i hapësirës së ndejtjes dhe në raste më të rralla edhe i kuzhinës, duke u përfshirë në të dhe funksioni i ngrënies.

Duke u bazuar dhe në konkluzionin e mësipërm, elementi i përbashkët midis projektimit në vendet evropiane dhe atij në Tiranë është shfrytëzimi i një hapësire të vetme për bashkëjetesën e dy funksioneve jetike në apartament, siç janë ndejtja dhe ngrënia. Kjo përqasje vihet re në pjesën më të madhe të banesave në vendin tonë, pavarësisht disa rasteve të përmendura më sipër.

Struktura hapësinore e apartamenteve në Tiranë ndryshonte në varësi të rritjes së numrit të dhomave të gjumit. Kjo dukuri vihet re nga analiza krahasimore e rasteve studimore mbi numrin e nyjeve higjieno sanitare në banesë. Ky numër qëndron i pa ndryshuar në shembujt evropian, vetëm një tualet, pavarësisht tipologjisë së apartamentit apo numrit të personave që strehoheshin në të. Ndërkohë duke iu referuar tabelës së rezultateve të banesave kolektive në Tiranë, është faktike se 40 % e apartamenteve me dy dhoma fjetjeje dhe të gjitha ato me tre dhoma gjumi janë konceptuar me dy nyje higjieno sanitare.

Si përfundim, metoda teorike, si çdo tjetër dhe analizat e përdorura në tezë ripohojnë atë që ka qenë gjithmonë pjesë e diskutimeve, përkatësisht se në përcaktimin e llojeve të organizmave dhe skemave të akomodimit, faktorët kompleks që rregullojnë një qelizë banimi

mund të qartësohen dhe të urdhërohen nga një metodë, por ato nuk mund të përfaqësojnë kurrë një normë absolute nga e cila, pasi të jenë vendosur disa elementë të caktuar, është e mundur të arrijmë në përfundime po aq të sigurta dhe unike. Vetëm gradualisht, nëpërmjet përvojës laike, do të jetë e mundur gjithnjë e më shumë të ngushtohet teoria e kufizimeve në lidhje me formimin e organizmave të banesave kolektive, duke e rikthyer përmes një përzgjedhjeje të njëpasnjëshme gjithnjë e më lart në planin e progresit strehimin për njerëzit; por kjo jo për shkak të një metode, por nga një progresion i natyrshëm, i cili formohet spontanisht nga përvoja e asaj që është bërë, nga gabimet që janë gjetur praktikisht, nga arritjet graduale të teknologjisë që hapin horizonte të reja dhe të papritura, aplikimi i ideve të konsideruara më parë të pazbatueshme. Në prizëm të diskutimeve të mëdha të fund shekullit të XIX dhe fillimit të XX, për të kornizuar nëpërmjet metodave apo projektimeve standarde banesën kolektive apo individuale, arrihet në përfundimin se kjo gjë do të ishte e pamundur. Secili vend nën ndikimet gjeografike, politike dhe sociale merr vendime në përshtatje me kushtet që përballet dhe qasjet që ka ndaj problematikave dhe situatave të ndryshme.

## 8.4 Rekomandime

Duke iu referuar literaturës së huaj, çdo vend në momente të caktuara i kthehet historisë së vet duke reflektuar emocione dhe këndvështrime të reja në lidhje me ngjarje ekzistuese, të cilat lexohen ndryshe nga kritikët dhe specialistët në shtrirje kohore të ndryshme. Kjo dukuri ndodh dhe me arkitekturën dhe urbanistikën, të cilat sado kohë të kaloj janë ato që lënë më shumë gjurmë në fytyrën e një vendi dhe prezantojnë në mënyrë vizuale, pa fjalë të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e qytetit. Çdo etapë historike, politike dhe arkitektonik ka lënë shenjën e vet në rrudhat e plakjes së një qyteti dhe sado të mundohemi ajo nuk mund të largohet më por duhet të mbijetojë në kushtet e reja të përshtatjes. Në këtë kuptim, studimi i banesave kolektive para 1944 është një kontributë i shtuar për projektimin rezidencial në Shqipëri.

Rekomandimet e mëposhtme bazohen mbi rezultatet e analizës së detajuar hapësinore të banesave kolektive në Tiranë, të cilat tregojnë një komformitet të lartë të jetesës në ambiente të bollshme dhe hapësira teknike të mjaftueshme për familjet.

1. Nëpërmjet rregullave të përshkruara në rregulloren e Planit Rregullues të 1939-1943 dhe disa kushtëzimeve shumë të thjeshta, krijoheshin rregulli, dekori dhe ansambli urban i qytetit. Nga reflektimi i këtyre rregullave u garantua karakteri arkitektonik dhe cilësia hapësinore e disa prej zonave dhe njësive urbane të cilat kanë arritur deri në ditët e sotme dhe konsiderohen ende nga më të suksesshmet në Tiranë, si p.sh.: ish blloku ("Tirana e Re" me shembujt e ilustruar në këtë kërkim shkencor), ato midis rrugës së Elbasanit dhe rrugës së televizionit, etj.
   Ruajtja fizike e këtyre objekteve për nga vlerat historike arkitektonike që ato mbartin, si gjurmët e para të banesave kolektive në Tiranë. Një pjesë e këtyre ndërtesave kanë nevojë për restaurim për të ruajtur identitetin e tyre si shembuj unik për periudhën që përfaqësojnë.
2. Kompozimi urban i banesave kolektive prezantojnë tipologji të ngjashme me vendet evropiane për të njëjtën periudhë kohore dhe respektimi i hapësirave midis ndërtesave.

Mos okupimi i tyre ndihmon në zhvillimin e qytetit duke ruajtur origjinalitetin dhe koceptet bazë të projektimit të viteve para 1944.

